Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Faik Bruçi, biznesmeni ku qëndron bashkë suksesi dhe humanizmi

Nga **SHAQIR SKARRA**



12

Reportazh/Turizëm

Shtatë ditë maleve, nga Grazhdani në Shishtavec

Nga **Grehans Uka**



4

Turizëm

Tërnova, një perlë e natyrës, e fshehur mes malesh

Nga **EDUART RAMÇI**



8

NISIN PUNIMET NË RRUGËN E ARBRIT, PRESIDENTI I GJOKA KONSTRUKSION DEKLARON:

Punimet mbarojnë për 2 vjet

Kryeministri Edi Rama: **Rruga që ndërtojmë, kushton me gjithë mirëmbajtjen 10 vjet, me gjithë operimin e tunelit, vetëm 250 milionë euro. Sot rruga do të ketë tunele më të gjatë me standarde rigoroze, me tunel emergjence, do të plotësohet me të gjithë segmentet, do të ndërtojë degëzimin e Klosit dhe Maqellarë-Bllatë dhe do të mirëmbajë gjithë veprën dhe tunelin për 10 vjet".**

Opozita: **"Nuk ka transparencë. Kontrata e rrugës së Arbrit është bërë për interesat e Ramës e jo dibranëve".**

Presidenti i Gjoka Konstruksion: **"Pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj, punimet ato do të mbarojnë për dy vite.**

Lexoni në faqen 6-7



Rafting në Dri, potenciali i fshehur i turizmit në Dibër

Faqe 3



NË BRENDËSI: ■ **Gërmimet nëntokësore** të AlbChrome fajësohen për rrëshqitjen masive të dheut në Bulqizë ■ **Festa e qershisë** që pret të kthehet në traditë ■ Krijohet "**Union Lura**", një përpjekje e qytetarëve për t'i rikthyer Lurës lavdinë e dikurshme ■ **Lura** në programin "100 fshatra +" ■ **Jashar Kurti**, shembulli se si suksesi vjen përmes agroturizmit ■ **Profesor** Sabriu ■ **Kujtimet** e një pedagogjikasi ■ Për librin "**Lutfi Ndreu**, mësues dhe artist" ■ **Ku ishe ti** or mec - memec kur digjej e përçudnohej Shqipëria? ■ **Unë** nuk kam turp nga puna ■ **Krijohet** forumi "Të rinjtë e Dibrës" ■ **Mehmet pashë Deralla** në kujtimet e një gjenerali ■ **Gjurmë** lashtësie në Çidhën ■ **Odat** ku prodhohej filozofia popullore ■ **Të jesh grua**, poezi nga Sanije Degjoni Ndreka ■ **Hafiz Visha**, një emër i njohur në mjekësinë shqiptare ■ **Faik Xhani**, 70 vjet jetë aktive me vizion, freski e energji ■ **Humbi** jetën në detyrë, ■ **Dibra** nderon kapitenin e FA ■ Ike o **Besim Daci**, parajsa është jotja! ■ **Xhelal Karoshi**, ushtaraku që kujtohet me respekt nga Jugu në Veri

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (146). Qershor 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit qershor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Besnik ALKU
Eduart RAMÇI
Sami CURRI
Shemsi MANJANI
Bujar KAPEXHIU
Selman MËZIU
Ali HOXHA
Sanie NDREKA
Munir HOXHA
Met DELIU

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Festa e qershisë që pret të kthehet në traditë

Gëzimi për frytin e parë nuk kalohet pa festë. Ishte ky motivi i grupit të festave të ngritur nga projekti “D2T - Dibra: Turizëm dhe Traditë” pranë Zyrës së Informacionit Turistik, me përfaqësues nga Bashkia, institucionet e tjera të qeverisjes vendore, Organizatat Jo-Fitim prurëse, sektori privat dhe vullnetarë e pasionantë.


Ky grupim, me datë 3 qershor 2018, nën koordinimin e Zyrës së Informacionit Turistik Dibër dhe angazhimin e shumë aktorëve mbështetës, organizoi “Festën e Qershisë”.

Veprimtaria synonte të promovonte Dibrën si një destinacion turistik, produktet cilësore dibrane, dhe në veçanti qershinë e Dibrës, e cila është kampione për prodhimin e disa varieteteve dhe me një cilësi shumë të lartë.

Kjo festë është një nga festat e përfshirë në Kalendarin e Festave për Bashkinë Dibër, nëpërmjet të cilave kërkohet të promovohet rajoni i Dibrës dhe të tërheqë vëmendjen e sa më shumë vizitorëve dhe turistëve.

Qindra vizitorë morën pjesë në festivalin e qershisë të organizuar para Pallatit te Kulturës në bulevardin kryesorë të qytetit, ku ishin vendosur tendat e panairit të qershisë dhe prodhimeve të tjera që lidhen me qershinë. Më shumë se 21 pjesëmarrës zbukuruan me prodhimet e tyre bulevardin kryesorë dhe ekspozuan prodhimet e tyre të zgjedhura enkas për këtë panair. Fermerët ishin të kënaqur me punën, me prodhimin e tyre por duhet të bëjnë më shumë për marketingun dhe cilësinë, duke bashkëpunuar më shumë njëri me tjetrin dhe duke pasur një zë më të fortë për tu mbrojtur nga spekulantët e tregut.

Grupi i valleve, grupi i cirkut, grupi i arteve marciale, amatorët e aeronautikës dhe artistët e vegjël animatorë prezantuan me perfomancë artistike e sportive pjesë nga repertori i tyre më i zgjedhur, duke mbledhur shumë fëmijë, prindër dhe vizitorë në shfaqen e tyre. Kjo i dha një atmosferë edhe më festive këtij panairi, duke e kthyer atë në një festival të mirëfilltë.



Qindra vizitorë morën pjesë në festivalin e qershisë. Më shumë se 21 pjesëmarrës zbukuruan me prodhimet e tyre bulevardin kryesorë dhe ekspozuan prodhimet e zgjedhura për këtë panair.

Pajtim Vranici, djali dibran me guxim dhe zemër të madhe, që është “no limit”, me rastin e festës së qershisë fluturoi me logon “Dibra - destinacion Turistik” mbi Peshkopi, nga mali i Zimurit te stadiumi, duke ndezur edhe më shumë atmosferën festive në qytet.

Janë pikërisht këto aktorë që po të bashkohen dhe vendosen në lëvizje, i japin më shumë gjallëri jetës së Peshkopi dhe Dibrën e bëjnë një vend të lakmuar për pushuesit. “Si Dibra s’ka tjetër”, është shprehja më e saktë që mund të thuhet në këtë rast.

Ky panair u mbështet nga projektit “D2T, Dibra: Turizëm dhe Traditë” si dhe nga fondacioni “Friends of Albania” që u kujdesën që festa të ishte shumë e veçantë, sidomos për fëmijët.

Grupi organizator i festave nuk do e lërë vetëm me festën e Qershisë, por së shpejti bëhuni gati edhe për festën e Drinit dhe festën e “Bjeshkës” në Radomirë rrëzë Korabit.

Na ndiqni dhe na vizitoni.

Për më shumë mbi turizmin në Dibër ndiq faqen në Facebook:
DIBRA TURIZËM DHE TRADITË



Me 7 korrik 2018 zhvillohet “Festa e Bjeshkës”, Radomirë Dibër. Një festë lokale, që këtë vit në kuadër të projektit Festat Lokale, synojmë të ketë impakt edhe më të madh, duke iu drejtuar jo vetëm audiencave lokale, por gjithë vendit e më gjerë, me pjesëmarrjen e vizitorëve të huaj, për të patur mundësinë e përjetimit të fshatit shqiptar, zhvillimit të turizmit të eksperiencës në lartësinë e Bjeshkëve, mes mrekullive natyrore që RADOMIRA jonë gëzon.

Në #FestaEBjeshkes do të keni mundësinë të bëheni pjesë e aktiviteteve, përtej atyre çka një festë tradicionale lokale ofron.

Të zgjidhni mes guidave të mirëfillta turistike në zonë; të njiheni nga afër dhe pse jo, të bleni produkte tipike të zonës, origjinale dhe tërësisht organike, si “djathi i luleve”, në panairin e produkteve agro; të kaloni kohë me banorët mikpritës, të inspiroheni nga historitë humane që fshehin Bjeshkët, të sodisni nga afër ” portën “ e malit më të lartë në vend, Korabit, me kullotat alpine dhe burimet e shumta ujore.

Ejani dhe zbuloni në 7 Korrik #QershiaMbiBjeshke!

Kush tjetër?! #FestaEBjeshkes, Radomirë.

turizëm

Rafting fshehur në Dri, potenciali i turizmit në Dibër



Rreth 25 të rinj dhe të reja nisën më 30 qershor 2017 një lundrim në Dri nga Podgorci, 500 m mbi urën e Topojanit deri në Luzni, në një përpjekje për ta kthyer lundrimin në Dri në një sport që do të thithë më shumë turistë në të ardhmen.

Edi Truka, drejtori ekzekutiv i organizates "North Green Association", tha se ky aktivitet kishte si qëllimin kryesor të ndërgjegjësojë komunitetin dhe qeverisjen vendore mbi problematikat që shkaktojnë hedhja e mbeturinave në degëzimet kryesore që derdhen në lumin Drin.

Nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, drejtues të organizatave të ndryshme që operojnë në Dibër, por gjithashtu edhe përfaqësues të Bashkisë Dibër dhe institucioneve të tjera vendore, ishin pjesëmarrës në këtë veprimtari dhe një pjesë e tyre lundruan për të parë nga afër bukurinë e luginës dhe njëkohësisht ndotjen e shkaktuar nga mbeturinat e hedhura nga banorët që jetojnë pranë degëzimeve që derdhen në Drin.

Vozotësit ndaluan në Gradec dhe Hotesh, jo vetëm për të vlerësuar potencialet që ofrojnë këto dy vende buzë Drinit, por edhe për të kryer pastrime e lumit nga mbetjet urbane, kryesisht plastikë.

"Gjatë lundrimit realizuam aksione pastrimi, por në disa zona e kishim të vështirë të vepronim, për shkak të vështirësisë së lundrimit, por gjithashtu edhe të grumbullimit të mbetjeve në degët e shkurreve, të cilat e bënin të pamundur pastrimin e tyre", thotë Edi Truka për gazetën Rruga e Arbërit.

Por kjo veprimtari nuk ka vetëm qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit në rajon me një mundësi të re, siç është lundrimi me gomone në Dri, por edhe ndërgjegjësimin për një mjedis të pastër.

> Ky aktivitet kishte si qëllimin kryesor të ndërgjegjësojë komunitetin dhe qeverisjen vendore mbi problematikat që shkaktojnë hedhja e mbeturinave në degëzimet kryesore që derdhen në lumin Drin.

"Kërkojmë të advokojmë mbi këtë problematikë, sepse lugina e Drinit, përveç florës dhe faunës shumë të larmishme, ofron mundësi zhvillimi ekonomik për zonën me anë të turizmit lumor, si ecje në lumë, peshkim, plazhit lumor dhe sporteve ujore si hydrospeed, rafting, kayaking", thotë Truka.

"Aktivizëm dhe rafting", ishte motoja e kësaj veprimtarie, me qëllimin e dyfishtë: nga njëra anë anë advokimin on mbi problematikën dhe nga ana tjetër zhvillimin e raftingut, një sport aventure që pak lumenj e ofrojnë, duke e promovuar zonën në një zhvillim të mëtejshëm të ofertave turistike që mund të kërkohet në Dibër", thekson Edi Truka.

Truka thekson edhe bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe organizatat që po merren me hapjen e perspektivave të zhvillimit në rajon.

"Në bashkëpunim me Bashkinë Dibër, organizatën 'Dibra: Turizëm dhe Traditë (D2T)', 'ALCDF' e kemi quajtëm këtë si 'Festa e Drinit', me një synim për t'i dhënë një tjetër perspektivë zhvillimi luginës, duke e kthyer në një festë kalendarike në Dibër dhe njëkohësisht të ketë një vëmendje të veçantë për ta mbrojtur bukurinë përrallore që ofron lugina e vendbanimeve më të hershme në Ballkan".

Organizata "North Green Association" edhe në të kaluarën ka zhvilluar disa veprimtari me qëllim një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Ajo kërkon të lartësojë zërin mbi problematikat mjedisore për një të ardhme më të mirë. "Jemi akoma në kohë, po të bashkëpunojmë të gjithë", thotë Truka.

Kjo veprimtari, "Aktivizëm dhe Rafting" në lumin Drin u krye falë mbështetjes të Ambasadës Zviceriane dhe organizatës "Lëviz Albania", në kuadër të projektit "Gjurmë të Gjelbërta për Dibrën".

Krijohet "Union Lura", një përpjekje e qytetarëve për t'i rikthyer Lurës lavdinë e dikurshme

Më 29 qershor, në mjediset e hotel Tirana International në Tiranë është themeluar shoqata "Union Lura".

Në një postim në FB, Abaz Deda, një nga anëtarët themelues të shoqatës, falënderoi në emër të Këshillit Ekzekutiv të Shoqatës, të gjithë anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme, të ardhur nga qytetet dhe zonat në të cilat lurianët kanë ndërtuar jetën e tyre dhe përfaqësojnë denjësisht vlerat dhe traditat e Lurës në këto vende. Në listën themeluese prej 37 anëtarësh spikasin emra të njohur në fushën e biznesit, politikës e gazetarisë, mes të cilëve gjeneral Gjergj Vladit, biznesmeni Dod Doçi, juristi Abaz Deda, botuesit Naim Buci, gazetarit Hekuran Vladi e shumë të tjerë.

Shoqata u themelua vetëm pak ditë pasi Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama vizitoi Lurën, në një etapë të gjatë takimesh e konsultimesh me publikun. Vizita e një kryeministri në vendin e 7 liqenjve, i ka hapur mundësi të reja zhvillimi këtij rajoni dhe duket se krijimi i kësaj shoqate është një përpjekje për ta rilindur Lurën dhe për ta kthyer në një nga pikat me potenciale zhvillimi në të ardhmen. Lura është përfshirë në projektin qeveritar për zhvillimin e turizmit "100 fshatra plus" dhe pritet që krahas ndërtimit të infrastrukturës rrugore, të merren masa emergjente për ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve dhe agroturizmit.

Në statusin e bërë publik, thuhet se qëllimi i shoqatës "Union Lura" është të promovojë vlerat e Lurës si një trevë me histori, të ofrojë mbrojtje ligjore të të drejtave dhe interesave të krahinës së Lurës, lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me personat juridikë publikë dhe privatë, për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut, organizimin dhe/ose pjesëmarrjen në takime, konferenca, simpoziume, kongrese, forume, tryeza të rrumbullakëta, ekspozita, seanca komunikimi të specializuara me pjesëmarrje të një publiku vendas dhe të huaj, bashkëpunim aktiv me organizata të huaja të ngjashme etj.

FOTOLAJM



Anëtarë të organizatës "Ecovolos" zhvilluan në mes të qershorit një lundrim me kanoe në liqenet e Lurës, duke nxitur kështu rritjen e turizmit në këtë rajon. Ened Mato, drejtuesi i Ecovolis, përmes një postimi në Twitter, citoi një thënie të Gjergj Fishtës, se "Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë"! Mato e cilëson Lurën si një Perlë! "Natyra e gjallë më e bukur në botë! 7 Liqene, 7 Mrekulli! Ta mbrojmë Lurën! Ta duam Lurën!", shkroi ai në Twitter, duke përcjellë edhe disa foto nën hashtagun #VizitoLurën #LiqenetELurës, njëra prej të cilave është fotoja shoqëruese.

Anëtarët e kësaj organizate i kërkuan Kryeministrit Rama gjatë vizitës së tij në Lurë që të shihte mundësinë e rregullimit të rrugës për te liqenet, pasi vetëm kështu mundësia për zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e kësaj pasurie nga djegiet dhe prerjet do të bëhej e mundur.

Rruga e Arbërit nr. 146

Ditari i Udhërrëfyesit:
Marshim gjatë shtegut Korab-Koritnik

reportazh

Shtatë ditë maleve, nga Grazhdani deri në Shishtavec



Nga **GREHANS UKA**

Të mbash ditar gjatë një udhëtimi me grupe turistësh është një ndër gjërat më interesante dhe e rëndësishme për çdo udhërrëfyes. Më interesant bëhet kur atë e ndan me të tjerët duke iu treguar për përvojën personale dhe të tjerëve. Kjo nxit dhe iu tregon të gjithëve një mënyrë për të përjetuar natyrën.

DITA E PARË, 12 QERSHOR 2018: MAQELLARË - STANET E HINOSKËS

Me grupin që do të shoqëroja u takuam në Maqellarë, dhe ecjen e filluam në orën 9:30 nga Grezhdani, një fshat historik, 700 m mbi nivelin detit. Gjatë rrugës po njiheshim me pjesëtarët e grupit. Ishin Manfredi dhe Elisabeta, çifti gjerman, me profesion mësues; Alles, vajza nga Londra që punonte mjeke dhe Antoni, guida nga Shkodra që kish ardhur me qëllim për të mësuar shtegun Korab-Koritnik, si pjesë Shtegut të Sharrit.

Ecjen e vazhduam drejt Popinares, një fshat karakteristik me gurë, i shtrirë rrëzë Malit të Velivarit, 1300 metra mbi nivelin e detit. Dalëngadalë vazhduam drejt bjeshkës në Popinarë. Sa herë kthenim kokën pas, dilte përpara syve të gjithë lugina e Drinit të Zi dhe fushën ku shtrihej Dibra e Madhe përtej kufirit. Në horizont dukej edhe Liqeni Radikës, Malet e Gollobordës apo dhe Malet që janë pjesë parkut Lurës. Tek stani i Iliaz Kërçakut nga Bllata, fillojmë ngjitjen drejt kreshtës së Velivarit për t'u kthyer drejt bjeshkës së Hinoskës. Ishte ngjitje e lehte qe na nxori tek stanet e Trepçës. Kalimi tek Kulla e Turkut ishte një rrugë interesante mes pyjesh.

Tek Stanet në Hinoskë, mikpritja iu la mbresa turistëve dhe e vlerësuan shumë

DITA E DYTË, 13 QESHOR 2018: BJESHKËVE TË RABDISHTIT E ZAGRADIT

Nisja nga Hinoska filloi në orën 9 të mëngjesit. Dalëngadalë, sëbashku me grupin u afruam në lartësinë 2050 m që kalonte në vijën e kufirit. Pamja ishte e shkëlqyer dhe turistët e shfrytëzuan për fotografitë, ngaqë është edhe kufiri ndërshtetëror Maqedoni-Shqipëri. Grupi e pëlqeu shumë këtë pikë, sepse të ofronte pamje në të dy anët e kufirit. Me ndalesa të shkurtra deri në orën 12:30, arritëm mbi bjeshkët e Rabdishtit dhe Zagradit. Zbritja nga bjeshka dukej interesante, sepse shtrirja e fshatrave Zagrad dhe Rabdisht rrëzë dy shpateve gëlqerore dhe arkitektura e shtëpive në përshtatje me mjedisin përreth, ishte një pamje mbreslënëse.

Rrugës takuam Nazmi Ndreun, që mblidhte bimë mjekësore. Ndërsa ndalesa e radhës është në shtëpinë e Ylber Fetës, ku kaluam një natë për tu mbajtur mend.

DITA E TRETË, 14 QESHOR 2018: NJË NATË NË STANET E GRAMËS

Nisja në ditën e tretë filloi në orën 8:30 nga Zagradi, në një lartësi 1200 metra mbi nivelin e detit. Grupit i pëlqeu ngjitja dhe peizazhi, gjithashtu. Sidomos kur po i afroheshim Majës së Gramës. Ishte një ecje e lehtë për grupin dhe me pamje të mrekullueshme. Panorama që kishim përpara e detyroi grupin disa herë të ndalonte për fotografi. Patëm një zbritje të butë dhe interesante, sepse përpara kishim një kope me dhi të egra. Gjatë zbritjes, një shi i fortë filloi, por për fat ishim afër stanit ku do të qëndronim.

Grupit i pëlqeu shumë mjedisi dhe shtëpizat e drurit që ne do të qëndronim, si dhe mikpritja që Xhemali bëri. Madje ai bëri të mundur që grupi të shikonte nga afër jetën baritore, apo dhe mjeljen e deleve që bënin çobanët. Kjo ishte diçka interesante, sepse çdo proces i punës bëhej në mënyrë tradicionale.

DITA E KATËRT, 15 QERSHOR 2018: DREJT RADOMIRËS

Mëngjesi filloi me një ngjitje që të krijonte idenë e të pamundurës, por gjithçka filloi të dukej e thjeshtë. Pas çdo hapi shtëpizat e drurit zvogëloheshin dhe dukeshin si të rrëzuara nën masivin shkëmbor që rrethon gjithë bjeshkën.

Po lëviznim në drejtim të liqenit të Gramës dhe po shijonim peizazhin piktoresk. Duke kaluar qafën, mes Bjeshkës së Gramës dhe Bjeshkës së Shehit, filloi të binte shi. Kjo na detyroi të lëviznim më shpejt këmbët, dhe kur iu afruam fshatit, shiu pushoi. Një mjegull mbuloi vendin dhe nuk na krijonte mundësinë të shihnim gjelbërimin e paanë.

Në Radomirë, njerëzit na pritën mirë dhe çdo sjellje e tyre na ngrohte përbrenda. Duke pirë çajë mali dhe duke parë ndeshjet e botërorit, është një gjë e rrallë për miqtë. "Kurrë nuk e kishim menduar se do ta shikonim ndeshjen Portugali-Spanjë mes malesh, me një gotë çaji përpara", thanë ata. Shiu i paradites u harrua.



DITA E PESTË, 16 QERSHOR 2018: NGJITJA E PAMUNDUR PËR NË KORAB

Në orën 7:40 filluam ngjitjen për në malin e Korabit, së bashku me Antonin dhe Alesian, mjeken nga Anglia. Por koha nuk ishte në favorin tonë. Mjegulla e dendur, shiu që binte herë pas here dhe bora në lartësinë 2500 metra, na e pengoi ngjitjen. Për shkaqe sigurie, vendosëm të kthehemi. Gjatë rrugës shikuam disa liqene të mbuluara me një shtresë akulli, të cilat na tërhiqnin vëmendjen. Rrugës takuam Avni Kupën, çoban i zonës me një tufë të madhe delesh e qingjash.

Manfredi dhe Elisabeta, çifti nga Gjermania, qëndruan në hotel, por tregonin se kishin kaluar kohë të mirë me banorët e Radomirës. Ata ishin treguar shumë miqësor me ta. Arkitektura e shtëpive dhe dashamirësia e mikpritja e banorëve ishin krejt të veçanta.

DITA E GJASHTË, 17 QERSHOR 2018: NË ÇAJ TË KUKËSIT

Korrektësia gjermane e Manfredit dhe Elisabetës nuk vihej në dyshim në grup. Me ta, përgatitja e grupit për udhëtim të krijonte përshtypjen se gjithçka bëhej në kohën e duhur. . Në orën 8 filluam nisjen për në Çaj, 1600 metra mbi nivelin e detit. Gjatë rrugës u takuam me një grup nga Kosova që ngjiteshin për në Korab. U ngjitëm në Fushën e Korabit (1500 m) dhe rreth orës 11 ishim në Qafën e Sorokolit, 2000 metra mbi nivelin e detit, aty ku ndahet Dibra me Kukësin. Kishim dy zgjedhje për rrugën: ose të vazhdonim rreth kufirit me Kosovën, ose të vazhdonim luginës poshtë, e quajtur ndryshe edhe si "Përroi i Lushit". Zgjodhëm versionin e dytë, pasi na u duk më lehtë, por rreth orës 12 filloi një shi dhe mjegull, duke e na vështirësuar ecjen. U lagëm, por rikthimi i diellit pas dy orësh dhe ndalesa për drekë, na ngrohen pak duke na sjell edhe një farë gëzimi.

Miqtë vlerësuan shumë terrenin, për larmishmërinë e thyerjeve, bimësinë, sidomos



lulet. Gjithashtu, iu pëlqeu shumë bujtina e ndërtuar në mënyrë tradicionale e Ardian Musait. Dhomat e rregulluara thjesht, por veçanërisht familja e madhe dhe harmonia mes tyre, janë diçka që vlerësohen shumë nga mësuesit gjerman dhe mjekja angleze.

DITA SHTATË, 18 QESHOR 2018: NË SHISHTAVEC

Kur nisesh nga Çaji për në Shishtavec, duhet të kalojmë përmes një gryke, e cila është shumë interesante. Sepse, pavarësisht se ngjiteshe në lartësi, nuk arrije ta kuptoje ngjitjen. Pas 3 orë e gjysmë udhëtimi, afrohemi në Kallabakun e Madh e të Vogël. Ardiani, mikpritësi ynë në Çaj, na shoqëroi gjatë gjithë udhëtimit. Në momentin që arrijmë në Kallbak, fillojmë zbritjen te vendi i quajtur "Laku Kallabakut". Rrugës poshtë shohim fshatin Turaj. Më pas shfaqen fshatrat Novosejë e Shishtavec, e diku me poshtë duke rezervati dhe disa ndërtesa të ndërtuara që në kohën e komunizmit.

Dalëngadalë, përmes rrugës së makinës ndërtuar kohë më parë dhe e pa përmirësuar, afrohemi te Kafja e Mahmut dhe Fatos Nokës. Ora shënonte rreth 14. Aty bëmë pushimin e drekës, në pritje të makinës. Në atë vend dikur kishte qenë pike qëndrim për minatorët e minierës së kuarcit që ndodhej poshtë malit të Kallabakut. Me ndërrimin e sistemeve politike, dy vëllezërit Noka e kishin privatizuar dhe e kishin shndërruar në bar-kafe për ata që vizitonin liqenin. Ndërsa tani po investonin për ta kthyer në një qendër turistike.

Në Shishtavec na pret Adem Sokoli. Shtëpia e tij pritëse është e rregulluar dhe e pastër. Ndërsa Ademi tregohet shumë mikpritës. Na ofron një filxhan me kafe turke dhe një gotë raki. Ndërsa Manfredi nuk heziton të provojë bakllavanë. Ademi tregoi se gatimet i bënte vetë, si dhe ishte vlerësuar edhe si "Kuzhinieri më i mirë" për kuzhinën tradicionale. Bakllavanë që Manfredi e provoi, ishte e gatuar prej tij. Për anëtarët e grupit ishte një surprizë: një burrë shqiptar mund ta gatuante atë lloj ëmbëlsire..

Nga shtëpia që do të qëndrojmë duken Kallabaku, bjeshka Moravës dhe Guri i Mëngjesit mbi Restorant Skiatorin. Ademi tregon që është e thjeshtë të shkosh nga bjeshka e Moravës drejt Gurit të Mëngjesit Skijatori; dhe duke ndjekur shenjat e vendosura për shtigjet, mund të kalosh nëpër Kosovë dhe del mbi Tetovë. Por ky shteg mbetet për tu provuar herës tjetër.



Lura në programin "100 fshatra +"



Nga **EDI RAMA***
Kryeministër i Shqipërisë

Është hera e parë që unë vij këtu. Lurën e kam parë siç e kanë parë shumë shqiptarë, nga kartolinat, nga kalendarët e vitit edhe nga shumë pamje që dikur jepeshin dhe shfaqeshin për të treguar një mrekulli të natyrës. Më pas e kam parë, siç e kanë parë dhe shumë shqiptarë, me ato skenat e tmerrshme të shkatërrimit.

Sot jemi këtu për të hapur një kapitull të ri, duke qenë se qeveria ka një program të posaçëm për Rilindjen Rurale, për rilindjen e fshatit, një program që nis me krijimin e 100 modeleve. 100 modele në 100 fshatra të ndryshëm të Shqipërisë, nga veriu në jug, ku përfshihet, nuk diskutohet, edhe Lura dhe ku synohet që të orientohen burimet natyrore, burimet njerëzore drejt një zhvillimi shumëplanësh.

Ka shumë fshatra Shqipëria që janë të jashtëzakonshëm për nga bukuria e natyrës, që janë të jashtëzakonshëm për nga historia dhe për nga tradita e mikpritjes, por që, siç është këtu, janë shumë larg rrugës së tregut për të mundur të krijojnë një zhvillim intensiv bujqësor apo blegtoral.

Pyetja është çfarë mund të bëhet në këto kushte? Përgjigja është shumë e thjeshtë. Përgjigja është që, në vend se të synohet e pamundura dhe në vend se njerëzit të stërmundohen duke punuar nga momenti kur del drita, deri në momentin kur bie errësira për të prodhuar në bujqësi, apo në blegtori dhe thjesht për të mbijetuar duke i marrë prodhimet me çantë e duke dalë te rruga për t'i shitur, – të kthejnë sytë nga miniera e jashtëzakonshme e bukurive natyrore dhe e trashëgimisë historike e kulturore dhe t'i drejtohen agroturizmit.

Nëse dikush jeton në një shtëpi siç janë shumë shtëpi këtu që janë vërtet të jashtëzakonshme, sepse kanë një karakteristikë, kanë një histori, pavarësisht se për shkak të varfërisë janë bërë ndërhyrje që i kanë dëmtuar në integritetin e tyre, çfarë mund të bëjë, si mund t'ia dalë që me punën e vet të nxjerrë të ardhura për të jetuar normalisht?

Çfarë mund të bëjmë për bujqësinë, çfarë mund të bëjmë për blegtorinë, duke pasur një rrugë që është një skëterrë e vërtetë për më tepër dhe duke pasur një distancë kaq të gjatë nga tregu më i parë?

Sa i kushton një familjeje që jeton në një situatë të tillë dhe situata të tilla ka plot Shqipëria që të investojë të gjithë mundin dhe djersën e vet për të prodhuar domate, patate, apo qepë dhe pastaj për të dalë deri poshtë në treg?

Kush është ai sipërmarrës, kush është ajo kompani grumbullimi i produkteve që do ndërmerrte aventurën që të organizonte automjete për të ardhur deri këtu dhe për të mbledhur ato pak prodhime që mund të ishin?

Askush. Pra, mundësia për të dalë nga këtu në treg është minimale, për mos thënë nuk ekziston.

> Unë besoj shumë që agroturizmi është një mundësi e madhe dhe një potencial i jashtëzakonshëm që ne nuk e kemi fare të shfrytëzuar dhe që duke e shfrytëzuar një gjë është e sigurt, dalin nga varfëria të gjitha familjet që e bëjnë.

> Ajo që unë ju them është që ne nuk do ta lëmë rrugën pa bërë... Ne kemi filluar të mendojmë për këtë, se ndryshe mbase nuk do kishim ardhur sot këtu, ashtu sikundër paralelisht kemi filluar të mendojmë për të bërë një hap për restaurimin e këtyre shtëpive, për të ndihmuar banorët që shtëpitë të mos degradohen për shkak të pamundësisë për të bërë restaurimet, apo për t'i bërë riparimet siç duhen bërë.

Por ka një mundësi tjetër, për ta bërë tregun të vijë këtu dhe jo tregun e domateve e të patateve, por tregun e turizmit. Ka një mundësi tjetër, për t'i bërë njerëzit të vijnë nga Tirana, nga e gjithë Shqipëria dhe nga Europa këtu, ta marrin ata rrugën, t'i bëjnë ata shpenzimet e karburantit dhe këtu të gjejnë pikërisht atë që nuk e gjejnë diku tjetër këtë bukuri përrallore, këtë histori të veçantë, këtë traditë dhe këta njerëz dhe të mund të shijojnë diçka që nuk e gjejnë në një vend tjetër, jo se në vende të tjera nuk ka, – ka patjetër, por ka histori të tjera, ka arsye të tjera, padiskutim, – por historinë e Lurës e gjejnë vetëm këtu, nuk e gjejnë dot diku tjetër.

Unë besoj shumë që agroturizmi është një mundësi e madhe dhe një potencial i jashtëzakonshëm që ne nuk e kemi fare të shfrytëzuar dhe që duke e shfrytëzuar një gjë është e sigurt, dalin nga varfëria të gjitha familjet që e bëjnë. Nuk ka asnjë mundësi që të jetosh me agroturizëm dhe të jesh i varfër. S'flasim për të pasur, – nuk diskutohet që ata që organizohen dhe që krijojnë zinxhirë të ndryshme bujtinash etj. etj. mund të bëhen dhe të pasur, – flasim për një jetë normale. Flasim për një jetë që të jep më shumë të ardhura sesa puna në shtet, apo sesa puna në privat individualisht.

Për më tepër, unë jam i bindur që duke hapur rrugën e zhvillimit të agroturizmit, do të ketë me mijëra e me dhjetëra mijëra emigrantë që do kuptojnë se duke investuar paratë, bashkë me familjen, bashkë me ata që kanë mbetur këtu, ose në shtëpinë e gjyshërve dhe të prindërve do fitojnë nga aktivitetet më tepër sesa fitojnë duke punuar atje ku janë si punëtorë në Greqi, apo në Itali, apo qoftë edhe si biznesmenë të vegjël...

Me rrugën aktualisht sot nuk mund të pretendohet kjo që po them. Patjetër që këtu vijnë turistë edhe sot, se unë i pashë, më zunë sytë disa njerëz që duket që s'janë që këtu dhe që kanë ardhur për turizëm, por janë shumë pak për të pretenduar këtë që po flas, sepse kjo rrugë kërkon vërtet aventurierë për të ardhur deri këtu, ose hallexhinj që s'kanë çfarë të bëjnë, siç jeni ju, që doni, apo nuk doni atë rrugë do përdorni. Pra, duhet që ne të investojmë për rrugën dhe kjo na bëhet kafshata e dytë e madhe për buxhetin, se qenka e thënë që të gjitha kafshatat e mëdha ne t'i gëlltisim këtu në Dibër, se Rruga e Arbrit është e bukur për t'u thënë, është shumë e bukur për t'u bërë, por është një kafshatë shumë e madhe për t'u gëlltitur nga buxheti shteti. Edhe kjo rrugë është e bukur të thuhet dhe e bukur të bëhet, por nuk është kafshatë e lehtë, sepse kërkon një fond të konsiderueshëm dhe sigurisht që ajo që kthen mbrapa është shumë e madhe, po ashtu.

Sidoqoftë, ajo që unë ju them është që ne nuk do ta lëmë rrugën pa bërë...

Ne kemi filluar të mendojmë për këtë, se ndryshe mbase nuk do kishim ardhur sot këtu, ashtu sikundër paralelisht kemi filluar të mendojmë për të bërë një hap për restaurimin e këtyre shtëpive, për të ndihmuar banorët që shtëpitë të mos degradohen për shkak të pamundësisë për të bërë restaurimet, apo për t'i bërë riparimet siç duhen bërë.

Kemi një fond që do ta vëmë në dispozicion. Unë e falënderoj Dod Doçin. Atij në fakt i takon të jetë këtu se dhe kompaninë e ka me ermin "Lura" dhe deri tani për Lurën vetëm emrin e kompanisë së vet ka vënë, s'ka bërë asgjë tjetër, por nuk ka pasur dhe çfarë të bëjë se nuk mund të bëjë dot një kompani atë që po diskutojmë nëse nuk përfshihet shteti, nëse nuk përfshihen dhe të tjerë, etj, etj, kështu që edhe me kompaninë e Dodës ne do komunikojmë për të bërë të mundur si fillim njëherë projektin. Pastaj do shikojmë menjëherë paralelisht të fillojmë një punë, siç kemi bërë për Vunoin, siç kemi bërë për Dhërmiun, që kemi investuar ne për të rimëkëmbur shtëpitë e vjetra, edhe këtu të investojmë pasi të identifikojmë të gjitha shtëpitë karakteristike dhe që janë të vjetra për t'i rindërtuar dhe riparuar siç duhet jo disa me çati të kuqe, disa me çati të verdha, por siç kanë qenë çatitë karakteristike dhe në të njëjtën kohë të shikojmë mundësinë e krijimit të një rrethi njerëzish autoktonë këtu që janë në Tiranë, apo që janë jashtë shtetit që kanë dëshirë të vijnë dhe të investojnë shuma të vogla në shtëpitë e tyre, ose shuma pak më të mëdha për të ndërtuar bujtina, apo hotele.

Ky vend në një 10-vjecar mund të bëhet destinacion europian. Kjo nuk diskutohet, sepse mundësitë e natyrës i ka të jashtëzakonshme. Edhe traditën dhe historinë e ka të jashtëzakonshme, por duhen disa gjëra dhe këto gjëra do bëhen së bashku...

(Botuar me shkurtime. Të plotë mund ta gjeni në linkun: https://kryeministria.al/newsroom/lura-ne-programin-100-fshatra/)

Fjala e Kryeministrit Edi Rama në Peshkopi dhe Klos me rastin e çeljes së punimeve për Rrugën e Arbrit

Kryeministri në Klos: Gjetëm një projekt që kushtonte shumë më tepër



Kryeministri: Rruga e Arbrit është një çështje drejtësie!

Është e vërtetë, 550 vjet pas ndarjes nga jeta të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit që vjen prej Dibre, për të ardhur në këto fushëbeteja epike të Dibrës, ku u shkrua dhe fati i kombit tonë, shpesh, edhe pse sot shkohet e vihet me makinë, duket sikur shkojmë e vijmë me gomar, sepse rrugët ekzistojnë, por janë në gjendje të mjerueshme. U lanë rrugëve për 20 e kusur vite dhe nëse do të ishin bërë gjërat me mend, me projekte dhe me radhë, Rruga e Arbrit do të kishte përfunduar të paktën 10 vjet më parë.

Por, fatkeqësisht, qeveria që e premtoi me më shumë fuqi e me më shumë ulërima se të gjitha të tjerat, jo që nuk e përfundoi, por vetëm sa e pick-oi, siç bëri në të gjithë Shqipërinë, duke na lënë ne barrën që t'i bëjmë rrugët, por duke lënë mes nesh dhe rrugëve një gropë të madhe borxhesh.

Për Rrugën e Arbrit, në marrjen e mandatit gjetëm 5 kontrata me vlerë 2.6 miliardë lekë, por i gjetëm faturat në tavolinë. Asnjë kokërr leku të paguar. Rruga nuk diskutohet që nuk dukej asgjëkund. Dukeshin vetëm gjurmët e atyre festave me daulle e me shirita për ato inaugurimet për t'i hedhur hi syve kësaj dynjaje.

E njëjta situatë ishte kudo dhe këtë dua ta përsëris për të gjithë ata që kujtojnë se të bësh një rrugë është njësoj si të shkruash një koment në Facebook, – e mendove, e bëre. Ndërkohë që të bësh një rrugë do të thotë të projektosh, do të thotë të gjesh financimin, do të thotë të ndërtosh kontrata dhe të kesh një supervizim serioz. Asnjë nga këto të katërta nuk bëheshin derisa ne morëm detyrën.

Projekte copë-copë, si projekti i Rrugës së Kombit, që sot jeni ju dëshmitarë, janë të gjithë shqiptarët dëshmitarë, që na sjell lajme me masivë dheu që bien në rrugë e me shkëmbinj që shkëputen e rrezikojnë jetën e njerëzve. 37 pika kërcënimi për sigurinë ka ajo rrugë, e projektuar në këmbë dhe e ndërtuar shkel, shko, bjeri daulleve dhe ik...

Për Rrugën e Arbrit, ne gjetëm një projekt që kushtonte shumë më tepër se ky dhe që ishte mizerje, me tunel pa tub emergjence. Gati 3 kilometra tunel për t'i futur njerëzit brenda, pa iu lënë mundësi të dalin, nëse ndodh, largqoftë, ndonjë hata. Është e ndaluar në të gjithë botën, edhe në Afrikë, të ndërtosh 3 kilometra tunel dhe të mos kesh dalje emergjence. Po ashtu, kjo rrugë bën dyfishin e punëve, bazuar në projektin e ri dhe më e bukura për ju është që lidh edhe Klosin...

Ndërsa brenda kësaj periudhe që ne do të ndërtojmë rrugën, ju do të shikoni që do të ketë një urë nga njëra anë e tunelit, 220 metra, 150 metra e lartë dhe një urë tjetër nga ana tjetër e tunelit, matanë, po kaq dhe Klosi do të lidhet me Tiranën për 30 minuta, Bulqiza për 40 minuta, Burreli për 60 minuta dhe Peshkopia që është pak më larg, përsëri do jetë shumë më afër, 80 minuta Distanca që ishin të paimagjinueshme, por që ama do përshkohen si zotëri, jo si shofer ku Benz-i të duket si mushkë kur vjen këtu. Edhe kur zbret nga vetura, të duket sikur ke zbritur nga mushka....

Miqtë e mi, unë ju falënderoj të gjithëve këtu. Më vjen shumë keq për të gjithë torturat e pafundme. Do kisha dashur dhe do kishim dashur t'i bënim më shpejt këto punë, por veprat publike dhe punët e qeverisë nuk janë si komentet në Facebook që bëhen shpejt, – prandaj dhe unë bëj shumë komente se bëhen shpejt. Janë punë komplekse që kërkojnë angazhime të mëdha dhe kërkojnë kohë dhe durim. E di që durimi është malli më i shtrenjtë sot në Shqipëri, se gjithë këto vite, duro e duro, iu ka ardhur të gjithë njerëzve në majë të hundës, por vetëm mos më ngatërroni mua me 20 e ca vjet përpara sesa të merrja detyrën. Për çfarë mbaj përgjegjësi dhe mbajmë përgjegjësi, jemi gati të mbajmë përgjegjësi.

Gabime kemi bërë dhe do bëjmë sepse punojmë, por faje ndaj këtij vendi, kurrë, kurrë! Sepse, siç e nisa me një shprehje të heroit tonë kombëtar dhe po e mbyll me këtë shprehje që për mua është një nga motivet e punës time; Çfarëdo që të ndodhë, unë do të jem mik i virtytit dhe jo i fatit dhe deri në fund do bëj bashkë me të gjithë shokët dhe shoqet e armëve, gjithçka mundemi që të fitojmë kohën e humbur për dekada. E duke shpresuar që durimi që është malli më i shtrenjtë do të gjendet në atë tregun e komuniteteve të debatit e të diskutimeve, na shani sa të doni, vetëm na doni sa të mundeni.

(Fjala botohet me shkurtime. Të plotë mund ta lexoni www.kryeministria.al)

Duke ju parë këtu sot të mbledhur në këtë krahinë të Shqipërisë, që Shqipërisë i ka qenë djep dhe mburojë dhe shqiptarizmës oxhak dhe orakull, vetvetiu më vjen si jehonë një ngashërim në ngazëllim. Më vjen si jehonë, përjetimi i përflakur në mall e mallëngjim i një tosku të pavdekshëm të cilin Dibra zemërbardhë dhe zemërmadhe e birësoi si djalë dhe si shehid të bëmave të saj kombëtare.

"Ndodhesha në Dibër, – kujton Abdyl Frashëri, sipas dëshmisë së sjellë prej arbëreshit Anselmo Lorecchio, – përpara një mizërie njerëzish që më dëgjonin. U tregoja atyre se e ardhmja jonë varej nga bashkimi ynë si shqiptarë. Ja, ju keni ardhur këtu që të vendosni për diçka me rëndësi të madhe dhe keni ardhur këtu të armatosur deri në dhëmbë, kurse armët i mbani në krahë fisnikërisht që t'i përdorni për të ngrënë kokat e vëllezërve tuaj! Vëllezër, vetëm po të vëllazëroheni ngushtë me njëri-tjetrin, ju mund të shpëtoni jetën e nënës tuaj të përbashkët, Shqipërisë".

"Nuk kisha mbaruar akoma së shqiptuari fjalën e fundit, – vazhdon Abdyl beu – kur u ngrit një uturimë e madhe që më bëri të dridhem, por një çast më pas u ngashëreva derisa më shkuan lot në sy kur pashë tërë atë mizëri që me një lëvizje prej vetëtime hodhën në tokë armët dhe po shtrëngonin me njëri-tjetrin duart e djathta, si miq të vërtetë!"

"Në këtë tokë të bekuar, dëshmitare dhe dëshmidhënëse të një përkushtimi kaq të madh Frashërlliu qau si fëmijë, – kujton shkruesi i këtyre kujtimeve, – tek pa malësorët gegë të fortë si malet të përqafoheshin si vëllezër". Këtu janë përlotur brenga dhe bëma nga më domethënëset e shqiptarisë, ashtu sikundër edhe janë buzëqeshur.

Nga lufta e Gjoricës te kuvendi i Qernanicës, për të drejtën e të qenurit zot në vend të vet, te kongreset e panumërta për të shpallur se Shqipëria është një me myslimanë e të krishterë, me vegjëli e shehlerë, nga mësonjëtoret e Said Najdenit dhe bibliotekat e Hoxhë Moglicës, Maliq Tanushës dhe Kurt Ballës te vizioni i një Iljaz pashë Çoku, një Vehbi Agolli, një Haki Stërmilli, një Sherif Langu e një Dom Nikoll Kaçorri, e nga trimëritë e Cen Lekës, Sheh Zerqanit, Haxhi Vildan Dibrës, Sheh Halim Reçit, tek vetëmohimi i Elez Isufit e Dali Ndreut, Dibra e zemrës së madhe dhe e sofrës së përbashkimit dëshmon si dje, si mu këtu sot, se është vatra gjithmonë e ndezur e nëntë maleve të trimërisë e të vëllazërisë shqiptare.

Kjo kokore natyrore dhe dokësore me nëntë dyer të gurta e të blerta të një urtësie që nuk e rrudhin as koha dhe as sprovat janë kurora që naltëson sot e kurdoherë yllin e mëngjesit të mbarë kombit shqiptar, birin e kësaj treve, Gjergj Kastriotin Skënderbeun.

Është privilegj i madh për mua të jem në Dibër në muajin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, e cila konakun e vet e pat më së shumti këtu, në Dibër dhe ku prej koritjes e shantazheve e patën mbrojtur me gjak dibranët trima Sul Zerqani e Iljaz Dibra, Isuf Doda e Karahasanët, Llan Kaloci e Hoxhë Moglica, Azis Sadiku, Seid Daci, Ymer Lutfiu e shumë e shumë të tjerë, por edhe në këtë Vit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit, dibranit dhe shqiptarit pa asnjë të sharë...

Skënderbeun dhe besëlidhjen 140-vjeçare ne nuk deshëm dhe nuk duam t'i shohim dhe t'i kremtojmë me daulle ceremonish.

I deshëm për vendin, i dëshiruam fort për Dibrën. I deshëm fort me përparësi, aq sa pa ngurrim i identifikuam me ëndërr e përpjekje, me durim e me pune, për t'ia lidhur më në fund edhe më shumë brezit të kombit, një vizion që do të jetë tanimë një realitet duan, s'duan ata që sot e gjithë ditën vazhdojnë të tallen dhe të përqeshin dhe nuk do të jetë më një iluzion, Rruga e Arbrit.

Kjo krahinë fisnike që aq shumë dha për atdhe, fe e flamur, me përçapje, me stërmundime, me vendime të rëndësisë kombëtare, për të cilat Abdyl Frashëri shkruan se, deri në Berat e thellë në Toskëri lidhën në një trup të vetëm myslimanë e të krishterë, rresht sot e përgjithmonë së qënuri skaj e gërxh, fatkeqësisht qoshe e harruar dhe periferi. Prej sot, vëllezër e motra dibrane, Dibra fillon rrugën, pjesën e fundit të një rrugëtimi prej dekadash e dekadash për t'u bërë një cope kraharor që rreh jetë dhe zhvillim në Shqipëri dhe për Shqipërinë!...

Pse rruga e Arbrit na qenka një çështje më vete dhe pse është në fakt një çështje kombëtare, duhet më mirë me thënë?

Sepse, për të gjithë ata që na dëgjojnë, se këtë ju e dini, për çdo shqiptar e bashkëkombës, kudo që është, Rruga e Arbrit është një çështje drejtësie! Drejtësi e historisë, po aq sa drejtësi njerëzore ndaj një populli të tërë të kyçur këtu brenda në izolim prej kaq shumë e shumë dekadash. Drejtësi që shteti shqiptar ka detyrën absolute dhe shtrëngim moral ta vërë dhe ta garantojë një herë e përgjithmonë!

Kush pak e njeh Dibrën, e di fort mirë që sado kjo krahinë është e rrethuar nga të katër anët me male, ajo nuk është, siç kanë pretenduar, ose siç kanë dashur ta shohin zuzarët dhe dallkaukët e çdo kohe, në izolim gjeografik nga pjesa tjetër e Shqipërisë apo nga viset shqiptare jashtë kufijve të Republikës.

Vetë natyra e ka pajisur këtë zone në 6 pika me gryka të ngushta që e lejojnë komunikimin mes trevave. Rruga e re e Arbrit do të rigjallërojë këto shtigje me të cilat Dibrën e bekoi Zoti, por të cilat Dibrës ia mbylli robi. Rruga e Arbrit do të ndjekë vijën e karvaneve që ka lidhur historikisht Dibrën me kryeqytetin. Prej qafës së Murrës e asaj të Buallit që lidh me bregdetin, grykës së Setës që të hedh në Shkodër, asaj të Radikës dhe të Drinit që hap Maqedoninë, Dibra gjithkahera ka patur vokacionin e një rrjeti komunikimesh mes bashkëkombësve dhe fqinjëve, gjithkahera, fatkeqësisht, të penguar e të vonuar, që nga pushtimet më të hershme e deri tek paudhësitë më të mbrame.

Rruga e Arbrit dhe sorollatjet e një krahine të tërë kanë qenë veç korija që fshehu për shumë kohë pyllin e makutërisë me tymnaja premtimesh e tam-tame inaugurimesh në tym. Por ka edhe më keq, për të qeshur e për të qarë dhe për pak sa nuk e qamë edhe rrugën e Arbrit. Edhe dëgjojeni për rrugën e Arbrit e ta dëgjojnë të gjithë, që na ka rokanisur kokën "pse nuk fillon, pse nuk fillon. Pse u vonua? Po gënjeni!" Kishte lënë një projekt, 300 e kusur milionë euro, një aventurë shqiptaro-kineze me rrugën e Arbrit. Pa buxhet, por peshqesh në formë vrimash në xhepat e gjithë shqiptarëve, premtim – zhgënjim pas premtim – zhgënjimi.

Na u desh ta negocionim atë marrëveshje me shpresë se do ta ulnim atë çmim deri sa humbëm kohë, por bëmë gjënë e duhur, e anuluam, jo vetëm për shkak të kostos, por dhe të produktit.

Sot, rruga që ndërtojmë, kushton me gjithë mirëmbajtjen 10 vjet, me gjithë operimin e tunelit, vetëm 250 milionë euro.

Dhe mirë që kushton më pak, por çudia është që standardi i parashikuar prej inxhinierëve të Saliut ishte C3, më i ulëti. Ndërsa ai i sot është C2. E dini çfarë do me thënë? Me projektin e Saliut, do hynit në tunel rrugor, – le që nuk do bëhej ndonjëherë, – por do hynit në tunel rrugor pa tub emergjence. A e imagjinoni dot 3 kilometra tunel pa tub emergjence dhe jashtë të gjitha normave europiane? Rruga ishte tamam si gjarpër që rrotullohej e rrotullohej në pjerrësi ekstreme dhe zona malore me lartësi të pastudiuar, aty ku janë ngricat gjithë kohës, në mëshirë të rrebesheve dhe pa mbrojtje skarpatesh, njësoj si rruga e kombit.

Rruga e kombit që sot diskutojmë, ka 37 pika rreziku për jetën, ku mund të bjeri nga sekonda në sekondë masivi i dheut sepse nuk u ndërtua me masa mbrojtëse. Kështu ishte dhe projekti i rrugës së Arbrit. Rruga do ishte pa kokë, sepse nuk kishte segmentin 1.1 kilometër që e lidh me Tiranën. Do arrinit deri atje dhe pastaj duhet të linit makinat e të merrnit kuajt e Saliut për t'u futur në Tiranë. Por rruga nuk kishte as bisht sepse 9.1 kilometra që e lidhin sot me doganën e Bllatës nuk ishin.

Me fjalë të tjera, 300 milionë euro borxhe për ta bërë këtë arterie jetike një shteg në mes të dy anëve që do ngeleshin siç janë sot. Si në kohën e rrugës së karvanëve. Por do ta pësonte edhe Klosi ku sot ne do të shkojmë për punimet, njësoj si Tirana, si segmenti Maqellarë – Bllatë, ishte jashtë projektit edhe Klosi. 300 milionë euro për ta lënë rrugën e Arbrit pa Tiranë, pa Maqellarë, pa Klos dhe pa doganë. Kjo është e vërteta. Sot rruga do të ketë tunele më të gjatë me standarde rigoroze, me tunel emergjence, do të plotësohet me tw gjithë segmentet, do të ndërtojë degëzimin e Klosit dhe Maqellarë-Bllatë dhe do të mirëmbajë gjithë veprën dhe tunelin për 10 vjet.

Monopati i torturës 118 kilometra, sot është 69 kilometra. Nuk dua t'ju marr më shumë kohë me detaje se ka plot sa të duash, por di t'ju them se rruga e Arbrit që ne do të ndërtojmë dhe këtu do jemi, do vijmë siç tha ai djali, nga Rruga e Arbrit përpara se sa të vijmë përsëri për të kërkuar votën tuaj...

Unë e di që Shqipëria ka nevojë për shumë e shumë më tepër akoma, por Shqipëria është si një shtëpi. Si shtëpia e gjithësecilit prej jush dhe nëse shtëpia ka fatkeqësinë që një kryefamiljar i papërgjegjshëm i ka lënë të gjithë paratë në bixhoz dhe e ka zhytur familjen në borxhe, familja në fillim lan borxhet për të shpëtuar shtëpinë dhe pastaj krijon mundësitë për ta zgjeruar shtëpinë...

Në mbyllje, puna le të ndahet. Qeverisë llogaridhënien, dibranëve dhe gjithë shqiptarëve mbështetjen tonë deri në fund, duke reflektuar gjatë gjithë procesit apelin e një dibrani të madh, Hoxhë Vokrrit në veprën e tij rilindase "Ferrëfenjësja e myslimanëve":

"Para Zotit dhe popullit do të jenë përgjegjës të gjithë ulematë-hoxhallarët dhe intelektualët e kohës, pse në kohën e tyre ndër shqiptarët ka pasur ndarje dhe përçarje".

(Fjala botohet me shkurtime. Të plotë mund ta lexoni www.kryeministria.al)



Nisin punimet në Rrugën e Arbrit, presidenti i Gjoka Konstruksion deklaron:

Punimet mbarojnë për 2 vjet

Opozita kundërshton: "Nuk ka transparencë. Kontrata e rrugës së Arbrit është bërë për interesat e Ramës e jo dibranëve".

Tymi i kuq shpërtheu në një tunel të vogël në Klos më 17 qershor në mesditë, që shënoi nisjen e punimeve në Rrugën e Arbrit, në segmentin krejtësisht të ri prej 26.2 km, që do të bëjë bashkë Dibrën dhe Tiranën.

Ky tym i kuq, përveç simbolikës për nisjen e punimeve, hapi më parë edhe debatet politike në Shqipëri për tre ditë - siç është zakoni, ku opozita dhe qeveria dhanë deklarata kundër njëra-tjetrës në lidhje me këtë çështje.

I pari ishte kryeministri Edi Rama, i cili gjeti një mënyrë origjinale për të dhënë lajmin e inaugurimit të punimeve, postoi më 15 qershor në FB një letër të shkruar me dorë ku thoshte se "çdo dibran që më ka telendisur në FB me sharje e tallje për Rrugën e Arbrit, i ka hallall të gjitha, po erdhi të dielën në Peshkopi e në Klos për fillimin e punimeve të pritura 100 vjet. Fjalët mbrapsht kush nuk çon të paktën një buzëqeshje në FB në pamundësi për të ardhur".

Në të dy takimet, në Peshkopi dhe Klos, kryeministri u prit me protesta të organizuara nga opozita. Deputeti i PD së Dibrës, Xhemal Gjunkshi, i ka cilësuar premtimet e reja të kryeministrit si mashtrimet e radhës. Ai shkroi në faqen e tij zyrtare në Facebook se "Edi Rama i pashpresë thërret dibranët të marrin pjesë në takimin e tij të "shplarjes së trurit", se gjoja do ua falka sharjet e ofendimet në facebook për Rrugën e Arbrit. Rruga e lavatriçes së pastrimit të Narko Euros. Rrugës ndaj së cilës nuk ka bërë asgjë transparente përballë publikut".

Deputetja tjetër e Dibrës, Dhurata Çupi Tyli, shkroi në FB se Edi Rama t'u thotë dibranëve se "sa transparente është kontrata e Rrugës së Arbrit dhe se është bërë për interesat e Ramës e jo dibranëve. Sa ju kushton kjo rrugë banorëve të kësaj treve të varfër. T'u thotë dibranëve a do t'i taksojë ata që të kalojnë nga kjo rrugë ashtu siç ka nisur me trendin e ri të taksimit të akseve rrugore".

Kryeministri nuk i kurseu sulmet në mitingun e Peshkopisë dhe ceremoninë e inaugurimit në Klos ndaj opozitës.

"Kur morëm mandatin ne na u desh t'i paguanim një më një 5 kontrata me vlerë 2.9 miliardë lekë për ta hapur rrugën e Dibrës si skenë për daulle e për shirita, edhe pse Rruga e Arbrit nuk dukej gjëkundi. Kështu ishin kontratat e nënshkruara nga ata që vazhdojnë sot e gjithë ditën t'u bien daulleve, kontrata për rrugë daullesh e shiritash pa buxhet, pas të cilave nuk u bënë rrugë, por vetëm copa rrugësh me gropa borxhesh", tha ai në Peshkopi.

Në takimin e Klosit, kryeministri vuri theksin te standardet e rrugës. "Ne gjetëm një projekt copë-copë, si projekti i Rrugës së Kombit... Ne gjetëm një projekt që kushtonte shumë më tepër se ky dhe që ishte mizerje, me tunel pa tub emergjence. Gati 3 kilometra tunel për t'i futur njerëzit brenda, pa iu lënë mundësi të dalin, nëse ndodh, largqoftë, ndonjë hata. Është e ndaluar në të gjithë botën, edhe në Afrikë, të ndërtosh 3 kilometra tunel dhe të mos kesh dalje emergjence. Po ashtu, kjo rrugë bën dyfishin e punëve, bazuar në projektin e ri dhe më e bukura për ju është që lidh edhe Klosin. Në projektin e Saliut, Klosi nuk ishte pjesë e rrugës", tha kryeministri Rama në Klos gjatë ceremonisë së nisjes së punimeve.

Ai premtoi se "gjatë kësaj periudhe që ne do të ndërtojmë rrugën, ju do të shikoni që do të ketë një urë nga njëra anë e tunelit, 220 metra, 150 metra e lartë dhe një urë tjetër nga ana tjetër e tunelit, matanë, po kaq dhe Klosi do të lidhet me Tiranën për 30 minuta, Bulqiza për 40 minuta, Burreli për 60 minuta dhe Peshkopia që është pak më larg, përsëri do jetë shumë më afër, 80 minuta, distanca që ishin të paimagjinueshme".

Duke folur për standardet e rrugës kryeministri tha në Peshkopi se "rruga që ndërtojmë, kushton me gjithë mirëmbajtjen 10 vjet, me gjithë operimin e tunelit, vetëm 250 milionë euro. Dhe mirë që kushton më pak, por çudia është që standardi i parashikuar prej inxhinierëve të Saliut ishte C3, më i ulëti. Ndërsa ai i sot është C2. E dini çfarë do me thënë? Me projektin e Saliut, do hynit në tunel rrugor, – le që nuk do bëhej ndonjëherë, – por do hynit në tunel rrugor pa tub emergjence. A e imagjinoni dot 3 kilometra tunel pa tub emergjence dhe jashtë të gjitha normave europiane?".

"Rruga do ishte pa kokë, sepse nuk kishte segmentin 1.1 kilometër që e lidh me Tiranën. Por rruga nuk kishte as bisht sepse 9.1 kilometra që e lidhin sot me doganën e Bllatës nuk ishin. Me fjalë të tjera, 300 milionë euro borxhe për ta bërë këtë arterie jetike një shteg në mes të dy anëve që do ngeleshin siç janë sot. Si në kohën e rrugës së karvanëve. Por do ta pësonte edhe Klosi, ku sot ne do të shkojmë për punimet, njësoj si Tirana, si segmenti Maqellarë – Bllatë, ishte jashtë projektit edhe Klosi. 300 milionë euro për ta lënë Rrugën e Arbrit pa Tiranë, pa Maqellarë, pa Klos dhe pa doganë. Kjo është e vërteta", tha ai.

"Sot rruga do të ketë tunele më të gjatë me standarde rigoroze, me tunel emergjence, do të plotësohet me të gjithë segmentet, do të ndërtojë degëzimin e Klosit dhe Maqellarë-Bllatë dhe do të mirëmbajë gjithë veprën dhe tunelin për 10 vjet".

PËRTEJ NJË DEBATI POLITIK: ÇFARË PO NDODH ME RRUGËN E ARBRIT?

Vetëm një javë pas shpërthimit të tymi të kuq në Klos, që i shërbeu dhe i shërben debatit politik, më 20 qershor, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar lejen e ndërtimit Infrastrukture për objektin: "Për ndërtimin e Rrugës së Arbrit", me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, Klos, Bulqizë dhe Dibër,

Presidenti i Gjoka Konstruksion:

- "Pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj, punimet ato do të mbarojnë për dy vite.
- Projektit fillestar i janë bërë ndryshime thelbësore, duke siguruar një rrugë me standarde europiane.
- Janë shtuar në projekt edhe dy tunele të tjera në fshatin Fshat duke e bërë rrugën e Arbrit një rrugë me 5 tunele.
- Ndryshimi më i rëndësisshëm i projektit është tuneli i Qafë Murrizës, për të cilin ai hodhi poshte idetë e mëparshme për një terren të papërshtatshëm, sidomos për praninë e shumtë të ujërave, duke theksuar se tuneli është ulur 100 metra në lartësi në krahasim me idetë e mëparshme, duke e zgjatur tunelin nga 2.3 km të parashikuar në 3.2 km.

me subjekt zhvillues Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërinë "Gjoka Konstruksion" sh.a.

Burime nga kompania thanë për gazetën se punimet kanë filluar më parë në rrugë dhe ceremonia e inaugurimit më 17 qershor ishte vetëm një veprimtari që shënoi nisjen zyrtare. Sipas tyre, punimet nuk kanë të ndalur dhe ato do të mbarojnë brenda një afati 2-vjeçar.

Presidenti i kompanisë "Gjoka Konstruksion", Rrok Gjoka, tha në ceremoninë e nisjes së punimeve në Klos, se pavarësisht se në kontratë punimet janë parashikuar të zgjasin 44 muaj (rreth 4 vite), ai theksoi se ato do të mbaronin për dy vite, duke e shkurtuar shumë kështu kohën e ndërtimit. Gjoka theksoi se projekti fillestar i janë bërë ndryshime thelbësore, duke siguruar një rrugë me standarde europiane. Janë shtuar në projekt edhe dy tunele të tjera në fshatin Fshat, duke e bërë Rrugën e Arbrit një rrugë me 5 tunele. Por duket se ndryshimi më i rëndësishëm i projektit është tuneli i Qafë Murrizës, për të cilin ai hodhi poshtë idetë e mëparshme për një terren të papërshtatshëm, sidomos për praninë e shumtë të ujërave, duke theksuar se tuneli është ulur 100 metra në lartësi në krahasim me idetë e mëparshme, duke e zgjatur tunelin nga 2.3 km të parashikuar në 3.2 km. Ky zgjatim i tunelit dhe ndërtimi i një turbine tjetër me të njëjtat parametra do ta rrisin shumë standardin e lëvizjes në këtë aks, si dhe do t'i shërbejnë më shumë sigurisë në qarkullim.

Rruga do të ketë një standard C2 - sipas standardeve të BE-së, me nga 2 korsi me 3.5 metra gjerësi, plus 1.25 metra bankinat anësore. Gjithashtu, sipas projektit, në ngjitje rruga do të jetë me tre korsi lëvizje, duke lehtësuar kështu shumë qarkullimin. Shpejtësia e parashikuar e lëvizjes do të jetë nga 60 deri 100 km në orë. Gjithashtu, tuneli 3.2 km, do të jetë me dy turbina, njëri prej të cilëve do të shërbejë në raste emergjente. Po ashtu, janë shtuar edhe dy tunele të tjerë në fshatit Fshat në Klos. Njëri prej këtyre tuneleve do të sjellë edhe ndryshime në projektin e mëparshëm të Urës së Vashës.

Paralelisht në punimet në Klos, po punohet edhe në Zall Bastar të Tiranës dhe shumë shpejt pritet të fillojnë punimet edhe në Tunelin e Murrizit, më i madhi dhe më i rëndësishmi në këtë akt rrugor. Gjithashtu, punimet po vazhdojnë edhe nga Shupenza në drejtim të doganës së Bllatës, ku më i rëndësishmi këtu është një vepër artit mbi lumin Drin, por edhe nga Bllata në drejtim të Maqellarës.

Në lidhje me financimin e saj, një nga debatet e hapura, Gjoka theksoi në takimin e Klosit se ka siguruar një mbështetje financiare nga Banka Kombëtare Tregtare një shumë prej 70 milionë eurosh.

Përsa i përket dyshimeve të opozitës se rruga do të jetë me pagesë, për momentin nuk ka deklarata zyrtare. Megjithëse nga mënyra e dhënies me koncension kjo duket se do të jetë e pashmangshme, sidomos tuneli, kjo pritet të vendoset në muajt në vazhdim.

"Qeveria po harton një plan kombëtar mbi menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, dhe në këtë kuadër do të shihet edhe Rruga e Arbrit, nëse do të jetë me pagesë ose jo, por deri më tani nuk ka një vendim që do ta bëjë rrugën me pagesë ", tha një burim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

* * *

Debati politik për rrugën do të vazhdojë, por përveç kësaj kompania ndërtuese premton se punimet nuk do të kenë të ndalur. Të dyja premtimet janë në këto ditë vere, por pas një periudhë 20-vjeçare premtimesh, le të shpresojmë se këto janë premtimet e fundit. Dhe për këtë ne do të ndjekim vazhdimisht ritmin e punimeve, për të treguar hap pas hapi se dy dekadave premtime po u vjen fundi. Rruga është e rëndësishme për ne, pjesa tjetër është vetëm debat politik...

Bujar Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 146

turizëm

Tërnova është një fshat në njësinë administrative të Zerqanit, Bashkia Bulqizë, i cili i ngjan një kështjelle, i rrethuar nga malet, të cilat ngrihen thikë dhe duken si muret e saj dhe në brendësi ndodhen shtëpitë.

Tërnova, një perlë e natyrës fshehur mes malesh



Nga **Eduart RAMÇI**

Në Shqipërinë verilindore, në qarkun e Dibrës ndodhet një vend, mrekulli e natyrës, që quhet Tërnovë.

Tërnova është një fshat në njësinë administrative të Zerqanit, Bashkia Bulqizë, i cili i ngjan një kështjelle, i rrethuar nga malet, të cilat ngrihen thikë dhe duken si muret e saj dhe në brendësi ndodhen shtëpitë.

Tërnova shtrihet në pjesën veriore të Qytetit të Bulqizës, njëzet kilometra në rrugë tokësore nga qyteti, kufizohet me Zerqanin, i cili është dhe qendra e komunës, me Sopotin, me Valikardhën, me Strikçanin, me Smollikun, me Okshtunin dhe me Martaneshin e Kaptinën në rrethin e Matit, e cila është në kufi me fshatrat e Tiranës e Shëngjergji.

Pyjet janë të dendur dhe rrugët të pashtruara, e herë-herës të pakalueshme. Këto zona të japin emocione të forta, vende të "fshehta" e të paeksploruara tërësisht.

Në Tërnovë nuk mungon asgjë: ujë të pastër si kristali, liqene, pyje me pisha, bredh, ah, bjeshkë të mrekullueshme, pasuri nëntokësore, minierë kromi e fabrikë pasurimi që po ndërtohet, hidrocentral.

Zalli i Ternovës burimin kryesor e ka nga Pylli i Zi, Verviaku, Përroi i Sharrës dhe Varret e Vrame. Aty ka vlera, aty ka kuriozitet, aty ka histori, aty ka legjenda, aty ka natyrë të pashkelur, aty ka njerëz të mrekullueshëm. Aty ka jetë, ka zhvillim.

Territori i fshatit Tërnovë shtrihet nga niveli 900 m, në shtratin e zallit dhe deri në 1900 m lartësi mbi nivelin e detit, e cila ndodhet në majën e Verviakut. Disa nga perlat e natyrës së Tërnovës janë: Dabrella dhe fusha e saj, Lugu i Qyqes, Topatoku i Epërm dhe i Poshtëm, Fusha e Gjatë, Varret e vrame, Livadhi i Hidës, Lukshta e Skurës, Fusha e Zerqanit, Kazjaku me malin shpella,

Në Tërnovë nuk mungon asgjë: ujë të pastër si kristali, liqene, pyje me pisha, bredh, ah, bjeshkë të mrekullueshme, pasuri nëntokësore, minierë kromi e fabrikë pasurimi që po ndërtohet, hidrocentral. Burimet natyrore të Tërnovës janë të shumta, ato mund të kthehen në një zonë të mirëfilltë turistike në rajon.

Livadhi i Dashit, Sheshi i Epërm, Sheshi i Poshtëm, Shpella e Sheshit të Epërm, Gurra e Topatokut, e cila ka një ujë shumë të ftohtë, sa nuk mund të mbash dorën në të më shumë se dhjetë sekonda, Stani i madh, Semanikle, Kaptina, Pylli i zi, Akrazhna, Livadhi i Destanes, Arat e Kryqeve, Ara e Hoxhës, Lloka, Përroi i Sharrave, i cili mori emrin nga një punishte për prodhimin e dërrasave dhe mobiljeve që ka qenë aty deri nga mesi i shekullit të XX, Liqeni i Zi, Liqeni i Martaneshit, Liqeni i Dhoksit, Liqeni i Luleve etj.

Burimet natyrore të Ternovës janë të shumta, ato mund të kthehen në një zonë të mirëfilltë turistike në rajon, me të ardhura të mira për vetë tërnovasit dhe për Shqipërinë e shqiptarët në tërësi.

Zalli i Tërnovës, i cili zbret nga bjeshkët e ndan fshatin në dy pjesë, zbret poshtë dhe në vendin i cili quhet "ku përzihen zajet", poshtë lagjes së Imerajve, bashkohet me zallin e Okshtunit dhe më pas merr emrin e fshatrave që kalon, si zalli i Smollikut, zalli i Lubaleshit etj., derisa bashkohet me zallin e Bulqizës në vendin e quajtur Ura e Çerenecit (Shupenzës) dhe derdhet në Drinin e Zi, në fund të Gjoricës së Poshtme.

E vendosur në mes të kodrave dhe e rrethuar prej tyre të cilat janë të veshura me gjelbërim nga veriperëndimi, juglindja dhe verilindja, ndërsa kodra pjesërisht të zhveshura nga lindja, siç është Kodra e Bordës, dhe sipër fshatit shtrihen bjeshkët dhe liqenet.

Tërnova është e njohur edhe për një shumëllojshmëri bimësh mjekësore, si p.sh., hithra, dëllenja e zezë, trëndafili i egër, sherebela e egër, luleshtrydhja (drethesa), salepi, boronica, shtogu, çaji i malit, mjedra etj, të cilat mblidhen ndër vite nga banorët e zonës, duke i kthyer edhe këto në burime ekonomike.

Banorët si dhe të parët e tyre, kanë lindur dhe janë rritur, me burimet e natyrës ndër shekuj, nga këto burime natyrore kanë mbijetuar.

Ndërsa gjithë fshati aktivitetin kryesor e ushtronte në blegtori, që siguronin pothuajse pjesën më të madhe të të ardhurave të banorëve dhe pjesa tjetër vinte nga bujqësia, ku kultivohen grurë, misër, thekër, patate dhe pothuajse të gjitha llojet e frutave si molla, qershia, ftoi, arra, gështenja, rrushi, kumbulla, thana etj., si dhe të gjitha llojet e perimeve.

Deri në vitin 1990 fshati ka patur më tepër se 400 shtëpi të ndërtuara me gurë në formën e kullave tradicionale shqiptare dhe të mbuluara me rrasë guri, pasi ishte shumë rezistente ndaj të ftohtit të acartë të dimrit.

Në fund të viteve shtatëdhjetë dhe në fillim të viteve tetëdhjetë edhe sistemi i ndërtimit të shtëpive ndryshoi, pasi filloi të ndërtohet një model i ri, i quajtur "model elbasanas" dhe të mbuluara me tjegulla, diku-diku dhe me rrasa guri.

Tërnova deri në vitin 1990 ka qenë fshati më i populluar në zonën e Zerqanit me mbi 4700 banorë, por pas viteve 1990 aty ka pasur një eksod dhe largim në masë të banorëve. Pjesë e Tërnovës është edhe Ternova e Vogël me rreth 40 shtëpi, që njihet edhe si një lagje e Tërnovës.

E vendosur në mes të kodrave dhe e rrethuar prej tyre, të cilat janë të veshura me gjelbërim nga veriperëndimi, juglindja dhe verilindja, ndërsa kodra pjesërisht të zhveshura nga lindja, siç është Kodra e Bordës, dhe sipër fshatit shtrihen bjeshkët dhe liqenet. Tërnova është e njohur edhe për një shumëllojshmëri bimësh ...

Deri në fillim të viteve 1980 Tërnova lidhej me një rrugë automobilistike e hapur dhe e përdorur më së shumti nga ushtria dhe kooperativa bujqësore, kalonte nga Zerqani në Rrush të Vogël, sipër fushës së Sopotit dhe mbërrinte deri në Varre të Vrame, për në fshat ishte një rrugë, e cila kalohej me shumë vështirësi dhe përfundonte te vendi i quajtur "Kodra te Varret". Pastaj u ndërtua rruga e re, e cila kalon nga rruga kombëtare Bulqizë, Peshkopi dhe në Fushë-Bulqizë mes një shtegu gjarpërues, shfaqet përnjëherë, përmes kraharorit të malit, një pamje që të magjeps.

Në këtë të përpjetë që shigjeton përmes shtegut që ka arritur të çajë kraharoret shkëmbore të malit, ku në të majtë ngrihet maja e Kazjakut dhe në anën e djathtë lartësitë që përfundojnë në Liqenin e Zi është e pamundur të mos biesh në një gjendje hutimi që të pushton, një tronditje e brendshme që të përkund si gjethe. Udhëtimi nën retë, i cili ngjason me një udhëtim si në ëndërra të jep përshtypjen se po ngjitesh në qiell.

Majëmale të formuar përmes një procesi të kahershëm e të pandalshëm erozioni, nguten me shfaq atë që me kujdesin e paepur ka mundur me ndërtuar natyra,

aktualitet

Pozicioni dhe mënyra sesi është bërë shtrirja natyrore e fshatit të jep përshtypjen e një amfiteatri gjigant natyror, i cili nuk të lë të mbetesh jashtë pasi ka vend për të gjithë.

Është për të ardhur keq, pasi rruga pas viteve 2000 është vështirë e kalueshme me makina të vogla, pasi nuk është investuar për mirëmbajtjen e saj. Gjithashtu, ka dhe rrugë të brendshme për të shkuar dhe vizituar vende karakteristike dhe turistike të zonës, të cilat janë ndërtuar kryesisht nga ushtria para viteve nëntëdhjetë.



Ndër shpendët e egër në komunën Zerqan mund të përmendim: korbi i cili gjendet në të gjithë komunën. Laraska, është një shpend që gjendet masivisht në komunën tonë. Ajo përbën një rrezik për zogjtë e vegjël të klloçkave, gjithashtu shumë të përhapur në zonën e Zerqanit janë harabeli, mëllenja, etj.

në bashkëpunimin e vet me shiun, borën, akullin dhe erën.

Fusha e gjerë dhe e madhe e Zerqanit tek Vorret e Vrame shtrihet si një qilim i blertë me bar e lule. Një peizazh marramendës që veç ata që kanë patur fatin ta kenë parë me sy e kanë mbartur dhe e mbajnë ndër vedi ndër vite kudo që janë.

Degëzimi, i cili ngjitet në mënyrë gjarpëruese në malin përballë malit të Kaziakut, kalon në fushë të Zerqanit, Varre të Vrame, zbret poshtë deri në fshat, ndërsa një degëzim kalon përmes pyllit dhe shkon në Liqenin e Zi, ndërsa rruga kryesore përfundon në Verviak tek Miniera e Tërnovës.

Është për të ardhur keq pasi rruga pas viteve 2000 është vështirë e kalueshme me makina të vogla, pasi nuk është investuar për mirëmbajtjen e saj. Gjithashtu, ka dhe rrugë të brendshme për të shkuar dhe vizituar vende karakteristike dhe turistike të zonës, të cilat janë ndërtuar kryesisht nga ushtria para viteve nëntëdhjetë.

Pozicioni dhe mënyra sesi është bërë shtrirja natyrore e fshatit të jep përshtypjen e një amfiteatri gjigant natyror, i cili nuk të lë të mbetesh jashtë pasi ka vend për të gjithë.

GOJËDHËNA MBI TËRNOVËN

Gojëdhëna shumë të hershme të trashëguara, brez pas brezi, flasin për një luftë të ashpër dhe shkatërrim të gjithë fshatit. Këto gojëdhëna flasin për shumë banorë që jetonin aty.

Gojëdhëna flet për një histori të tre vëllezërve bashkë me familjet e tyre, të cilët ishin të vetmit që shpëtuan nga një luftë, e cila shkatërroi gjithçka përfshirë edhe kafshët shtëpiake.

Flitet që të gjitha shtëpitë u dogjën dhe të gjithë banorët e fshatit u prenë në fyt me shpata. Gojëdhëna thotë që përroi i Gërhores u krijua nga kjo masakër, dhe dheu në këtë zonë u bë i kuq nga gjaku i tyre, në fakt çuditërisht dhe në ditët tona aty dheu është i kuqërremtë, në veçanti nga pjesë të tjera të fshatit që mbase vërteton këtë legjendë të hershme.

Tre vëllezërit, emrat e të cilëve nuk i thotë gojëdhëna, vendosin të largohen pasi kishin ngelur vetëm ato në fshat në mes të trupave pa koka që gjendeshin në të gjithë fshatin, pasi i varrosin të gjithë, bashkë me fëmijët e tyre që kishin shpëtuar, marrin rrugën për tu larguar dhe vendosin që të mos kthejnë më kokën mbrapa, pasi kështu do të harronin gjithçka.

Kur dalin në kodër vëllai i vogël kthen kokën mbrapa pasi harron për premtimin që kishin bërë më parë me vëllezërit e tjerë, befas dëgjon një zë i cili i thotë: "Kthehu, ky vend ka nevojë për ty!" Çuditërisht, në fshat nuk dilte më tym nga shtëpitë e djegura.

Ai kthehet nga vëllezërit dhe u thotë që duhet të kthehet në fshat pasi kishte harruar disa gjëra të rëndësishme dhe duhej ta ndiqnin dhe gruaja e tij me dy fëmijët, vëllezërit pranuan dhe vendosën të ulen dhe ta presin, aty në kodër pa kthyer kokën mbrapa, por ai ju thotë që ato të ecin me ngadalë rrugës sepse ai do të marrë gjërat që kishte harruar që i duheshin me doemos dhe do ti zinte ato në rrugë.

Kështu bënë, vëllezërit vazhduan rrugën dhe ai bashkë me nusen dhe dy djemtë u kthyen në fshat dhe filluan jetën nga e para dhe kështu fshati u popullua përsëri.

LEGJENDA E SIRENËS SË LIQENIT

Në pranverë dhe verë barinjtë nga Tërnova ngjitnin çdo ditë malin përpjetë duke kullotur bagëtitë së bashku me qentë e tyre të racës Molosa ose siç i quanin ndryshe, Balat. Ato ishin qen shumë të mëdhenj dhe ishin roje shumë të mirë për bagëtitë nga kafshët e egra sidomos nga ujku dhe ariu, në bjeshkët e mrekullueshme të Tërnovës, Liqeni i Zi, Shesh të Epërm, Shesh të Poshtëm, Livadhi i Dashit, Liqeni i Luleve, Fusha e Gjatë etj.

Një nga barinjtë, i quajtur Metzi, ishte shumë i pasionuar pas fyellit të tij, që krijonte një melodi kaq të bukur së bashku me zërin e zogjve, të cilët cicëronin në mal e krijonin një atmosferë magjepse dhe, ndërkohë që fyelli përdorej nga barinjtë jo vetëm për të kaluar kohën por dhe për të mbajtur larg kopeve kafshët e egra.

Një ditë, teksa Metzi po i kulloste delet në afërsi të bregut të liqenit si gjithmonë në melodinë e bukur të zogjve, fyellit dhe kumonat (këmborat) e bagëtive, befas në liqen afër bregut, ai shikon një vajzë të bukur të zhveshur, e cila po krihte flokët e gjata, që i zbrisnin poshtë deri në gjunjë. Metzi për momentin frikësohet dhe kërkon të largohet duke thirrur qentë, balat, prijësit e kopesë së bagëtive, befas dëgjon një zë të bukur që po këndonte, ishte një zë mahnitës sa që Metzi harroi bagëtinë dhe nuk arrinte ti ndante sytë nga vajza e cila vazhdonte të krihej, këndonte, shikonte plot dashuri nga Metzi.

Metzi po largohej gjithë nxitim, por kokën e mbante duke shikuar nga liqeni dhe befas vajza u zhduk së bashku me këngët dhe bukurinë e saj. Metzi e pa tek ajo u zhyt në thellësi të liqenit të kristaltë, i cili nga rrezet e diellit, i rrethuar nga mali, shkëmbinjtë dhe pishat e gjata i japin një sfond përrallor sipërfaqes së liqenit.

Ai mori rrugën për poshtë duke ju drejtuar fshatit, fliste dhe pyeste veten si ka mundësi që një vajzë kaq e bukur qëndron mbi ujë e vetme në liqen. Vallë ç'bënte aty, pse krihej dhe këndonte, ç'farë zëri të bukur ka? Ah,sikur ta shikoj dhe një herë, ah sikur ta dëgjoj zërin e saj edhe një herë, mendonte ai, me vete.

Metzi po i afrohej fshatit. Pasi doli në kodër sipër tij, kopeja dhe balat gati ishin futur në fillim të shtëpive ai mendonte me vete për atë që i kishte ndodhur por nuk arrinte të hiqte nga mendja bukurinë dhe zërin e embël të vajzës së liqenit.

Gjatë gjithë mbrëmjes ai nuk bëri gjë tjetër, por vetëm mendonte për atë vajzë të bukur që kishte parë në liqen, në mëngjes niset si çdo ditë me bagëtinë kodrave përpjetë, duke kërkuar që të mos humbte kohën si ditët e tjera, pasi delet herë pas here ndaleshin nëpër lëndina duke kullotur, atë ditë Metzi nuk i lejonte të ndaleshin pasi deshte që të mbërrinte sa më shpejt. Kur mbërriti, ai vuri re, që vajza ishte pikërisht aty ku ai e kishte parë një ditë më parë. Vajza kur pa Metzin, që sapo doli nga pylli, filloi të këndojë.

Duke u afruar buzë liqenit ai e pyet: Ju nuk jeni një magjistare që ka rënë nga qielli, apo jo?

"Oh jo, mor djalë i bukur, unë jam një sirenë. Emri im është Zana", i tha atij, duhet të ik tani, nesër hajde më herët, unë në orën dymbëdhjetë duhet të shkoj dhe u zhduk përsëri në ujin e liqenit.

Të nesërmen shkon që në mëngjes dhe Zana ishte po aty. Ajo e pyeti si quhej dhe ai u përgjigj, Metzi. Ajo duke qeshur i tha mund t'ju thërras Zi, posi koha që kaloj nga kur ik e deri kur kthehem është e zezë për mua për shkak të një mallkimi. Unë mendoj duke të thirrur Zi do të ndodhë e kundërta pra do të dal në dritë, dhe unë e ndjej që ti do të lëshosh mbi mua dritën.

Ato filluan të takoheshin çdo ditë në liqen, derisa bariu kërkoi dorën e sirenës dhe ajo u shpreh e lumtur të heqë dorë nga jeta e liqenit për të marrë një palë këmbë. I vetmi kufizim ishte që të shtunën e të dielën, deri në ditën e dasmës, ajo nuk do të lejonte të shiheshin. Çdo gjë shkoi mirë për dy javë, por të shtunën e tretë ai shkoi në vendin e zakonshëm.

Metzi, nuk pa askënd. Ai ishte gati të largohej, kur dëgjoi nga një zë që erdhi nga uji:

"Zi, është e shtunë unë duhet të kthehem në një peshk për shkak të një mallkimi. Por nëse martohesh me mua, të gjitha këto mallkime do të ikin ".

Kështu vendosën të martoheshin dhe Metziu e mori në shtëpi, në fshat. Martesa u bë dhe ishte e lumtur. Ajo lindi dhe rritën tre djem. Por një ditë Zana u sëmur rëndë dhe para se të vdiste kërkoj që të varrosej në liqen. Metziu ishte i dëshpëruar, për humbjen e së dashurës së saj. Mori trupin e saj të vdekur duke u larguar nga Tërnova dhe u nis për tek liqeni duke u futur bashkë me Zanën në liqen për të mos dalë më kurrë.

Dhe Liqeni mori një bukuri të paparë në formë zemre, ngaqë mori në brendësi të tij dy të dashuruar, të cilët dhanë jetën për njëri-tjetrin. Që nga ajo ditë i mbeti emir: Liqeni i Zi, për nder të djaloshit Metzi', i cili nga dashuria që kishte për nusen që i dha liqeni, vendosi të kthehet bashkë me të dhe që të prehet përgjithmonë në liqen.

FAUNË E LARMISHME

Në pyjet e komunës Zerqan nga kafshët e egra jetojnë: gjitarët grabitqarë, këtu mund të përmendim: Ariu i murrme, i cili arrin deri ne 2 m gjatësi, 1 m lartësi dhe me një peshë 180-200 kg. Gjuetia e tij është e ndaluar.

Ujku, është një ndër kafshët grabitqare më të përhapura në këtë komunë, njëkohësisht më i rrezikshëm. Gjuetia është e lejuar në të gjitha stinët dhe me të gjitha mjetet. Macja e egër, është kafshë e rrallë dhe gjuetia e saj është ndaluar.

Dhelpra është një kafshë e vogël mishngrënëse me gëzof të çmueshëm. Vjetulla jeton ku ka shkurre afër arave dhe vreshtave ku bën dëme të kulturave të arave.

Gjitarët barngrënës. Ndër to mund të përmendim: Derri i egër, është një kafshë me përmasa trupore pak më të vogla se derri i butë, arealet e tij zakonisht janë moçalet me bimësinë e tyre. Gjuetia e tij është e lejuar me sezone, por gjithsesi ekziston gjuetia ilegale.

Kaprolli, është një kafshë shumë e rrallë, në zonën tonë. Jeton kryesisht në zonën e ahut. Nuk lejohet gjuetia e tij, sepse është specie në zhdukje. Dhia e egër, areali i saj është përqendruar kryesisht në malin e Kazjakut, dhe në Liqenin e Zi.

Lepuri i egër,është një kafshë shumë e përhapur në zonën tonë. Këto kafshë gjatë periudhës së tranzacionit si rezultat i gjuetisë së paligjshme dhe të pakontrolluar, janë dëmtuar aq shumë, sa numri i tyre është nën nivelin kritik të riprodhimit të tyre.

SHPENDËT E EGËR

Ndër shpendët e egër në komunën Zerqan mund të përmendim:Korbi i cili gjendet i shpërndarë pothuajse në të gjithë komunën. Laraska, është një shpend që gjendet masivisht në komunën tonë. Ajo përbën një rrezik për zogjtë e vegjël të klloçkave, gjithashtu shumë të përhapur në zonën e Zerqanit janë harabeli, mëllenja, etj. Duhet theksuar se për të gjitha llojet e botës shtazore, si rezultat i gjuetisë së pakontrolluar dhe moszbatimi i ruajtjes në kohën e riprodhimit vihet re ulja në numrin e disa specieve që janë shumë të rëndësishme në ekosistemin e kësaj zone.

Prej shtatorit 2017 banorët e Lagjes së Re në Bulqizë shikojnë me frikë dhe ankth se si toka poshtë këmbëve të tyre rrëshket e çahet dhe muret e banesave dhe avllive plasariten e rrezikojnë të bien.

Gërmimet nëntokësore të AlbChrome fajësohen për **rrëshqitjen masive** të dheut **në Bulqizë**

Nga **Sami CURRI** */Reporter.al*

Banorët e një lagjeje në Bulqizë besojnë se punimet e kompanisë AlbChrome për ndërtimin e traverbankut kanë shkaktuar rrëshqitje të tokës e cila u ka dëmtuar dhe u rrezikon shtëpitë. Një studim i Shërbimit Gjeologjik thotë se punimet minerare ishin një nga faktorët aktivë të rrëshqitjes, por kompania AlbChrome mohoi të kishte përgjegjësi dhe tha se lëvizja e tokës vinte nga mungesa e kanalizimeve në sipërfaqe.

Prej shtatorit 2017 banorët e Lagjes së Re në Bulqizë shikojnë me frikë dhe ankth se si toka poshtë këmbëve të tyre rrëshket e çahet dhe muret e banesave dhe avllive plasariten e rrezikojnë të bien.



Xhaferr Imeri, banor i Bulqizës | Foto nga : Sami Curri

Çarja, e cila sipas një studimi të hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në tetor të vitit të shkuar përfshinte 472 mijë metra katrorë dhe është në zgjerim, ka dëmtuar ndërkohë disa shtëpi dhe xhaminë fare pranë Qytetit të Ri në Bulqizë. Ashtu siç ishte parashikuar në studim rrëshqitja ka vijuar duke iu afruar pallateve të qytetit, ndërsa një familje ka braktisur banesën e cila u kthye në të pabanueshme dhe të tjerët rrezikojnë të njëjtin fat.

"Të gjitha shtëpit e kësaj lagje i ka bërë thuajse të pa banueshme. Janë hapur muret, oborret. Jemi të friksuar se mos kjo lëvizje vazhdon akoma", tha Xhafer Imeri, një prej banorëve të lagjes.

Imeri dhe banorët e tjerë besojnë se arsyeja e rrëshkitjes së tokës janë punimet e kompanisë AlbChrome për ndërtimin e traverbankut – një tunel horizontal nëntokësor që lidh minieren e Bulqizës me Shëngjunin në Klos.

"Pikërisht kur kanë filluar punimet për këtë traverbank (nën këtë zonë) kanë filluar edhe shembjet e tokës", shpjegon Imeri.

Studimi i Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, i cili nga përpiluesit cilësohet si relacion emergjernce që duhet të pasohet nga një studim i thelluar, gjeti po ashtu se ndër faktorët e rrëshkitjes ishte "ndryshimi i drejtimit të ujërave nëntokësorë drejt punimeve minerare" duke veçuar traverbankun dhe gërmimet minerare nga 335-350 metra nën nivelin e luginës

Çarja, e cila sipas një studimi të hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në tetor të vitit të shkuar përfshinte 472 mijë metra katrorë dhe është në zgjerim, ka dëmtuar ndërkohë disa shtëpi dhe xhaminë fare pranë Qytetit të Ri në Bulqizë.

Kompania AlbChrome e cila është koncesionari më i madh në minierën e Bulqizës dhe që po bën punimet për traverbankun, mohoi që aktiviteti i saj të ishte përgjegjës për situatën. "Mendimi ynë është se ulja e kores së tokës në një masë të tillë nuk është ndikuar nga ky punim", thuhet në një përgjigje që ajo i nisi BIRN.

Megjithëse i referohet po raporti të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për llogari të Bashkisë Bulqizë, i cili veçon ndërtimin e traverbankut si një nga faktorët, kompania thotë se studim nuk konstatoi "që aresyeja është traverbanku".

Ndërkohë, autorët e raportit gjeologjik bëjnë thirrje për një studim të thelluar të rrëshkitjes së tokës në Bulqizë duke nënvizuar se Shërbimi Gjeologjik Shqiptar nuk i ka kapacitet financiare për ta zbatuar. Kjo kërkesë mbështet dhe nga bashkia e Bulqizës, e cila shprehet se i ka kërkuar ndihmë ministrive të linjës.

RREZIKU NGA RRËSHQITJA

Traverbanku i cili ishte planifikuar të ndërtohej që në mesin e viteve '80, për të mundësuar menaxhimin e ujërave nëntokësorë të minierës dhe po ashtu për të lidhur dy pjesë të saj dhe lehtësuar transportin e kromit. Punimet për të sidoqoftë ngecën, ndërsa rifillimi i tyre u njoftuar një herë në prezencë të ish-kryeministrit Sali Berisha në majt të vitit 2013, pasi Balfin Group bleu aksionet e kompanisë koncesionare deri atëherë ACR, dhe sërish në gusht të vitit 2015 në prani të kryeministrit Edi Rama. Një vit më vonë, në vitin 2016 qeveria vendosi të zgjasë koncesionin me 10 vjet duke premtuar investime përfshi traverbankun që i zgjasnin jetën minierës.

Koncensioni i pjesës më të madhe të minierës së kromit në Bulqizë iu dha nga qeveria në vitin 2001 kompanisë italiane Darfo s.p.a dhe ndërroi disa herë pronësi mes problemeve të shumta, aksidenteve të rënda me humbje jete të minatorëve, grevave të minatorëve ...

Koncensioni i pjesës më të madhe të minierës së kromit në Bulqizë iu dha nga qeveria në vitin 2001 kompanisë italiane Darfo s.p.a dhe ndërroi disa herë pronësi mes problemeve të shumta, aksidenteve të rënda me humbje jete të minatorëve, grevave të minatorëve dhe akuzave për mungesë investimesh. Kompania u ble nga BALFIN Group në vitin 2013 dhe ndërroi emrin në AlbChrome.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kërkoi në raportin e tetorit 2017 për rrëshkitjen që të mbyllej xhamia e qytetit, pasi sipas tyre "në një situatë të tillë kërcënohej jeta e besimtarëve që do të ushtronin ritet e tyre në këtë objekt kulti, që ishte plasaritur në të gjitha anët".

Por xhamia e dëmtuar rëndë nuk ishte e vetmja që rrezikonte, sipas hartuesve të raportit e gjithë lagja "duhej mbajtur në kontroll të rreptë nga ana e pushtetit lokal, sepse me zgjerimin e kontureve të fenomenit mund të rrezikohen edhe objekte të tjera", ndërkohë u rekomandua që të shembej nënkontroll godina e ish-parkut automobilistik.

Studimi i cilësuar prej tyre si studim emergjence gjeti se nëse nuk ndërhyhej menjëherë sipërfaqja e prekur, që zgjatej për gjysmë kilometri dhe ishte e gjërë 1 kilometër, do të vijonte të lëvizte dhe shkaktonte probleme edhe më të mëdha, ndërsa rekomandoi që në zonë "të mos ndërtohen banesa të reja, pa kryer më parë studimin gjeologo-inxhinierik për truallin ku do të ndërtohen".



Zona e prekur nga rrëshqitja në Bulqizë | Foto nga Google Earth

Për banorët e zonës rreziku u bë i dukshëm pasi çarja filloi të zgjerohej. Një prej banesave e cila u gjet e pabanueshme edhe prej studimit u braktis, por banorët e tjerë thonë se largimi nuk është zgjidhje, pasi ata kanë investuar gjithçka kishin në këto shtëpi.

"Ato dy lekë që i mblodhëm, me zor bëm një shtëpi, bashkë edhe me ndihmën e çuanve. Sot ky investim që na ka marrë kursimet e një jete punë në nëntokë ka rrezik që të rrëzohet, shkak kjo nga lëvizja e tokës", tregon Zaim Rrahmani, i cili prej vitesh punon në Minierën e Bulqizë. Ai thotë se me lëvizjen e tokës muri rrethues i shtëpisë së tij dhe ai i shtëpisë së komshiut është çarë dhe po çahet çdo ditë edhe më shumë, duke sjellë edhe plasaritje të shtëpisë.

Banorët e zonës thonë se toka filloi të çahej që nga segmenti i përfunduar i Rrugës së Arbërit afërsi të Fabrikës së Pasurimit të Kromit në Bulqizë, ndërsa çarja vijoi dhe tani është në brendësi të Lagjes së Re. Ata thonë se aktiviteti i rrëshqitjes ka qenë i ngadaltë, duke dëmtuar banesat gradualisht dhe çarjet kanë ardhur duke u zgjeruar vazhdimisht.

Mundësinë e zgjerimit të çarjes e vë në dukje edhe raporti i Shërbimit Gjeologjik. "Nga vrojtimet në terren konstatohet se mundësia e aktivizimit të rrëshqitjes është evidente dhe ajo mund të zgjerohet në pjesën e sipërme të saj si dhe anash", thuhet në raportin e përpiluar nga Inxhinierët Zenel Hysa dhe Mehmet Kenga.

ÇFARË E SHKAKTOI RRËSHKITJEN

Banorët besojnë se rrëshqitja ka ardhur pas fillimit të punimeve të traverbankut. Ata thonë se ka pasur dy valë të rrëshkitjes së tokës vetëm në harkun kohorë të pak muajve. Rrushe Rrahmani, 84 vjeç tregon për BIRN se në këtë lagje ka një jetë që banon dhe se nuk mban mend që të ketë lëvizur toka ndonjëherë kështu si këto muajt e fundit.

"Komshiu jonë, Suri Çupi, bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët është larguar për në Itali sepse dolën në qiell të hapur. Shpija ju është çarë mes për mes the thuajse i zuri brenda dhe nga shteti nuk e vuri kush ujin në zjarr", thotë 84-vjeçarja.

Të njëjtën gjë i tha BIRN edhe Xhafer Imeri. Ai thotë se ata kanë dyshuar fillimisht te ndërtimi i Rrugës së Arbrit, por fakti që rrëshqitja ndodhi pas vjeshtës së vitit të

Studimi, të cilin edhe AlbChrome e referon, përveç se cilëson punimet e kompanisë si një nga "faktorët aktivë", kërkon edhe që të merren masa në gërmimet nëntokësore për të ndaluar rrëshkitjen.



Rrëshqitja e tokës në Bulqizë | Foto nga : Sami Curri

shkuar i ka bërë që ta përjashtojnë këtë dyshim. "Kjo rrëshkitje është shumë e theksuar që prej vjeshtës së 2017-s, ku toka deri më sot ka pasur disa valë rrëshkitjeje. Kemi një dyshim që një gjë e tillë ka ardhur si pasojë e ndërtimit të traverbankut të Klosit, që do të lidh Minierën e Bulqizës me Shëngjunin e Klosit", tha Imeri.

Të frikësuar banorët i kërkuan ndihmë Bashkisë së Bulqizës e kjo e fundit kontaktoi Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Raporti i emergjencës i përpiluar nga ky shërbim u jep të drejtë dyshimit të banorëve. Ndërsa përmend si faktorë të mundshëm mungesën e një kullimi të mirë të ujërave sipërfaqësore, ndërtimin e rrugës, mungesën e bimësisë së lartë dhe aktivitetin siszmik. Studimi thotë se një faktor i mundshëm është ndërtimi i traverbankut.

"Ulja e depozitimeve torfore deri në 4-5 m si rezultat i sufozionit, për shkak të ndryshimit të drejtimit të lëvizjes së ujrave nëntokësore drejt punimeve minerare të cilat tashmë janë shumë poshtë nivelit luginës (traverbangu rreth 335 m dhe puset e shfrytëzimit të minierës rreth 350 m)", është sipas raportit një nga faktorët aktivë që mund të ketë shkaktuar rrëshkitjen. E shpjeguar me fjalë të thjeshta sipas përpiluesve të raportit, ujërat që kanë ndryshuar drejtim për shkak të punimeve nëntokësore kanë marrë me vete edhe shtresën e butë të tokës.

Përpiliuesit e raportit sidoqoftë kanë qenë të kujdeshëm. Ata i thanë BIRN se përtej dyshimeve ishte i nevojshëm një studim i thelluar për të përcaktuar saktë shkakun e rrëshkitjes.

KOMPANIA MOHON PËRGJEGJËSITË

Kompania AlbChrome nga ana e saj mohoi që faji të ishte i punimeve dhe tha se mendonte që problemi ishte nga mungesa e kanalizimeve. Madje në një email për BIRN ata mohuan që uji i devijuar nga punimet që ata po bëjnë të kishte gërryer shtresa të buta të nëntokës. "Ujërat nëntokësore që dalin në ballin dhe trungun e Traverbankut janë të pastra, pa ndotje me masa torfike apo ranore, janë ujëra te pijshme (përdoren si ujë i pijshëm për Bashkinë e Klosit) dhe për këtë arsye ne mendojmë që hapja e këtij punimi nuk ndikon në sipërfaqe", deklaroi AlbChrome.

Ajo po ashtu kundërshtoi pretendimet e banorëve dhe i tha BIRN se rrëshqitja e zonës kishte filluar më herët dhe për të faji ishte kryesisht i mungesës së kullimit të ujërave sipërfaqësorë. "Punimi (traverbanku) ka pak kohë që ka hyrë në zonën që pretendohet, ndërkohë që kjo zonë ka filluar uljen që në vitet '90 kur ky punim ishte ende larg zonës. Mendimi ynë është se ulja e kores së tokës në një masë të tillë nuk është ndikuar nga ky punim", shkroi kompania.

Megjithëse i referohet raportit të përpiluar në vitin 2017 nga Shërbimi i Gjeologjik Shqiptar me kërkesë të Bashkisë Bulqizë, raport që BIRN e disponon dhe ku theksohet se një nga faktorët e mundshëm ishin edhe punimet për traverbankun, kompania mohoi të kishte dijeni për një studim të tillë.

"Në vitin 2017, Bashkia Bulqizë ka marrë një studim të hollësishëm për problematikën e kësaj rrëshqitjeje, e kryer nga institucioni

Dëmtimi i shtëpive nga çarja e tokës u shtohet problemeve të tjera të shfrytëzimit të kromit në Bulqizë, përfshi aksidentet të cilat u kanë marrë jetën 7 minatorëve dhe plagosur disa të tjerë prej nëntorit të vitit të shkuar. Në galeritë e kontrolluara nga AlbChrome janë raportuar dy aksidente...

i duhur, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, dhe në këtë studim nuk konstatohet që aresyeja është traverbanku", thuhet në përgjigjen zyrare të AlbChrome.

E pyetur konkretisht për studimin, i cili e gjen ndërtimin e travebankut dhe gërmimet minerare si faktorë të mundshëm, kompania u përgjigj se nuk kishte parë një raport të tillë. "Albchrome nuk disponon një studim të tillë", thuhet në përgjigje.

Por nga ana tjetër studimi, të cilin edhe AlbChrome e referon, përveç se cilëson punimet e kompanisë si një nga "faktorët aktivë", kërkon edhe që të merren masa në gërmimet nëntokësore për të ndaluar rrëshkitjen.

Ndër masat që kërkohen të merren veç pastrimit të kanaleve kulluese, mbjelljen e pemëve të larta si akacia e të ngjashmë përpiluesit kërkojnë marrje të masave edhe nëntokë. "Disiplinimi i arteries kryesore të largimit të ujrave në drejtimin natyral është shumë i rëndësishëm në kushtet kur për shkak të punimeve minerare (traverbangu rreth 335 m dhe puset e shfrytëzimit të minierës rreth 350 m), mund të ketë ndodhur ndryshimi i drejtimit të lëvizjes së ujrave nëntokësore", thonë përpiluesit e studimit.

Banorët ndërkohë shpresojnë që dikush do të paguaj për dëmet e tyre. Ata thonë se babashkëqytetari i tyre që u shpërngul nga shtëpia për shkak të shembjes mori vetëm 100 mijë lekë, duke shtuar se kjo masë dëmshpërblimi nuk ishte e mjaftueshme për të riparuar dëmet apo për të siguruar strehim tjetër. AlbChrome tha për BIRN se duke qenë se dëmet nuk ishin shkaktuar prej aktivitet të saj ajo nuk kishte detyrim të dëmshpërblente banorët. Kompania gjithashtu theksoi se traverbanku po ndërtohej si detyrim koncesionar.

PAMUNDËSIA E NJË STUDIMI TË THELLUAR

Sidoqoftë rekomandimi kryesorë në relacionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, drejtuar bashkisë së Bulqizës të siguruar nga BIRN, është kërkesa për një studim i thelluar. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar nuk ka kapacitetin teknike për ta bërë një studim të tillë, që do të kërkonte kontraktimin e një kompanie private për kryerjen e shpimeve me sondë për ta kuptuar më qartë se çfarë po ndodh.

"Shërbimi Gjeologjik Shqiptar prej vitesh ka pësuar disa reforma dhe sot nuk ka kapacitetet e nevojshme që për rastin në fjalë ose edhe për raste të tjera të kësaj natyre të bëj një studim të thelluar, kjo sepse ka një kosto shumë të madhe, të pa përballueshme nga institucioni. Në rastin e Bulqizës, ne kemi përpiluar një relacion në kushtet e emergjencës", u shpreh për BIRN Mehmet Kenga, një nga hartuesit e këtij relacioni.

Melaim Damzi, kryetar i bashkisë së Bulqizës i tha BIRN se kishin kërkuar që të bëhen të gjitha studimet e nevojshme për rastin në fjalë, tek ministria e linjës, por edhe tek Shërbimi i Gjeologjisë Shqiptare, pasi ata vetë nuk mund ta financonin një të tillë. "Ata kanë kryer një studim si rast emergjence, por për një studim më të thelluar për të kuptuar shkaqet dhe se çfarë mund të ndodh në të ardhmen, bashkia Bulqizë nuk ka mundësitë financiare për ta përballuar një të tillë, duke shpresuar që institucioneve të cilave ne ju jemi drejtuar ta bëjnë një gjë të tillë. Ne hapat tonë institucional i kemi ndërmarrë të gjitha", i tha BIRN Damzi.


Veap Halili, anëtar në Këshillin Bashkiak Bulqizë, po ashtu i tha BIRN se studimi i thelluar duhej të bëhej sa më shpejt, duke pohuar se nuk kishte pasur studime paraprake nëse ndërtimi i traverbankut mund të shkaktonte probleme. "Jemi përballë një emergjence. Raporti i thelluar gjeologjik do të nxjerr edhe shkaktarët. Nëse shkak është ndërtimi i traverbankut, kompania koncensionare e Minierës së Bulqizës duhet të dëmshpërblej banorët e dëmtuar", u shpreh për BIRN Halili.

AlbChrome i tha BIRN se nëse do të kishte një studim tjetër ata do ishin të hapur për tu njohur me të. Kompania tha se ndërkohë po zbatonte një projekt të vjetër i cili nuk përmende ndikim në sipërfaqe. "Projekti për hapjen e këtij punimi është bërë në vitin 1985 në Institutin e minierave dhe nuk përmend në asnjë rrjesht që ky punim të ketë ndikim në sipërfaqe", tha kompania.

Dëmtimi i shtëpive nga çarja e tokës u shtohet problemeve të tjera të shfrytëzimit të kromit në Bulqizë, përfshi aksidentet të cilat u kanë marrë jetën 7 minatorëve dhe plagosur disa të tjerë prej nëntorit të vitit të shkuar. Në galeritë e kontrolluara nga AlbChrome janë raportuar dy aksidente, përfshi plagosjen e pesë minatorëve nga një shpërthim mine gjatë punës për ndërtimin e traverbankut në shkurt të këtij viti. Kompania ka reaguar thënë se i ka marrë të gjitha masat e sigurisë.



Rrushe Rrahmani, banore e Bulqizës | Foto : Sami Curri



Dëmtimi i i mureve të xhamisë në Bulqizë. Foto nga studimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Faik Bruçi
biznesmeni ku qëndron bashkë suksesi dhe humanizmi

Nga **Shaqir SKARRA**

Dibra ka ditur t'i presë e përcjellë bukur djemtë e saj, t'i vlerësojë e nderojë gjithmonë. Këtë radhë e priti krejt ndryshe biznesmenin e njohur, birin e Katër Grykëve, Faik Bruçin.

Këshilli i Qarkut Dibër, me vendim Nr.5, datë 13 mars 2018, e kishte nderuar me titullin më të lartë "Nderi i Qarku Dibër", me motivacionin: "Në vlerësim të veprimtarisë së tij, për mbështetjen financiare, në ruajtjen dhe promovimin e vlerave për historinë, artin, sportin dhe kulturën dibrane".

Më 27 prill 2018, në një nga sallat e Hotel "Veri" në qytetin e Peshkopisë, u mblodhën biznesmenë, intelektualë, artistë e miq të Faikut. Ishte i pranishëm kryetari i Këshillit të Qarkut, z. Hajri Laçi, si dhe kryetari i bashkisë së Dibrës Muharem Rama. Mes të pranishmëve kishte jo vetëm nga vendlindja e tij, Katër Grykët, por edhe nga Tirana. Propozimi për këtë titull ishte nga Shoqata "Bashkësia Dibrane", ndaj nderonte me praninë e tij Bujar Kapexhiu – Mjeshtër i Madh, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës, së bashku me sekretarin, Saimir Shatku.

Në fjalën e tij, Hajri Laçi, kryetari i Këshillit të Qarkut të Dibrës tha se: "Si Faiku, Dibra ka shumë. Ka biznesmenë të suksesshëm, që herë pas here e kthejnë kokën nga vendlindja. Ka intelektualë që mendojnë për vendlindjen, ka artistë të njohur që ia rritin vlerat më shumë Dibrës anembanë botës. Për njerëz të tillë Dibra ka nevojë. Faiku është një ndër ata që nga mundi, djersa e tij jep për artin, kulturën e sportin në Dibër."

Në të gjitha fjalët dhe përshëndetjet që u thanë në këtë takim mbresëlënës, nuk mund të plotësohej kaq lehtë portreti i Faik Bruçit, i dallëndyshes së parë dibrane në fushën e turizmit, por edhe në biznes.

Në fakt, unë ka kohë që e njoh nga afër Faikun, kam biseduar e pirë kafe shpesh me të. Kemi biseduar rreth biznesit, turizmit, artit, kulturës e sportit. Ai ndihmon vazhdimisht, i ndërgjegjshëm se duhet akoma shumë punë për ta bërë jo vetëm të njohur Dibrën, por edhe të gjithë së bashku të prezantojmë vlerat dibrane në metropolin shqiptar.

JETA NË HIDROCENTRALE, SHKOLLA E JETËS

Faik Bruçi u lind më 1 janar 1956 në Lukanin e bukur të krahinës së Katër Grykëve, në një familje atdhetare. Familja e tij njihet për atdhetarizëm, besë e bujari, jo vetëm në Dibër por dhe jashtë sinorit të saj.

Vetëm pak kohë pasi mbaron arsimin tetëvjeçar në vendlindje, në vitin 1972, largohet nga Lukani, i strukur bukur rrëzë maleve dhe shkon në veprat e mëdha të dritës. Këtu gjatë punës që bënte, iu krijua mundësia të mbaronte me nota të mira arsimin e mesëm profesional për gjeometër ndërtimi, profesion që e ka dashur vazhdimisht.

Pas mbarimit të shkollës së mesme fillon punë si përgjegjës sektori i laboratorit të hidrocentralit të Fierzës. Të gjitha analizat laboratorike që zhvilloheshin atëherë për Fierzën, e cila sapo kishte hedhur digën e saj të madhe, i ishin besuar Faik Bruçit nga Dibra. Ky nuk ishte një vlerësim i vogël.

Nga vitet 1980 deri në vitin 1985 kalon në një vepër tjetër të madhe energjitike, siç ishte Komani. Edhe këtu punoi me detyrën e përgjegjësit të sektorit.

Në vitet 1985-1988 vazhdon punën në Ndërmarrjen e Tensionit të Lartë, Tiranë dhe në vitet 1988-1990 në Ndërmarrjen e Ndërtimeve Industriale, për të vazhduar më 1990-1992 në Ndërmarrjen e Mirëmbajtëses së Rrugëve.

Pa dyshim, që hidrocentrali i Fierzës dhe Komanit për Faik Bruçin, atëherë djalë i ri



Faik Bruçi me kryetarin e Këshillit të Qarkut Dibër, z. Hajri Laçi, gjatë ceremonisë së marrjes së titullit "Nderi i Qarku Dibër".

Faik Bruçi në fillim e nisi nga hiçi, në një kohë që mjaft të tjerë e kishin kaluar stadin dhe po konkurronin bindshëm në fushën e biznesit. Kjo nuk e pengonte Faikun vizionar. Moto kryesore e tij ishte gjithmonë: "Fillo me pak, mendo për shumë". Faiku në fillim kështu e nisi, me pak, por ambicia e tij ishte e madhe, kishte synime për t'u shtrirë jo vetëm në ndërtim, por edhe më gjerë.

e plot ëndrra të bukura për jetën, ishin dhe mbetën një shkollë e madhe. Aty, jo vetëm Faiku, por edhe plot të rinj të tjerë, me përvojën e bukur që fituan, u poqën para kohe.

BIZNESI: FILLO ME PAK, MENDO PËR SHUMË

Mbas ndryshimit të sistemit, falë edhe aftësive të tij drejtuese dhe profesionale, por edhe përvojës së mirë që kishte përfituar vite me radhë, Faik Bruçi arriti të krijojë aktivitete private në fushën e ndërtimit, sigurimeve, hotelerisë dhe pastrimit, duke u bërë kështu firma e parë e suksesshme në kryeqytet.

Faik Bruçi në fillim e nisi nga hiçi, në një kohë që mjaft të tjerë e kishin kaluar stadin dhe po konkurronin bindshëm në fushën e biznesit. Kjo nuk e pengonte Faikun vizionar. Moto kryesore e tij ishte gjithmonë: "Fillo me pak, mendo për shumë". Faiku në fillim kështu e nisi, me pak, por ambicia e tij ishte e madhe, kishte synime për t'u shtrirë jo vetëm në ndërtim, por edhe më gjerë.

Ka kaluar më shumë se njëzet vjet, që atëherë kur në hapësirat e pafundme të biznesit shqiptar u shtua dhe një dallëndyshe e re. Në vitin 1995, Faik Bruçi krijoi kompaninë "Bruçi" shpk. Megjithëse nuk e nisi në një stad me të tjerët, megjithëse e dinte se do të haste në vështirësi dhe pengesa, burokratike apo juridike, Faiku nuk u tërhoq përballë asnjë vështirësie. Ai nuk ishte mësuar të tërhiqej përballë vështirësive, pasi ishte kalitur mirë në moshë të re, në veprat e mëdha, në Fierzë e Koman. Pas njëzet vitesh, pas shumë pune, me mund e djersë, shikon veprat që ka ndërtuar e bindesh plotësisht se biznesi i tij është një histori suksesi.

Firma "Bruçi" shpk vendosi që investimet e para t'i nisë në objekte social-kulturore dhe infrastrukturë. Faik Bruçi, si një djalë nga një derë e fisme dhe arsimdashëse, kishte dëshirë të investonte në arsim. Mungesa e shkollave, por dhe ristrukturimi i tyre, ishte më se i nevojshëm ato vite në vendin tonë.

Nga Tirana Faiku shkoi në Shkodër, te djepi i kulturës shqiptare, ku ndërtoi shkollën "Martin Camaj", një shkollë vërtet me parametra bashkëkohorë. Nga Shkodra në Durrës, ku në kohë rekord ndërton godinën e Universitetit në vitin 2006. Kompania e tij, tashme e njohur, e shtrin veprimtarinë e saj edhe në fusha të ndryshme, si në infrastrukturë dhe ristrukturime të objekteve social-kulturore. Pas ndërtimit të një sërë fjetoresh për forcat komando të ushtrisë, realizoi edhe ristrukturimin e godinës së Ministrisë së Ekonomisë, Rrugës së Durrësit, ndërtimin e rrugës Tapizë – Qinam – Çekrezë etj.

Sektori i ndërtimit ishte i vështirë dhe mjaft kompani të tjera nguronin të investonin. Faiku mori përsipër të konkurrojë bindshëm në këtë sektor për dy arsye: E para, se ishte vetë profesionalisht i aftë, dhe e dyta, se kryeqyteti kishte nevojë të vazhdueshme për ndërtime. Strehimi në Tiranë vlente për të dëshiruar. Sapo kishin filluar ndërtimet e pallateve me dhjetë a më shumë kate apo siç quheshin ndryshe "gratacela". Ishin këto ndërtesa që ia ndërruan dhe pamjen kryeqytetit shqiptar, duke e barazuar shpejt nga ndërtimet me kryeqytete europiane.

Faik Bruçi punon dhe drejton gjithmonë me vizion dhe asnjëherë nuk ka dalë i humbur. Për shumë vite ka drejtuar Kompaninë "Bruçi" shpk, kompaninë "Jon 2002" si dhe ka qenë aksioner i rëndësishëm dhe i suksesshëm në "Bankën Popullore", Kompaninë e Sigurimeve "Albsig", Hidrocentralin " Gjanç" Korçë dhe njëkohësisht sot është pronar i vetëm i "Capital Tirana Hotel".

Biznesi dhe aktiviteti i tij çdo vit ka njohur vetëm ngritje dhe suksese. Për këtë, kompanisë që ai drejton dhe personalitetit të tij angazhues, me aftësi të mira menaxhuese, i janë akorduar tituj dhe simbole vlerësuese nga institucione brenda dhe jashtë vendit tonë.

Duke u afirmuar si kompani serioze, duke qenë një ndër më të rregulltat taksapaguese si dhe duke kompletuar administratën me kuadrin e nevojshëm inxhiniero-teknik, Faiku hedh vështrimin larg, aty ku sapo kishin filluar "gratacelat" e para shqiptare. Ndaj filloi ndërtimin e një sërë pallatesh shumëkatëshe, duke u radhitur një ndër kompanitë më serioze në fushën e ndërtimit. Por, ai nuk u mjaftua me aq. Shumë shpejt ndërtoi edhe objekte të një rëndësie të veçantë në sektorin e energjitikës, në fushën e ndërtimeve civile e industriale, ndërtimin dhe montimin e linjave të tensionit të ulët,mesëm e të lartë, në infrastrukturën, kanalizime, ujësjellësa, pastrimit dhe mbetjeve urbane, sipërfaqeve të gjelbërta etj.

Sot, kur shikon komplekset e banimit pranë shkollës teknologjike, të ndërtuar nga "Bruçi" shpk, bindesh në seriozitetin dhe profesionalizmin e kësaj kompanie.

Nga apartamentet e ndërtuara nga kjo kompani janë strehuar mbi 500 familje, mbi 70 mijë metra katror apartamente, dyqane, zyra dhe parkime.

Në vitin 2002, kryeqyteti shqiptar, pas popullimit të shpejtë, doli emergjente nevoja e pastrimit, mbledhjes dhe depozitimit të mbeturinave. Ndërmarrja e pastrimit, që mbulonte Bashkia, nuk mund ta përballonte këtë fluks të madh. Faik Bruçi vendosi të marrë mbi supe një përgjegjësi të madhe. Vendosi të bëhej pjesë me shumë kompani shqiptare dhe të huaja në pastrimin e Tiranës. Me kuadro, punëtorë, por dhe me makineri, mori pjesën më të vështirë për pastrimin e kryeqytetit. Jo vetëm sot, por që nga viti 2002-2008 zona perëndimore, një ndër zonat më të mëdha të Tiranës, pastrohet nga firma "Bruçi" shpk. Pastrimi i Tiranës është një nga sektorët më të vështirë, por për këtë firmë serioze edhe vetë qytetarët flasin me admirim. Bashkë me punëtorët e pastrimit, një pjesë e mirë e administratës natën rrinte zgjuar. Mëngjesi e gjente gjithmonë zonën

cyan magenta yellow black

profil

Nga viti 2011 e në vazhdim operon suksesshëm në fushën e hoteleri-turizmit, duke pasur sukses me tre godinat në qendër të Tiranës, "Tirana Capital Hotel", "Bruçi 1, 2" si dhe është në pritje të lejes për një hotel tjetër, "Bruçi 3".







perëndimore të Tiranës të pastër.

Në vitin 2006 nga Institucioni i Vlerësimit të Suksesit dhe Cilësisë "International Quality Crown Award" Londër, i ka akorduar Kompanisë "Bruçi" shpk dhe zotit Faik Bruçi, si administrator i saj, Çertifikaten Ekselente të Cilësisë.

Shoqëria "Bruçi" shpk ka realizuar një mori objektesh në fushën e ndërtimit si godina banimi si në qytetin e Tiranës dhe atë të Durrësit. Në fushën e pastrimit të qytetit të Tiranës kjo shoqëri me zotin Faik Bruçi në vitin 2006 është shpallur në listën e më të mirëve të bizneseve të atij viti. Po ashtu, me gamën e tij të pasur e të vlerësueshme ka ushtruar aktivitete në pastrimin e qytetit të Sarandës, të plazheve, etj.

Në ambiciet e tij, si menaxhues i mirë dhe vizionar, vetë Faiku është pretendues dhe krijues edhe për të ardhmen. Ai po tenton të zgjerojë dhe të iniciojë edhe në fushën energjetikës si dhe në atë të turizmit. Kështu, momentalisht është bashkëpronar në hidrocentralin "Gjanç" në Korçë dhe ka aplikuar për të drejtën e realizimit të një impianti Fotovoltaik në Fushë-Krujë me kapacitet të konsiderueshëm për ta realizuar me sukses objektin dhe gjithë vlerën e investimit.

"TIRANA CAPITAL", HOTELI I REKOMANDUAR NË QENDËR TË TIRANËS

Nga viti 2011 e në vazhdim operon suksesshëm në fushën e hoteleri-turizmit, duke pasur sukses me tre godinat në qendër të Tiranës, "Tirana Capital Hotel", "Bruçi 1, 2" si dhe është në pritje të lejes për një hotel tjetër, "Bruçi 3".

Hotelet e tij, fare pranë Prokurorisë së Përgjithshme, vërtetojnë mjaft mirë cilësinë e shërbimit dhe komoditetit në qendër të Tiranës. Ato përbëhen nga 44 dhoma, recepsion, restorant, lavanteri dhe salla konferencash. Për të gjitha këto merr vlerësim maksimal nga klientët vendas e të huaj, sidomos për sa i përket pastërtisë, higjienës dhe shërbimit të kualifikuar, profesional e mbresëlënës.

Në perspektivë, përveç zgjerimit të kapaciteteve dhe gamës së shërbimeve, në kuadrin e përmirësimit të ligjit për turizmin, mendohet që të rritet konkurrueshmëria në fushën e turizmit, duke futur edhe guidat turistike. Faiku kërkon që turizmin ta shtrijë edhe në Dibër, sidomos në vendlindjen e tij të dashur. Megjithëse infrastruktura nuk është e përshtatshme, ai nuk tërhiqet, ka plane e projekte për të ardhmen që turizmi malor të jetë me perspektivë në Dibër.

Kur je në Katër Grykë, shkon nga shkon mendja, dashje pa dashje, të detyron mrekullia natyre të sodisësh. Syri përcjell bukuri të rralla, që ende kanë mbetur të virgjëra. Një ndër majat e larta të Katër Grykëve, është pa dyshim Runja e bukur, mahnitëse që, kur ngjitesh lart në majën e saj, e ke dhe Lurën ballë për ballë. Nuk janë larg njëra-tjetrës në vijë ajrore. Një distancë prej gjashtë kilometrash i ndan, që të dyja. Ballë për ballë shkojnë mirë me njëra-tjetrën. Shpesh herë është diskutuar ideja e një teleferiku nga maja e Runjës në Lurë, ku të promovohen fare mirë vlerat artistike të dyjave bashkë. Dhe kjo ide mund të realizohet në një të ardhme, nëse zona e Katër Grykëve si pushteti lokal, si biznesi vendas, si dhe vetë banorët e këtyre zonave, janë të interesuar për të thithur sa më shumë turistë të huaj për të parë këto mrekulli të natyrës.

VIZIONI PËR TURIZMIN NGA KATËR GRYKËT NË LURË

Qysh në vitin 1966 Lura është shpallur park kombëtar. Televizioni shqiptar në vitin 1995 dha një reportazh, kur ende Lura është e gjallë, kur ende e kishte tamam statusin e të qenit park kombëtar, ku pikërisht këto filmime mund të jenë të fundit, që i japin shkëlqimin e Lurës, se më vonë fillon rrënimi dhe krimi ndaj saj. Ajo që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë me Lurën, këtë perlë të vendit tonë, është padyshim masakra më e pashembullt që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë ndonjëherë mbi pyjet, ekologjinë, mjedisin, natyrën. Lura është një padi e hapur, një akuzë e rëndë, e drejtpërdrejtë për pushtetmbajtësit e njëzet viteve të fundit, që nuk e ndaluan dhe nuk po e ndalojnë shkatërrimin e saj.

Eh, këtyre panoramave u kanë mbetur vetëm fotografitë e dikurshme. Aparatet e sotme nxjerrin foto të grisura. Po, po, të grisura se u vjen era djegie, sopatë druvari, erë benzinë e vaj motosharrash.

Por, pa u shtyrë më tej në historinë e dhimbshme të një parku turistik drejt shuarjes së plotë, pyetja që shtrohet sot me forcë është: A do të mundemi ta ringremë sërish Lurën nga humbëtira ku gjendet? Dhe, nga do t'i a nisim? Kur? Kush? Ashtu siç e shkatërruam të gjithë, na lipset të mobilizohemi po të gjithë për ta ribërë. Nëse është dikush që e ka kryer sadopak detyrën në këtë mes, kjo është media, kronikat dhe reportazhet e disa televizioneve. Shkatërrimi i Lurës ka qenë në radhë të parë fajësi shtetërore, ndaj është shteti që duhet të vihet në lëvizje i pari për rivitalizimin e saj. Shteti ka strategjitë, mjetet dhe kapacitetet e duhura, instrumentet ligjore, buxhetin etj.

Kohët e fundit është folur se rruga për në Lurë është një ndër përparësitë e Qeverisë, por deri këtu ende mungon ai lajmi i mire megjithëse nga Kastrioti deri në Arras rruga vërtet ka përfunduar e me parametra bashkëkohorë. Nëse do të vazhdojë më tutje do të jetë një mrekulli.

Nëse deri tani kemi disa tregues të turizmit bregdetar, nuk kemi ende asnjë tregues zyrtar të turizmit malor, pa shpërfillur ato kullat mikpritëse të Thethit, si diçka minore në këtë fushë apo luginën e Valbonës, Dardhën e Korçës etj. Po Shqipëria nuk është kaq. Fundja Faiku kërkon që turizmin malor ta shtrijë në Dibër, t'i japë përparësi kësaj treve ende të pazbuluar.

Zona e Katër Grykëve me ato bukuri e mrekulli që ia ka falur natyra afron vërtet një turizëm malor të shkëlqyer si maja e Runjës, si tek liqenet e bukura të Kacnisë dhe kudo që të shkelësh këtu do të befasohesh me mrekulli që syri i njeriut nuk i ka parë në asnjë vend tjetër. Këtu dhe vetë pushteti lokal është i interesuar për ta kthyer këtë zonë në një turizëm malor, por problem mbetet infrastruktura.

Në fakt, jo vetëm zona e Katër Grykëve, jo vetëm Lura, jo vetëm Kalaja e Dodës, por e gjithë Dibra, kudo që të shkelësh, është një mrekulli e turizmit malor që ende nuk është promovuar. Dhe Faik Bruçi i njeh mirë këto zona, i ka shkelur, i ka parë nga afër e shpesh në biseda të ndryshme me miq, shokë e koleg bëhet flamurtari i parë për të promovuar vlerat që mbart e gjithë zona e Dibrës në turizmin malor.



Pamje e Lukanit, Selishtës e Kacnisë, aty ku shumë shpejt do të shtrihen investimet në turizëm të Faik Bruçit. Foto: Agim Totraku

Faik Bruçi, njeri kurajoz dhe me një vullnet të fortë, premton për më shumë. Ambica për punën i jep shtytje dhe asnjëherë nuk kënaqet me atë që ka bërë. Kërkon më shumë nga vetja, nga stafit që punon prej vitesh. Dita e tij e punës shumë e ngarkuar, vonë kur largohen të gjithë, Faiku del nga zyra, por telefonin kurrë nuk e mbyll. Pret në çdo orë të ditës dhe natës telefonata nga më të ndryshmet, sidomos tani që aktiviteti i tij është shtrirë edhe në fushën hotelerisë e turizmit.

MBËSHTETJA PËR ARTIN, KULTURËN E SPORTIN

Faik Bruçi, veç kontributeve në kuadrin e biznesit dhe të aktivitetit ekonomik, ka edhe shume kontribute humanitare e në sponsorizime në fushën e artit, sportit, kulturës e vlerave patriotike e historike të Dibrës. Klubi sportiv "Korabi"në maj të vitit 2006 i ka dhënë Medaljen e "Mirënjohjes" *"Për kontributin e dhënë në mbështetje të ekipit Korabit për arritjen historike të daljes në Superligë"*.

Faik Bruçi është një mbështetës i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Bashkësia Dibrane" si dhe të gazetës "Rruga e Arbërit", që në ditët e para të saj. Veprimtaria e Faik Bruçit si biznesmen, por edhe si kontributor dhe humanist, është një shembull i shkëlqyer i një qytetari të ndershëm dhe të mirë, i cili kurrë nuk e mbylli derën dhe zemrën për njerëzit në nevojë. Emri i tij është bërë tashmë i njohur për të gjithë komunitetin dibran dhe jo vetëm. Jeta dhe veprimtaria e tij, dhe pse larg vendlindjes, nuk është shkëputur kurrë prej saj.

Shumë veprimtari të zhvilluara në Dibër apo në Tiranë, janë të lidhura ngushtë me vendlindjen dhe Dibrën, si në fushën e sportit, artit, kulturës, ndërtimit, turizmit dhe ato humane e bamirësie. Vlerat e tij të humanizmit janë të spikatura në promovimin e vlerave kulturore dhe historike të Dibrës në përgjithësi dhe veçanërisht të Katër Grykëve në veçanti. Ai është jo vetëm ndërtues dhe biznesmen i suksesshëm, por edhe mjaft dashamirës i futbollit dibran. Kontribute të tjera nuk kanë munguar në art e kulturë, ku ka mbështetur vazhdimisht studiues e shkrimtarë dibranë si: Hilmi Kolgjegja, Xhafer Martini, Hysen Dervishi, Shaqir Skarra. Kohët e fundit, Faiku ideoi dhe sposorizoi dokumentarin "Katër Grykët e Dibrës", të shfaqur nga RTSH si dhe videoklipin e Lam Tahirit të shpallur "Qytetar Nderi " i Katër Grykëve.

Ai do të vazhdojë edhe më tej të lërë gjurmë dhe histori me vlerat e tij më të mira, më të spikatura patriotike dhe njerëzore. Për të tillë njerëz vërtet Dibra ka dhe do të ketë gjithmonë nevojë.

Rruga e Arbërit nr. 146

Me punë, me djersë, me sakrifica, Jashar Kurti dhe fëmijët i kanë bërë vend vetes, duke fituar respekt e dinjitet, që përkthehet në më shumë klientelë dhe para.

Jashar Kurti, *shembulli se si suksesi vjen përmes agroturizmit*

Nga **Osman XHILI**



Sapo kishte mbaruar klasën e tetë, kur u nis udhëve të jetës në kërkim të identitetit të tij. E ndjente që kishte shumë për të dhënë, por nuk e dinte se ku dhe si. Baba Izeri, një partizan i vjetër i luftës, një burrë i mençur, që kishte punuar në shtet e në kooperativë, do të ishte një model frymëzimi dhe pikë orientimi për të. Shpatullat i kishte akoma të njoma kur filloi punë në minierën e Bulqizës. Ata minatorë, me kasketa në kokë, ata njerëz, që në vend të parfumit, kishin në fytyrë një tis nga minerali i kromit, do të ishin modelet njerëzore, që do të ndiqte në të ardhmen, bashkë me figurën e babait të tij. Siç luftonin ata me malin, me shkëmbin, ashtu do të sfidonte dhe ai në jetë, në kërkim të gjërave, që nganjëherë dukeshin të pamundura. Punoi jo pak, por pesë vjet. Aty u rrit, u burrërua, mësoi si të fitojë dhe si duhet ndërtuar jeta. Ndërsa punonte, vazhdonte shkollën për teknik miniere dhe ndiqte në të njëjtën kohë, kursin e shoferave. Falë vullnetit të hekurt ia doli mbanë. Mori diplomën e shkollimit të mesëm dhe patentën e shoferit me rezultate shumë të mira.

Dy vite më vonë, kur mbaroi shërbimin ushtarak, e gjeti veten në kabinën e një skode të madhe. Ishin kohë të vështira, dimra të egër, rrugë nëpër male. Ngarkonte tulla, dru, material ndërtimi, duke ndërruar goma, duke bërë defekte, duke lëshuar frymën e tij në duart e ngrira, me shpresën për ti ngrohur sadopak. Kështu u rrokullisën dhe ca vite të tjerë, deri në vitin 1990, kur duhej dhe një dhjetëshe, për tu mbyllur mijëvjeçari i dytë.

FILLIMI I BIZNESIT

Dy tre vite të tjera, punoi akoma si shofer. Fillimisht te biznesi i motrës, në Bulqizë. Ngiste makinën dhe mendja i punonte për të ngritur një biznes të tijin. Nuk duhej shumë njohuri për ta bërë një gjë të tillë. Pak guxim, pak para, shumë korrektesë dhe po kaq ndershmëri. Ai i kishte të gjitha këto, në një shkallë të mjaftueshme dhe mjaftonte të bënte hapin e parë.

E filloi tregtinë me një makinë të vogël. Shkonte e merrte mallin në Tiranë dhe dilte tregjeve, në Peshkopi, në Bulqizë, në Shupenzë, a ku të mundej tjetër. Vite e vite me këtë mënyrë pune, ku dyqani i tij, i vendosur mbi katër rrota, lëvizte sa andej këndej. Lëvizte dhe i shtonte nga pak përmasat, derisa makina e tij e vogël nuk e mbante më. Kishte ardhur koha për tu instaluar diku dhe ai gjeti një mjedis të përshtatshëm në qendër të Maqëllarës. Ashtu siç nisin të gjithë bizneset, me pak mallra, me pak xhiro, me pak klientelë, duke u shtuar më pas, çdo ditë e më tepër. Në krah tani ka dhe tre djemtë e tij, Klevisin, Feratin dhe Ergildin, djem, që kushdo do të dëshironte ti kishte për vete. Të shkolluar, me edukatë dhe besimtarë të devotshëm. Dy më të mëdhenjtë kanë mbaruar arsimin e lartë për financë-bankë, me master, por dhe i treti vazhdon në atë rrugë. Më e vogla e familjes, Juarda, në klasën e gjashtë, duket pak e pezmatuar dhe pa shumë humor këto ditë. Të gjitha notat i ka dhjeta, por vetëm matematikën e ka nëntë, duke i dalë mesatarja 9,9.

Një tjetër biznes ka hapur familja Kurti, këtë radhë në Tiranë. Është një market ushqimor, identik si ky që kanë në Maqëllarë. Dy djemtë e mëdhenj po punojnë dhe po i japin jetë biznesit të tyre. Po mundohen të vënë në jetë teoritë e fituara. Nuk i kërkojnë punë shtetit, e kanë gjetur vetë atë. Me punë, me djersë, me sakrifica, ata i kanë bërë vend vetes, duke fituar respekt e dinjitet, që përkthehet në më shumë klientelë dhe para.

AGROBIZNESI

Plot dhjetë vite më parë, kur shumë njerëz ja kishin drejtuar sytë frutikulturës, Jashari u ndal për një moment, me kokën turbull në mendime. Po sikur të guxonte dhe ai, siç kishte guxuar në gjërat e tjera? Sikur të ngrinte një pemëtore të vogël në fillim, me vetëm pak dynymë? Dhe sikur të humbiste, nuk do të humbiste shumë. Pastaj e kundërshtoi mendimin e parë. "Nuk je lojtar i peshave të lehta", i tha vetes. Të mbillte një hektar? Më shumë akoma. Dy... tre... pesë...? Steka u vendos diku mbi shtatë hektarë dhe aty qëndroi pa lëvizur më. Nuk e kishte të gjithë tokën e tij, gjashtë hektarë i mori me qira për një periudhë 20 vjeçare. Shumicën e mbolli me mollë të variteteve të ndryshme, Starking, Gold, Green Smith, nga të cilat, dy hektarë me distanca të vogla, të mbështetur në tela. Mbolli dhe pesë dynymë me qershi dhe shtatë dynymë me kumbull. Vetëm ai e din se sa para ka harxhuar, sa net ka mbetur pa gjumë dhe sa ëndrra të frikshme ka parë. Sidomos, vitet e para, shumë të vështira. Megjithëse konsultohej me specialistë të fushës, dilnin pengesa të panumërta dhe të paparishikuara. Biznesi i ri i pemëtarisë, i ngjante me një lubi, që po i hante ato kursime që kishte fituar me tregtinë, aq sa para tre-katër vitesh vendosi ti shkulte pemët. Specialistët e bujqësisë ia kundërshtuan mendimin. I thanë të duronte dhe pak, të tentonte sërish e të mos dorëzohej, se ishte fare pranë suksesit.

Rendimentet tashmë kanë ardhur në rritje, por Jashari mendon se ky do të jetë viti i kthesës së madhe. Me qershitë e filloi mbarë. 35 kuintalë të prodhuar i shiti "një dorë, në Kosovë" (siç e përdorin shprehjen tregtarët). Tani po vazhdon me kumbullën e hershme, për t'u pasuar pastaj me mollën. Prodhimi i saj është shumë i mbarë dhe fermeri shpreson të marrë deri në njëmijë kunitalë në total. I ka bërë të gjitha shërbimet në shkallën maksimale: krasitjen, plehërimin organik dhe kimik, punimin, rrallimin, që sapo e ka përfunduar dhe, spërkatjet që i ka në vazhdim.

Jashari ka mbjellë çdo vit dhe kultura të tjera si: misër, fasule, patate, lakër dhe perime të ndryshme. Në të gjithë këtë veprimtari japin ndihmesën por dhe marrin të ardhura jo pak familje të tjera nga fshati i tij, Grazhdani. Po të bësh një llogaritje të thjeshtë, mund të rezultojnë rreth pesë milionë lekë të shpenzuara në këtë mënyrë. Vetëm rrallimit të kokrrave, po t'i referohemi, rezultati do të ishte i tillë. Dhjetë veta, kanë punuar për dy javë, që do të thotë, diku te 1.5 milionë lekë që kanë shkuar te njerëz në nevojë.

Në gjithë këtë veprimtari jo të vogël, Jashari ka pasur heraherës ndihmën e shtetit, por do të dëshironte që këtë ndihmesë ta kishte akoma më të pranishme. Ai e bën vaditjen e pemëve, duke marrë ujin nga liqeni i fshatit, kundrejt një pagese të caktuar. Po të nxirrte puse në tokën e tij, kjo do të ishte më ekonomike, por dhe uji do të ishte më i pastër dhe pa ndotje. Duke e bërë vaditjen në formë pikash dhe një pjesë plehrash kimike do t'i dërgonte përmes sistemit rrënjor, nëpërmjet vaditjes. Gjithashtu, do të dëshironte të subvencionohej nga shteti për ngritjen e një frigoriferi, ku mund të fuste prodhimet e tij, pa pasur frikën e prishjes së frutave. Ngritja e një pike të madhe të grumbullimit të frutave, do të ishte si një rregullator i madh për fermerët e Dibrës. Janë këto, disa nga kërkesat që Jashari dhe fermerë të tjerë i adresojnë tek shteti, një apel për ndihmë, pasi dhe këto, do të dinë që këtë respekt ta shpërblejnë me punë.

Ja kështu, Jashari, bashkë me djemtë dhe me gjithë familjen e tij, punojnë dhe synojnë drejt lartësive të reja. Duan dhe pak të shtojnë tregtinë, duan t'i ngjisin dhe një bllok arrash, pemëtores së tyre. Duan të investojnë në turizmin familjar dhe plot projekte të reja, nga të cilat, do të përfitonim të gjithë.

Profesor Sabriu



Gati të gjithë e njohin profesorin e biokimisë, Sabri Vraniçin, në qytetin e Peshkopisë. Ai tashmë u drejtohet të tetëdhjetave, por asnjëherë nuk shteret, si një pus i begatë, me plot gjëra për tu treguar e për tu dhënë të tjerëve.

Prindërit Demir dhe Shirete Vraniçi, i edukuan fëmijët e tyre me besim, me moral, me dashuri për njerëzit e për krijesat e tjera. Profesori kujton njëherë, kur ishte i vogël e kishte marrë diku një kalli misri për ta pjekur, nënë Shiretja e detyron ta çojë kallirin atje ku e kishte marrë. Ishte ky një mesazh nga ata që zor se harrohen gjatë jetës, duke përcaktuar qartë vijën ndarëse të hallallit dhe haramit.

Shtatëdhjetë vjet më parë Sabriu i vogël vazhdonte shkollën shtatë vjeçare me rezultate të shkëlqyera. . Pasditeve shkonte në fshatin Rashnapojë tek hafiz Tahir Salkurti, duke mësuar KURAN, sure e histori për jetën e Profetit. Ndoshta do ishte bërë hafiz, ndoshta teolog i fesë islame, por marshimi i tij u ndërpre në një moment shumë vendimtar e ju përkushtua vetëm arsimit. Mbaron pedagogjiken, e më pas diplomohet për histori gjeografi e pastaj për biologji e kimi.

Në vitin 1957 vjen mësues në pedagogjike, e më pas nëndrejtor në bujqësore. Bashkë me Mois Camin, asokohe drejtor i shkollës së mesme në qytet, u bënë promotorë për përhapjen e arsimit bujqësor në të gjitha zonat rreth e qark, në Maqellarë, Kastriot, Shupenzë e më gjërë.

Duke pasur dije në shumë fusha të jetës e shkencës profesor Sabriu, bashkë me nxënësit e tij, hulumton dhe eksploron faunën e florën e pasur të vendit tonë. Ndoshta nuk mbeti kënd i tokës shqiptare pa shkelur që nga Lura e Kalaja e Dodës, Saranda e Ksamili, Kukësi e Korça, Tirana e Durrësi. Vizituan miniera të ndryshme, parqe kombëtare, fabrikën e qelqit. Bakri, kromi, seleni apo të tjerë elementë ishin objekt i studimit të tyre. Agrumet e jugut apo pisha flamur e Llogarasë mbetën në memoriet apo fotografitë e studenteve.

Ai kishte kabinetin e biologjisë më të pasurin, të paktën në Dibër. Nje familje ku bashkëjetonte gjarpri, peshqit, bretkosa, zhapiku e plot gjallesa e krijesa të tjera.

Kjo punë stoike e plot vetëmohim vazhdoi deri në vitin 1990, kur profesori u pensionua. Jeta e tij u vu nëdilemë. Si do ta mbushte zbrazëtinë e mësimit? A nuk duhej drejtuar diku tjetër eksperienca e tij e gjatë dhe e begatë?

Angazhime të tjera filluan për profesor Sabriun. Puna me njerëzit i kishte mësuar shumë gjera. I kishte mësuar artin e të kuptuarit të njerëzve, artin e të fituarit të respektit të njerëzve dhe artin e drejtimit të tyre.

Në shkollë kishte drejtuar bashkimet profesionale. Më pas zgjidhet kryetari i këshillit të lagjes. Për dy legjislatura ishte anëtar këshillit të qytetit, ku jep ide e mendime me vlerë. Zgjidhet kryetar i shoqatës së të verbërve, kryetar i kthimit të pronave e sot vazhdon të jetë nënkryetar i veteranëve të rrethit duke marrë pjesë në takime e promovime të shumta.

Por përsëri e përsëri ai ndjente se gjithë kësaj jete të mbushur me angazhime të shumta, i mungonte diçka, si një gjellë e mirë që i është harruar kripa. Gjatë gjithnjë atyre viteve si gjeograf, biolog e kimist ai kishte mbetur i habitur, në mos i mahnitur nga gjithë ato dukuri e fenomene të jashtëzakonshme. Përsëritja e stinëve nga pranvera tek dimri, nata e dita, dielli e hëna dhe planetet të tjerë, pa takuar njëri tjetrin. U kishte shpjeguar studentëve të tij lëvizjen e elektroneve nëpër orbita, ngjashëm me planetet.

Si biolog kishte studiuar trupin e njeriut, ndërtimin e tij, qelizat, indet, organet, rruazat e kuqe, të bardhat, trombocitet, tretjen e ushqimit, e nga çdo kënd që ta shihje dukej një baraspeshë hyjnore. Kush ishte krijuesi e rregullatori? Kishte përdorur ndonjëherë termin "mëma natyrë", por pa u bindur as vetë për këtë. Një term i thatë që nuk thoshte asgjë. Natyra për vete është e krijuar. A mund të krijonte, a mund të prodhonte ajo gjësend?

Jo dhe jo . Gjithë këto kishin një krijues të vetëm, të madhin Allah.

Në këto raste, bile dhe më shpesh, mendja harbonte viteve të largëta të fëmijërisë, kur shkonte tek hafizi i nderuar Tahir Salkurti, për të mësuar Kuran. Shumë vite që atëherë, por jo e pamundur për tu strehuar tek mëshira e Allahut.

E shoqja e tij, Kujtimja, vëlla Rustemi, motra Munire, falnin pesë vaktet dhe e nxisnin të bashkohej në namaz. Profesori kishte vite që agjëronte bashkë me familjen e tij. Do ti shtonte dhe nje shtyllë të fuqishme si namazi, besimit të tij për ti dëshmuar Allahut se është nga të devotshmit. Tashmë e sheh shpesh profesor Sabriun të falë të xhumanë apo ndonjë vakt tjetër në xhaminë ë qytetit bashkë me besimtarë të tjerë.

I duket se jeta e tij ka fituar nje dimension të ri, është shtuar një notë shumë e rëndësishme në pentagramin e jetës, pa të cilën nuk gjëndej përseja, e krijimit njerëzor.

Ndoshta rastësisht emri i tij përkon me një nga cilësitë e tij më të shkëlqyera të jetës së tij, sabrin dhe durimin. Myzhde profesor! Me të vërtetë Allahu është me durimtarët.

Osman Xhili

Me rastin e 70-vjetorit të Shkollës së Mesme Pedagogjike të Dibrës.

Kujtimet e një pedagogjikasi

Nga **Shemsi MANJANI**

Ndër kujtimet e periudhës shkollore, ato të viteve të shkollës së mesme, si për mësuesit ashtu dhe për nxënësit, janë më të shumtë e më mbresëlënës. Ndodh kjo për faktin se lidhjet nxënës-nxënës, nxënës-mësues kanë një përmbajtje më të pasur e më të qëndrueshme se sa në çdo kategori tjetër të shkollave, përfshirë dhe ato të shkollave të larta, me lidhje e afrim më të zbehtë. Për nxënësit janë kujtime të moshës së rinisë, moshës së energjisë, përpjekjeve, shpresave, dashurive e dëshirave të zjarrta për t'u arsimuar e qenë dikush në jetë, për t'i shërbyer sa më mirë vetes, familjes dhe shoqërisë. Është mosha më e lidhur me mësuesit për qëllimet e sipërme, me besimin e respektin më të madh për ta.

Vetë mësuesit e këtyre shkollave janë më të angazhuar në detyrën e tyre duke ndjerë kënaqësi në arritjen e rezultateve sa më pozitive, rezultate që, siç është provuar në shumicën e rasteve, përcaktojnë ecurinë e arritjet e këtyre nxënësve në jetë. Kënaqësi ndjejnë këta mësues edhe në moshën e pleqërisë të larguar prej vitesh nga detyra. Ndjehet kjo kur të takojnë me përzemërsi ish nxënësit e tu, disa dhe pensionistë, kur të dërgojnë të fala apo urime, kur të bëjnë vizita apo të ftojnë në promovimin e librave të tyre..Akoma më shumë, kur mëson për arritje të dallueshme gjatë jetës në detyrat që kanë kryer apo kryejnë, përfshirë edhe arritjet e fëmijëve të tyre që janë dhurata mbi të gjitha dhuratat e jetës për çdo familje.

Mendimet e mësipërme mbështeten kryesisht nga përvoja disavjeçare si nxënës, mësues e drejtues në shkollën e parë të mesme Pedagogjike të Dibrës, që u hap 70 vite më parë, shkollë për gjithë zonën verilindore të vendit tonë. Veçanërisht ne më të moshuarit, sot mbi 80-vjeçarë, ish nxënës e mësues në këtë shkollë, të paktë në numër, të rralluar e të përmalluar për ish nxënësit tonë pedagogjikas e për njëri-tjetrin, ruajmë kujtime të shumta.

Mua më shoqëruan këto kujtime duke mbetur të freskëta dhe pasi u largova nga pedagogjikja me mbylljen e parë të saj ngaqë me këta, ish nxënësit e mi, do të vazhdonte një lidhje tjetër ato mësues e drejtorë, unë në Seksion të Arsimit e Kulturës, drejtues i tyre me konsiderata reciproke që në vitet e shkollës , kënaqësia më e veçantë në këtë detyrë me probleme e shqetësime të vazhdueshme. Ndjeja kënaqësi kur gjatë viteve të punës në seksion, shkoja nëpër shkolla për të parë punën e ish-pedagogjikasve, i mirëpritur nga ata, apo kur vinin në seksion për ndonjë kërkesë apo problem tjetër, të pritur nga unë me përzemërsi. Nuk i harroj qëndrimet e tyre pozitive edhe në rastet kur nuk kisha mundësi t'ua plotësoja kërkesat, siç më ndodhte ndryshe me disa të tjerë, të njohur me mua prej vitesh, me një qëndrim hatërmbetës, kur nuk u plotësohej kërkesa.

Ringjallja e kujtimeve do të vazhdonte jo vetëm në takimet e mësipërme e të tjera si këto, por dhe shumë vite më vonë kur isha në pension. Mbresa të bukura më kanë lënë kremtimet e përvjetorëve të maturave në Peshkopi, pranë ish-Shkollës Pedagogjike me pjesëmarrjen dhe të mësuesve, ku gëzimi e hareja arrinte kulmin. Takimi i fundit shumë mbresëlënës, 50-vjetori i maturës të vitit 1967, maturës që shënoi mbylljen e parë të pedagogjikes, u bë në vitin që shkoi. Unë, fillimisht ftesës së bërë me telefon nga Kryetari i Komisionit, Ilmi Cani, ju përgjigja me pamundësinë për pjesëmarrje nga rruga e largët, e pabërballueshme nga mosha, apo gjendja shëndetësore. Ndërrova mendim, kur ai me të drejtë, nguli këmbë për t'i përballuar këto vështirësi nisur nga fakti se ky ishte 50-vjetori i klasës jo vetëm kur unë kisha qenë mësues e drejtor, por më e rëndësishmja, e harruar prej meje për t'u vlerësuar, ngaqë ishte klasa ku mësuese kujdestare për katër vite kishte qenë bashkëshortja ime e ndarë nga jeta 25 vite më parë, me shumë konsiderata për të nga ajo klasë dhe të gjithë pedagogjikasit pa përjashtim. Atë takim nuk do ta harroj kurrë. Disa nga ish nxënësit kishin ardhur me bashkëshortët apo bashkëshortet e tyre. Për t'u përmendur çifti Ballabani nga Burreli, të dashuruar që kur ishin nxënës në pedagogjike.

Në muajin prill të këtij viti, më qëlloi që të kisha një takim jo vetëm mbresëlënës por dhe të papritur e të pamenduar. - Jam Hajdar Haxhihyseni, më thotë me zë të ulët në telefon. Nesër do të vij nga Durrësi në Tiranë, vetëm për t'ju takuar. Kam mall. Në moment u befasova. Ishte ish kujdestari i konviktit të shkollës pedagogjike i viteve të para, elbasanas, për të cilin kisha vite pa dëgjuar. Refuzoi dëshirën time që unë të shkoja në Durrës për t'u takuar, gjë që sipas mendimit tim më takonte. Ndahemi nga biseda e shkurtër, duke lënë orën dhe vendin ku do ta prisja në Tiranë.



Foto nga takimi me Hajdar Haxhihysenin (majtas)

Takimi qe shumë i përmallshëm më të dhe djalin e tij që e kishte sjellë me makinë. E si të mos ishte i tillë? Takoheshim pas më shumë se 60 vitesh, ai që në ato vite kishte lënë gjurmë të pashlyera punë e përkushtim për ne, sot 89 vjeçar dhe unë(ish konviktor në ato vite), sot 84 vjeçar. Që në fillim të bisedës u shua kurioziteti se si i kishte lindur mendimi e dëshira për të më takua. Kishte pasur njohje me Gafurr Zotën, historian, ish mësues e drejtues, tani banues në Durrës, i cili i kishte dhënë një ditë gazetën lokale të Dibrës "Rruga e Arbërit", për lexim, ku ishte një shkrim imi me titull "Shkolla pedagogjike e Dibrës, vatër e ndritur e dijes për gjithë zonën verilindore" shkrim sensibilizues për të kremtuar 70-vjetorin e saj. Shkrimi e kishte emocionuar duke i kujtuar atë periudhë, marrëdhëniet me ne. Sapo mësova për mundësinë që na kishte krijuar për këtë takim shumë të mirëpritur nga unë e ftova Gafurrin të na bashkohej ne takim. Bisedat vazhduan me ish kujdestarin tonë të nderuar nga mëngjesi deri në orët e pasdites.

Fillimisht unë shpreha disa konsiderata për të që tërhoqën vëmendjen dhe të djalit të tij, Ardjanit, në moshë mbi të pesëdhjetat, të cilin gjithashtu e falenderova për gatishmërinë për të ardhur dhe sjellë në këtë takim babain e tij, shumë të nderuar e të respektuar, të paharruar nga ne. Përmenda përkushtimin dhe interesimin e tij të vazhdueshëm për ne konviktorët, për gjendjen tonë shëndetësore, për përparimin në mësime duke u përqendruar tek vlerësimi për orët e studimit, për të mos munguar e mbajtur rregull e qetësi. Shumë i lidhur me prindërit tonë që vinin shpesh për të na takuar. Kënaqësi të veçantë na jepte në organizimin e aktiviteteve në kohën e lirë, sidomos ato sportive, lojërat me top, duke luajtur me ne në oborrin e shkollës, përveç aktivizimit të tij në ekipin përfaqësues të rrethit në futboll, ku ishte një ndër më të mirët. Për herë të parë na solli një tavolinë ping-pongu e na njohu me këtë lojë, shumë të preferuar nga ne dhe disa mësues. I pari ai që na ngjalli dashurinë për sportin. Disa prej nesh në futboll dhe ping-pong,në atë kohë e shumë vite më vonë, do të përfaqësonim rrethin në aktivitetet kombëtare përfshirë dhe lojën e volejbollit. Nuk mund të lihet pa u përmendur kontributi i tij në veprimtarinë artistike. I papërtuar tregohej në mbrëmjet e vallëzimit që organizoheshin në shkollë duke mos e hequr nga krahët fizarmonikën me orë të tëra, të vetmen vegël muzikore që kishim, të cilën vetëm ai dinte ta përdorte. Ndonjëherë i entuziazmuar ngrihej nga vendi, futej në mes nesh që ishim në valle apo në vallëzim duke i rënë fizarmonikës.

Ish kujdestar Hajdari, fillimisht shprehu interes dhe i tregova për ne dibranët që në kohën e tij ishim konviktorë e që pas mbarimit të studimeve të larta do të ktheheshim si mësues e drejtues të kësaj shkolle e shkollave të tjera të mesme e arsimit e kultures në shkallë rrethi etj. Ndamë opinione e kujtime për të ndjerët, Zenel Sula Mois Cami dhe Nuri Abdiu. Për Nuri Abdiun, ish pedagogjikasi i parë me tituj të lartë, "Profesor-Doktor", "Mësues i Popullit", etj., i ndarë nga jeta më 29 prill 2014, dinte shumë, përfshi dhe për studimet e tij në Bashkimin Sovjetik, e disa vite zëvendës-drejtor në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Mois Cami, i përkushtuar në të gjitha shkollat ku punoi e drejtoi, "Mësues i Merituar", shef i seksionit të arsimit dhe kulturës, deputet i parë nga radhët e arsimit, ndarë nga jeta në vitin 1991. Zenel Sula, nxënës i shkëlqyer i pedagogjikes, i pari nga kjo shkollë që shkoi për studime në BS, ku përfundoi po me rezultate të shkëlqyera, disa vite Drejtor i Pedagogjikes e specialist në Ministrinë e Arsimit, i ndarë nga jeta në vitin 2016. Pas interesimit të tij, në vijim i tregova mikut tim të vjetër Hajdar Haxhihysenit, gjithçka për Ismail Erebarën, ish mësuesin e drejtuesin e përkushtuar në shkollat e qytetit;kujtuam Riza Likën, të ndjerin Esat Caka etj.

I kujtova dhe dy pedagogjikas të tjerë të shkëlqyer, të kohës së tij, që nuk i mbante mend, Shefqet Hoxhën nga Kukësi dhe Esat Sulën nga Mati. Shefqet Hoxha, ish nxënës i shkëlqyer në pedagogjike dhe në universitet me korrespondencë, me shumë kontribute në arsim, me tituj "Mësues i Popullit", "Profesor i Asociuar", "Doktor i Shkencave", deputet një legjislaturë. Ka botuar deri më sot 60 libra, rast i veçantë. Edhe sot në moshën 84 vjeçare, e gjen çdo ditë në Bibliotekën Kombëtare duke studiuar e shkruar. Esat Sula, ish nxënës i pedagogjikes që mbaroi gjithashtu shkëlqyeshëm, me kontribute si mësues i fizikës në gjimnazin e Burrelit e drejtor në këtë shkollë. E veçanta për të, drejtoi për 12 vite seksionin e arsimit e Kulturës në rrethin e Matit, i dyti në Shqipëri për numrin e viteve në këtë detyrë, pas legjendës së arsimit dibranë, "Mësuesit të Popullit", Selim Alliu, i cili drejtoi arsimin në Dibër mbi 20 vjet.

Kujdestar Hajdari u gëzua shumë kur mësoi për respektin që kishim treguar ne ish nxënësit e tij për Jorgji Sinjarin, i ardhur nga Berati, që krijoi familjen në Dibër, për shkrimin për të në gazetën lokale. Po kështu shkrimet që bëmë për dy drejtorët e Pedagogjikes, Shefik Osmani e Zenel Sula, përfshirë dhe përkujtimin e 80-vjetorit të jetës së tyre, ku së bashku me ta, ishin ish mësues të tjerë të kësaj shkolle të atyre viteve të para.

Së fundi, me kujdestar Hajdarin ndamë të njëjtin mendim se shkolla pedagogjike e Dibrës, falë personelit të kualifikuar dhe përkushtimit të tyre, ndër vite ka nxjerrë nxënës të shkëlqyer, të cilët pas mbarimit të studimeve të larta u shquan në fushat ku punuan. Përmendëm disa ish pedagogjikas të periudhave e rretheve të ndryshme, me disa arritje të dallueshme si shkrimtarë, diplomat, gazetarë, artistë, sportistë, historian, deputetë, ushtarakë, drejtues apo punonjës të institucioneve të ndryshme, shumë prej tyre me tituj shkencorë. Për t'ju përmbajtur hapësirës së shkrimit ndalemi vetëm tek disa:

Shaban Sinani, Profesor Doktor, studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar, shumë i vlerësuar në drejtimet e mësipërme nga studiues e personalitete vendas dhe të huaj. Ish pedagogjikas me shkëlqim të pandërprerë prej atëherë e deri më sot, kudo ku punoi e drejtoi, Akademiku i parë dibran, një nga njerëzit e studiuesit e rrallë të kulturës e shkencë shqiptare. Ka botuar mbi 35 libra. Librat dhe studimet e tij kanë të veçantë se, veç cilësisë së lartë, trajtojnë probleme madhore të kombit, kulturës dhe letërsisë shqiptare, nga letërsia e Kadaresë, Dritëro Agollit e disa të tjerëve, te Kodikët e Beratit, nga studimet madhore për Mitologjinë shqiptare apo Ciklin e Kreshnikëve, tek pritja dhe shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri.

Xhafer Martini, shkrimtar i mirënjohur, botues i tre romaneve, 10 monografive, 11 librave studimorë, disa tregime, përralla, poema, letërsi për fëmijë, disa poezi e tregime që i përkasin letërsisë artistike, shumë shkrime me vlerë të botuara në gazetën "Rruga e Arbërit" e organe të tjera.

Naim Plaku, mësues i pasionuar e i talentuar i gjuhës dhe letërsisë, me disa botime në këto drejtime. Duke qenë bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Kulturës Popullore e atij të Gjuhësisë dhe Letërsisë, ka dhënë një kontribut me vlerë në mbledhjen dhe studimin e folklorit letrar, leksikut dhe dialekteve të shqipes. Shumë I përmendur për dhjetëra poezi e tekste këngësh, shumë prej tyre të botuara në librin "Fllad e Frullizë" botuar në vitin 2006.

Abdi Baleta, matjan, i shkëlqyer në pedagogjike. I dalluar si diplomat së bashku me disa të tjerë ish pedagogjikas si Sulejman Tomçini, Përparim Sinani, Maxhun Peka, Lazam Koldashi, Ivzi Çipuri, Adem Ymeri, etj. Baleta, disa vite përfaqësues i vendit tonë në OKB, në një rast shumë i duartrokitur në Parlamentin e parë pluralist shqiptar, duke folur për marrëdhëniet dhe problemet e vendit tonë me një nga vendet fqinje, botuesi gazetës "Rimëkëmbja" dhe i 10 librave si "Dilema Historike", "Kundërshpifografi", etj. Botues i shumë shkrimeve me vlerë në vazhdimësi edhe sot, të botuara çdo muaj në faqet e para të revistës "Shenja", revistë e përmuajshme, mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore.

Të njohur janë në të gjithë Shqipërinë e më gjerë, ish pedagogjikasit drejtues në organet qendrore të partisë, pushtetit e institucioneve kryesore të vendit, Xhelil Gjoni, dy ministra, Tefta Cami e Safet Zhulali, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Fehmi Abdiu, Kryetarja e Bashkimit te Grave të Shqipërisë Lumturi Rexha etj.

Të gjithë ruajmë kujtimet më të mira për Shkollën Pedagogjike të Dibrës, që rrezatoi dritën e dijes në gjithë zonën verilindore, elita e parë për përgatitjen e mësuesve dhe gjenerimin e personaliteteve vendase, të munguar prej shumë vitesh.

U promovua në Muzeun Kombëtar libri i ri i publicistit e shkrimtarit Halil Rama


Për librin **"Lutfi Ndreu, mësues dhe artist"**

Prof.dr.Bujar KAPEXHIU
"Mjeshtër i Madh"

Kur dikush, mik i afërt apo një i panjohur që ta njeh sado pak përkushtimin e përvojën dhe sidomos gatishmërinë dhe dashamirësinë për të kontribuar në një proces krijues apo veprimtari vlerësuese, të kërkon të shkruash për një personazh të njohur, e ke të vështirë të kundërshtosh apo, për mirësjellje, të sajosh e të renditësh argumente e pengesa që ta bindësh sado pak porositësin se koha dhe detyrat e përditshme të pengojnë ta kryesh këtë kërkesë. Kështu më ndodhi edhe mua me shkrimtarin Halil Rama, kur më ofroi librin e tij të fundit. Nuk guxova për asnjë çast të ngurroja me një heshtje të gjatë, me një mbledhje buzësh, kruajtje koke apo përpëlitje qepallash e belbëzime pa kuptim, shenja këto që paraprijnë çastin e kundërshtimit. Jo! Për më tepër kur vura re faqen e kopertinës së librit, ku ishte fotografia e z. Lutfi Ndreu si dhe titulli aq domethënës "Mësues dhe artist".

Zakonisht, në këto rrethana, ke drojën se nga e si do t'ia nisësh, ku të përqendrohesh, dilema çfarë të thuash. Mirëpo tek unë nuk ndodhi ky ortek pyetjesh, ngaqë gjëja më e lehtë dhe më e këndshme është të flasësh për mësuesin dhe artistin e aq më tepër kjo bëhet më tërheqëse kur këto dy profesione mishërohen te një njeri i vetëm. Kjo e pasuron lëndën. Nuk mund të them se edhe në këtë rast nuk m'u faneps përsëri një pyetje. E thjeshtë. Para se pena ime të prekte letrën, më erdhi pyetja: Të flas për Lutfiun, apo për librin? Më e lehtë dhe më e arsyeshme ishte ajo që ndjeva brenda vetes: të flas për të dy! Pra, po filloj me Lutfiun. E kam njohur Lutfiun shumë vonë, në veprimtari të ndryshme që kemi organizuar me komunitetin dibran. Një burrë me fytyrë të prerë, flokë të dendur, që me buzëqeshjen e çiltër dhe shkëlqimin e syve shoqëron shtrëngimin e dorës dhe përkuljen tradicionale burrërore, me pjesën anësore të ballit prek atë të tjetrit në çastin e përshëndetjes. Në çdo pyetje që i bën të përgjigjet shkurt, qartë, me butësi dhe i gjithë ky angazhim është i ambalazhuar bukur me modesti. Që në takimin e parë e ndien që ke përballë një njeri fisnik, të shkolluar, që di të komunikojë me delikatesë, duke shprehur dashamirësinë pa e kursyer buzëqeshjen dhe respektin për bashkëfolësin. Këto karakteristika të natyrës së tij, të fiksuara nga unë që në çastin e parë të takimit, më kaluan si në një sekuencë filmi sapo vështrimin e përqendrova te kopertina e librit dhe njoha Lutfi Ndreun... Aq më tepër që me mbiemrin Ndreu kam shumë njohje e miqësi letrare, artistike, familjare e shoqërore. Kurioziteti më shtyu më tutje për t'u futur nëpër faqet e librit. Humba midis tyre dhe e kapa veten në befasi, sikur po ecja në një sallë rrethuar me mure të larta, mbi faqet e bardha gjenden të varura shumë fotografi. Në to janë të fiksuara pamje të vetëm një personazhi në mjedise të ndryshme, i rrethuar nga shumë njerëz të njohur e të panjohur, nëpër veprimtari pedagogjike dhe artistike. Diku me pamje

Më e rëndësishmja e më e pëlqyeshmja është se në rreshtin e gjatë të njerëzve me vlerë, dibranëve të rrallë, që njëri pas tjetrit hedhin hapin e tyre në rrugë e lavdisë së Dibrës, shtohet edhe një personazh, një qytetar, që ia ka kushtuar jetën, punën, dijen dhe shpirtin kësaj toke ...



të përgjithshme e diku tjetër ky personazh i vetmuar, herë bardhezi e herë me ngjyra, që vepron e flet me natyrshmëri e sinqeritet për gjithçka kërkon misioni i mësuesit dhe i artistit. Këtë sallon artistik dua ta përshkruaj shkurt. Sallon plot me fotografi të realizuara nga "fotografi" Halil Rama, që me aparatin e tij të cilësisë së lartë e ka fiksuar personazhin e tij qysh në fëmijëri e në rini, mësues e prind, artist e qytetar. Ndoshta fjala "fotografi" duket paksa e jashtme, e ftohtë, statike, por konstatova që "aparati fotografik" i Halilit është krejt ndryshe nga ata të markave të tjera, sepse aty nuk gjen vetëm pamjen e jashtme, konturet apo tiparet e ngurta të personazhit, por gjen dhe ndien analizën e hollësishme, të brendshme e dinamike me mendimet, idetë, pasionin, emocionin e dashamirësinë e mësuesit. Gjen shpirtin, gjallërinë dhe origjinalitetin e artistit, fisnikërinë e seriozitetin e qytetarit, dashurinë e përkushtimin si prind, çiltërsinë e besnikërinë si mik, dhe korrektesën si shok apo koleg. Ai lexues që do të shfletojë faqet e këtij libri ka të drejtën dhe besueshmërinë që të thotë pa droje se ka vizituar një sallon fotografik ku ka parë, e jo vetëm kaq, por edhe ka ndier e ka prekur figurën e një personazhi me vlerë e bashkë me të ka kaluar nëpër të gjitha shtigjet ku ndër vite ky personazh ka hedhur hapin e tij herë energjik e herë të lodhur, por gjithnjë optimist e tejpamës për jetën dhe misionin e tij. Ndoshta nuk është çudi që edhe lexuesi të ndihet i ulur në bankën e klasës e të ndjekë zërin e plotë e të ëmbël të Lutfiut mësues në shpjegimin e mësimit dhe herë pas here të shohë nga afër me sytë e tij sesi ky mësues vendos dorën mbi kokën e nxënësve e shpupuris me përkëdheli flokët e pakrehur të këtyre vocërrakëve që vijnë nga larg, në shi e në dëborë, me duart e skuqura nga të ftohtit, për të mbushur vijat e fletores me germat magjike të gjuhës që flet mësuesi, prindërit, fshatarët e ata vetë.

Humori, siç thuhet, është privilegj i të mençurve dhe brenda shpirtit e mendjes së Lutfiut bën që ai gjithnjë, në çdo takim a bisedë me miq e shokë, të jetë i ngrohtë, befasues, i mençur dhe gazmor. Jo vetëm për vete. Gëzimin, harenë e të qeshurën ai ua dhuron edhe të tjerëve, e përcjell atë me shpirtmadhësi, sepse ndien që gëzimi, hareja, e qeshura e të tjerëve e kënaq dhe e ngazëllen edhe atë vetë. Aq më tepër kur ndien origjinalitetin dhe krenarinë që në shumë raste është ai shkaktari, udhërrëfyesi dhe shpërthyesi i atmosferës gazmore.

Unë e kam thënë dhe e kam përsëritur shpesh, ndoshta edhe e kam tepruar, por po e them haptas, pa modesti, se më pëlqen gjetja që ... "nuk është e rastit që fjala Dibër rimon bukur me fjalën Libër".
Ja, pra, edhe kjo vepër e Halilit, si shumë të tjera krijime të tij, përforcojnë dhe e bëjnë legjitim kombinimin Dibër-Libër.

Buzëqeshja nuk mungon kurrë në portretin e Lutfiut kur ai bisedon me të tjerët, qofshin cilëtdo, miq, shokë, të njohur apo të saponjohur, pleq a fëmijë. Buzëqeshja e Lutfiut shoqëron rrugëtimin e çdo bisede, arsyetim për çdo problem e jo rrallë, me modestinë e fisnikërinë e tij, ai edhe vërejtjen apo kritikën e shoqëron me buzëqeshje, që tjetrit të mos i vijë e rëndë, e ashpër, e papranueshme e kundërshtuese. Pikërisht kjo e bën Lutfiun të jetë serioz me buzëqeshjen e tij. Personalitet me shpirt të lirë, që me humorin e mençur gjen hapësirën e merituar të mikpritjes në shoqërinë dibrane. Dihet nga të gjithë, tashmë vetë jeta na e ka vërtetuar se njerëzit me shpirt të mirë, fisnikë e dashamirës, gazmorë e hokatarë kanë të rezervuar një vend të veçantë e janë të mirëpritur në shoqëri në çdo mjedis, në çdo tavolinë, në çdo Odë. Prandaj jam i sigurt se, sipas zakonit e traditës së Odës Dibrane, Lutfiu në këtë moshë me siguri e ka vendin në krye të Odës, në qoshe të oxhakut, rrethuar nga miq e shokë, ku të gjithë presin që biseda të nisë me fjalën e tij. Lutfiu nuk heziton, por me korrektesë, me përkushtim e vërtetësi është i gatshëm të japë mendime e vlerësime për figura të ndryshme dibrane që kanë një vend të veçantë në altarin e historisë së Dibrës. Këtu kujtoj shkrimin vlerësues për Mjeshtrin e Madh Hazis Ndreu, në librin tim "Burri i Odës Dibrane". Këtu gjej rastin ta falënderoj zotin Lutfi Ndreu për ndihmesën që ka dhënë me shkrimin e tij për plotësimin e figurës së mikut, mësuesit, kolegut dhe udhërrëfyesit të tij. Nuk dua të përmend shumë episode interesante nga jeta, gazmore apo të trishtuara, situata të thjeshta apo të ndërlikuara, batuta të mençura plot humor, sepse dua të ruaj kuriozitetin e lexuesit dhe vlerësimin e plotë për Lutfiun dhe për Halilin, që ka ditur të përshkruajë me mjeshtëri e të rendisë në mënyrë logjike dhe artistike përgjatë gjithë rrjedhës së përshkrimit të këtij subjekti origjinal.

Struktura kompozicionale e renditjes së fakteve është bërë në mënyrë kronologjike, gjë që ndihmon të ndjekësh me lehtësi rrugën që ka bërë vetë personazhi gjatë jetës së tij. Në këtë mënyrë lexuesi bëhet bashkudhëtar me personazhin, duke njohur vendlindjen e duke rrugëtuar më tutje në fëmijëri, rini, jetën ushtarake, mësuesinë dhe kontributin letrar dhe artistik. Me një gjuhë të thjeshtë, pa "kaçurrela" artistike, pa figura të stisura, të cilat e sforcojnë dhe mjegullojnë natyrshmërinë dhe thjeshtësinë e vetë karakterit dhe jetës së personazhit, autori ka marrë përsipër ta përshkruajë atë me pasion, përkushtim, respekt e mirënjohje. Aty ku shkrimtari është i ftohtë e racional në shtjellimin historik të fakteve, pikërisht aty, në vazhdimësi, bëhet emocional me ndërhyrjen e rrëfenjave të Lutfiut, që përshkruan aq bukur si tregimtar me origjinalitet ndodhitë me shokët, me familjarët në shtëpi, në zyrë, në repart, në shkollë apo në grupet artistike. Pikërisht kjo ndërthurje tregimtar-personazh i jep shkrimit larmi dhe lexuesi e merr informacionin parapërgatitës nga autori Rama. Dhe më tej në lexim ndihet fare afër personazhit Ndreu me batutat, veprimet dhe emocionet e rastit. Kjo formë e servirjes së lëndës është si ajo metoda e amvisave dibrane që, para se të pjekin pulën, i japin një valë dhe më pas e futin në furrë, duke qenë të sigurta që mishi do të dalë me ngjyrën e kuqërremtë, më i butë e më i shijshëm dhe do përtypet më me lehtësi, duke ndier kënaqësinë e artit kulinar. Kështu edhe lexuesi, me këtë stil të të shkruarit, do të "përtypë" paragrafët e këtij libri duke shijuar e ndier kënaqësinë e artit të të shkruarit të "gatuesit" Rama. Interesante janë në faqet e këtij libri çastet humoristike me batuta, ndodhi, fakte apo histori gazmore, me anë të të cilave i jepet lëndës një vërtetësi jetësore, duke theksuar këtë veçori të rrallë të personazhit, që me humor krijon atmosferë gazmore në shoqëri e në familje, duke mos lënë mënjanë aftësinë e pasionin për të krijuar humor me shkrimet e tij, si në shtypin e kohës ashtu edhe në repertorin e Estradës së Dibrës. Lutfiu bën humor, ai është serioz sepse qesh kur duhet, ku duhet dhe sa duhet. Të tria këto "kur", "ku" dhe "sa" e bëjnë njeriun serioz edhe pse qesh. Një cilësi tjetër e shkrimit, e veçantë dhe e pakursyer në këtë libër, është përmendja me emra e të gjithë njerëzve që kanë bashkëpunuar me Lutfiun. Shokë e shoqe, kolegë arsimtarë e artistë, apo dhe personazhe të tjerë që i ndeshim në udhëtimin e bëmat e Lutfiut nga njëra zyrë te tjetra, nga një fshat i afërt në tjetrin më larg, civil e ushtarak, epror apo vartës, të gjithë me emër e mbiemër, duke e bërë tregimin më të besueshëm e më të dokumentuar, duke u dhënë edhe të tjerëve kënaqësinë si dëshmitarë pranë këtij qytetari të mirë, të mençur e fisnik.

E theksova qysh në fillim të kësaj hyrjeje se të shkruash e të flasësh për personazhe të këtillë nuk është e vështirë, sepse ke çfarë thua. Është njëlloj sikur të peshkosh në një rezervat peshku, ku peshqit përplasen me njëri-tjetrin, kush e kush të kapë më parë grepin. Kështu edhe në penën e Halilit, germa, fjalë, fraza e paragrafë të tërë, njëri pas tjetrit, madje edhe duke u shtyrë kush të zinte majën e penës që të rreshtohej në faqen e librit. Dhe Halili, si nikoqir i mirë ka ditur me mjeshtëri të rreshtojë më të bukurat fjalë, më të vërtetat mendime, më të saktat argumente, më të rrallat e më të ndjerat emocione, për të fiksuar në tablonë e tij jo vetëm bardhezi, por me ngjyrat më të këndshme figurën e Lutfiut.

Unë e kam thënë dhe e kam përsëritur shpesh, ndoshta edhe e kam tepruar, por po e them haptas, pa modesti, se më pëlqen gjetja që ... "nuk është e rastit që fjala Dibër rimon bukur me fjalën Libër". Ja, pra, edhe kjo vepër e Halilit, si shumë të tjera krijime të tij, përforcojnë dhe e bëjnë legjitim kombinimin Dibër-Libër. Në bibliotekat tona, në rreshtin e gjatë të librave radhitet edhe një tjetër. Interesant, origjinal e dinjitoz. Por nuk është vetëm kjo. Më e rëndësishmja e më e pëlqyeshmja është se në rreshtin e gjatë të njerëzve me vlerë, dibranëve të rrallë, që njëri pas tjetrit hedhin hapin e tyre në rrugë e lavdisë së Dibrës, shtohet edhe një personazh, një qytetar, që ia ka kushtuar jetën, punën, dijen dhe shpirtin kësaj toke që ka historinë më të lavdishme se cilado tjetër. Le të kalojë ky libër në duart e fëmijëve dhe nipërve tanë, që nëpërmjet faqeve të tij të njohin historinë, njerëzit, punën, sakrificat dhe triumfin e së mirës, e së bukurës, fisnikërisë dhe atdhedashurisë.

meditim

Ku ishe ti or mec - memec kur digjej e përçudnohej Shqipëria?

Nga **Abdurahim ASHIKU**
Gazetar, Athinë

Vonë u kujtove, shumë vonë...
U kujtove kur në mjekrën tënde të aktorit minjtë jo vetëm bënë rrugë e autostrada, por vila e grataciela...

Në fillimet, kur Shqipëria nisi të shkatërrohej e përçudnohej ishe një *mec i sapolindur, mec – memec që nuk të dilte zëri as ti kërkoje nënës qumështin e gjirit.

Ishe ulur në një karrige parlamenti dhe nuk nxirrje zë. Vetëm dorën ngrije kur të kërkohej vota për "çekun e bardhë", kur thirrja "kuota zero" drithëronte edhe vxhenjt* në barkun e nënës.

Unë asokohe isha një gazetar në provincë që nuk praja së shkruari për atë që shkatërrohej e përçudnohej. Shkruaja për "komandantin" tënd që në Blliçe të Dibrës jepte kushtrimin që pemëtoret e mëdha të Kastriotit të ktheheshin në kullota. Kam në arkivin tim një fotografi një ditë më pas, mollët e Kastriotit të prera e cungjet e pemëve si varre osmanlinjsh pas betejës në atë vend të Torviollit të Skënderbeut. Kam edhe një fotografi të bllokut më të madh të arrave në Ballkan (mbjellë në vitin 1960, ndër të tjerë edhe nga piketimi im) prerë në rrëzë e drurët dërguar nuk e di se ku përtej detit...

Shkruaja për "Komandantin" tënd që në Maqellarë bënte thirrje për shkatërrimin e objekteve social kulturore; çerdheve, kopshteve, vatrave të kulturës. E kam në kujtesë por edhe në arkivin tim fotografik pamjen e asaj masakre që do ti dhimbte në palcë edhe tërmetit të 30 nëntorit 1967, më i madhi dhe më shkatërruesi për Dibrën. Shkruaja për ndërmarrjen ushqimore të Peshkopisë që mblidhte dhe përpunonte mbi njëqind mijë kuintal fruta e perime e punësonte në pikun e prodhimit dhe përpunimit tremijë qytetarë të Peshkopisë e të zonave përreth. E shkatërruan deri në themele ashtu siç shkatërruan edhe uzinën mekanike, fabrikën e përpunimit të qumështit me teknologjinë më moderne të kohës, ndërmarrjen e prodhimeve të ndryshme, parkun e mallrave, stallat e blegtorisë... Shkruaja për një punonjës kulture në Zall-dardhë, Xhelal Çerpën që i vuri gjoksin portës së shtëpisë së kulturës që të mos hynte "kuota zero" për ti vënë flakën pasurisë më të madhe folklorike të trevës më artdashëse të Dibrës, Dardhës me zë të madh në kulturën shqiptare. Shkruaja për pallatin e kulturës të Lurës, fryt i djersës së popullit të saj, një më të bukurit në Shqipëri (dhe më të dhimbshmin në vlerën e ditës së punës) se si e prenë më mes e në themelet e tij ngritën një xhami a thua se në atë peizazh të virgjër e të lirë nuk kishte vend për themele të tjerë! Shkruaja për shkatërrimin e minierës së Bulqizës që ndërtoi Shqipërinë...

Këto, ulur në kolltukun e butë të deputetit në sallën e parlamentit më djegës e shkatërrues të Shqipërisë, nuk i shihje, nuk kishe gojë të fliste, ta kishte mbyllur regjisori i dhimbjes më të madhe historike shqiptare.

Edhe djegien e gazetës "Koha jonë", monumentit më prestigjioz të fjalës së lirë shqiptare, nuk e shihje ashtu siç nuk shihje tërë Tiranën në shkatërrim në lindje, nga rrëza e Dajtit me kombinatin e auto traktorëve e në perëndim, kombinatin e tekstileve... Nuk shihje as kinematë ikona historike të kryeqytetit ("17 Nëntori", "Partizani", "Republika"...) si binin si zogj të ngordhur nga acari i dimrit "demokratik".

Nuk fole as kur u dhunuan, u vodhën, u shkatërruan objektet e kultit, kur ikonat e mjeshtërve të mëdhenj të artit e të kulturës shqiptare kaluan kufirin për tu shitur për një televizor...

Nuk i the asnjë fjalë publike kryeministrit tënd, doktor i shkencave, për të mbrojtur vlerat monumentale të kultit që as regjimi komunist nuk i preku.

Nuk e pe as "96-tën kur u përgjak sheshi "Skënderbej", as kur piramidat lulëzuan në bekimin edhe të votës tënde, as "97-tën"kur në "shtetrrethim" ngrite dorën lart e votove për komandantin tënd fizik e shpirtërorpresident.

Nuk fole një fjalë kur u shkatërrua mbrojtja e vendit, kur shpërthyen depot e u rrëmbyen armët, djersë dhe gjak i tërë popullit.

Nuk e pe as se si u shkatërrua ikona e futbollit shqiptar, Stadiumi Kombëtar "Qemal Stafa". Nuk e nxore nga gurmazi zërin në mbrojtje të tij...

Heshte, heshte, heshte....

Rriteshe si mec...

Gojë mbyllur, memec...

Tash të shoh ekraneve të vegjël satelitorë gojëhapur...

Kërkon me të gjitha mjetet e mënyrat (deri me vënie gjoksi para buldozëve e greve urie) që Teatri Kombëtar, apo Teatri Popullor siç e ke njohur dhe jetuar, të mos shembet.

Edhe unë jam dakord që të mos shembet. Kam qenë dakord me shkrim e fotografim që asgjë nga ato që u ndërtuan me djersën e gjakun e popullit të mos shembeshin, mos shkatërroheshin.

Fatkeqësisht ata që asokohe ngritën zërin që Shqipëria mos shkatërrohej u dhunuan, u burgosën, u syrgjynosën...

Midis tyre edhe unë...

Më gjakosën, më kërcënuan me jetën, arritën deri atje sa të tentonin të më rrëmbenin evlatët me armën "O mbyll gojën, ose të rrëmbejmë fëmijët". Ika syrgjyn gjallë e syrgjyn vdekur...

Syrgjyn jam tash 22 vjet, e me sa duket i tillë do të jem derisa të iki nga kjo botë. Syrgjyn, sepse në mjekrën tënde të aktorit tash mijtë e politikës kanë bërë jo thjesht fole por qarkullojnë nëpër të me makina luksoze drejt vilash që si ka bota... Në trevën ku u rrita ka një mesele....

"... Moti, në një krahinë kishte ra murtaja. Njeri lutej që mos të binte në katundin e vet. Kur ra iu lut Zotit ta mbante larg mëhallës. Kur edhe atje ra tha: "O Zot, larg familjes time"! E kur ajo nuk e kurseu as atë, atëherë tha "larg bythës sime". "Murtaja" 27 vjeçare shqiptare shkatërroi gjithçka me vlerë materiale e morale. Tash e ka radhën Teatri Kombëtar. Nuk fole atëherë kur "mortaja" kishte ra në tërë Shqipërinë. Tash është shumë vonë. Nuk ka më larg "bythës sime".

Është "kuota zero" që e votove ti.

Dhe jo vetëm ti.

Goja hapet për të folur në kuvend.

Pas kuvendit fjala s'ka vlerë...

*Mec dhe vëxhenjt – fëmijë, emër krahinor

Unë nuk kam turp nga puna

Nga **Samet ZAGRADI**

Emigracioni për pjesën më të madhe të të rinjve ka qenë dhe mbetet një nga zgjedhjet dhe zgjidhjet e shumë problemeve ekonomike. Vështirësitë e mëdha ekonomike kanë bërë që të rinjtë të vërshojnë drejt shteteve europiane akoma pa mbaruar 9- vjeçaren, krejtësisht e ndaluar nga ana ligjore për të punuar apo për të kaluar të vetëm kufirin. Qindra të rinj që nga vitet e para të tranzicionit vërshuan ilegalisht duke lënë çdo gjë në vendin e tyre dhe duke parë jetën e tyre në një tjetër vend. Shumë prej tyre sot janë të suksesshëm, por ka edhe nga ata që nuk dihet se ku janë më... Por sot, jo të gjithë mendojnë që të largohen, madje ka të tjerë që kanë vendosur të kthehen në vendin e tyre, për të punuar e kontribuar pranë familjares.

Një prej tyre është 28 vjeçari Eljon Ramku, i lindur në fshatin Staravec të Njësisë Administrative Tomin. Tashmë i martuar, babai i dy vajzave, ka vendosur që të kthehet pranë familjes së tyre duke mos pasur "turp" nga puna në bujqësi. Eljoni iku nga Shqipëria pasi mbaroi arsimin 8 -vjeçar, duke luftuar varfërinë dhe papunësinë. Ai ishte vetëm 15 vjeç kur mori një vendim të madh në jetën e tij, duke lënë pas shokët, shkollën, familjen dhe çdo gjë që ai kishte deri në ato momente. Ai mori rrugën e vështirë të kurbetit dhe bashkë më të vëllanë, punuan dhe ndërtuan një jetë më të mirë për fëmijët e tyre. Prej vitesh ai e ndan jetën mes Greqisë dhe Shqipërisë, duke punuar punë të ndryshme dhe duke investuar ato të ardhura në vendin e tij të lindjes.

Puna sipas tij nuk është turp, mjafton që ato para që fiton i merr me djersë dhe punë të ndershme. Çdo ditë shikojmë të rinj nëpër kafene, xhiro nëpër bulevard dhe u vjen turp të punojnë me një rrogë të vogël apo në bujqësi.

"Unë ika nga Dibra i vogël. Situata ekonomike në familje nuk më lejoi të vazhdoj shkollën dhe u detyrova që të largohem në këmbë, ilegalisht drejt Greqisë", tregon Eljoni. Bujqësia dhe pemtaria janë fushat të cilën ai punon dhe merr fitimet.

"Sa më shumë kalonin vitet aq më shumë kupton që familja është gjëja më e shtrenjtë dhe e unë u detyrova që të kthehem në Shqipëri në kohën më të madhe. Traktori për mua është shoku i punës, sepse punoj më përkushtim dhe ndershmëri. Unë jam i kënaqur edhe me pak, siç themi ne dibranët, puna me djers kurrë nuk humbet ndërsa leku pa djersë nuk do ta gëzosh asnjëherë", tregon Eljoni.

"Edhe të rinjtë e sotëm duhet ta kërkojnë punën. Është mirë të shkollohen dhe të bëhen të zotët e vetes. Nuk ka si vendi jonë dhe këtë e dinë vetëm ato që si unë janë larguar në kurbet. Të rinjtë nuk duhet të kenë turp nga puna e ndershme, nuk duhet tu vijë zor në qoftë se lëron tokën, mbjell patate, qershi, merren me bujqësi apo punë të tjera. Dihet që këto që sapo përmenda nuk janë punë të lehta por u siguroj që jetohet edhe me këto punë. Dua tu them të gjithë të rinjve që të ndjekin modele të shëndetshme suksesi dhe të punojnë fort për ndërtimin e një rruge të sigurt për ta", thotë 28 vjeçari Eljon Ramku.

Si Eljoni po shohim gjithnjë e më pak të rinj që punojnë në punë të tilla. Tendenca për të qenë "të kohës" ose ndjekja e shembujve negative nga rrjetet sociale dhe media bën që rinia e sotme të ketë një tjetër këndvështrim për jetën.

Krijohet forumi "Të rinjtë e Dibrës"

Vetëm pak ditë më parë një grup të rinjsh dibranë hodhën idenë e krijimit dhe organizimit të një forumi të madh jo politik i të rinjëve dibranë për të lobuar, advokuar dhe të reaguar për të gjithë shqetësimet, kauzat apo problemet që të rinjtë e kësaj zone kanë.

Ideja e krijimit të të parit forum për gjithëpërfshirjen e të rinjve nga Dibra ishte prej kohësh, por vetëm pak ditë më parë u konkretizua dhe tashmë po vazhdon intensivisht punën e organizuar nga vetë të rinjtë për ta shtrirë si fillim idenë te të gjithë të rinjtë nga Burreli, Klosi, Bulqiza dhe Peshkopia.

Ky forum i quajtur "Forumi të Rinjtë e Dibrës" dhe aktualisht po punon në terren ku në çdo qytet ka përfaqësues që punojnë dhe përpiqen të çojnë te çdo i ri idenë e krijimit të këtij grupi. Shtrirja e grupit vazhdon të jetë në Universitet Shtetërore dhe private ku studiojnë të rinjtë nga Dibra. Vazhdimisht janë projektuar takime dhe lobime në qytete për të folur me të rinjtë që bëhen pjesë e këtij forumi.

Takimet e grupit bërthamë janë të shpeshta ku pritet shumë shpejt të organizohet një takim i madh me të gjithë të rinjtë e anëtarësuar, dhe jo vetëm, për të marrë nisma reale në komunitet. Një fushatë anëtarësimi po bëhet online edhe me formularë të shkruar, ku me të vërtetë ka pasur një interesim shumë të kënaqshëm nga të rinjtë.

Universitetet në Tiranë janë shprehur të gatshëm të bashkëpunojnë duke vënë në dispozicion salla takimesh pa asnjë kosto.

Mesazhe të shumtë vijnë çdo ditë në faqet elektronike të forumit ku shumë të rinj interesohen dhe japin ide e kontribut për vazhdimin me aktivitete të forumit. Në çdo qytet ka koordinatorët lokalë, ku po punohet për veprimtaritë dhe anëtarësimet e çdo të riu që ka dëshirë të jetë pjesë e kësaj lëvizje rinore.

Edison Balla, një nga ideatorët e parë të këtij forumi, thotë se "ishte një ide e kahershme që të mblidhte të gjithë të rinjtë e Dibrës bashkë. Dibra ka shumë të rinj që me zemër duan të jenë aty por situata dhe politikat e ndjekura gabim kanë bërë që ata të largohen me idenë për të punuar jashtë saj. Revolucioni gjithmonë ka ardhur nga të rinjtë dhe pikërisht ne duhet të ndihmojmë që diçka të ndryshojë për mirë në vendin tonë".

Në rrethin e Dibrës ka me dhjetëra kauza që duhet të ngrihet zëri, të sensibilizohet, të ndihmohet sadopak në zgjidhjen e tyre. Mjafton të kujtojmë statutit e minatorit, papunësinë, paragjykimet dhe dëmet që japin ato në shoqëri, tregjet e pasigurta apo mbetja e mallit stok të fermerëve janë kauza që na shqetësojnë çdo ditë.

Përse duhet të bashkohen të rinjtë dibranë rreth këtij forumi? Është një pyetje që çdokush mund ta bëjë. Forumi të rinjtë e Dibrës është një grupim të rinjsh, me potenciale dhe dëshirë të madhe. Është një grupim jopolitik dhe nuk financohet nga askush, çdo gjë është vullnetare dhe për çdo problem që shqetëson Dibrën do jenë gati të ngrenë zërin, deri sa ai problem të shkojë drejt zgjidhjes. Të rinjtë duhet të bëhen bashkë, sepse sa më shumë të rinj të reagojnë, aq më shumë sukses do të kemi. Efekti i këtij grupimi po ndihet akoma pa filluar mirë, duke parë se interesimi nga të rinjtë ka qene i madh. Ky grup do të jetë një zë i fortë për Dibrën.

"Forumi të Rinjtë e Dibrës", fton çdo të ri për të qenë pjesë, duke kontribuar me aq mundësi sa kanë. Dibra ka nevojë që të rinjtë e saj të kthehen duke ndërtuar atë ashtu siç prej vitesh janë munduar ta ndërtojnë paraardhësit tanë. Forumi do të jeni shumë shpejt pjesë e ndryshimit për mirë të Dibrës.

Gjeneral Vinçenco Murikio në librin e tij, krahas përshtypjeve të udhëtimeve nëpër Shqipëri, analizon situatën politike, gjendjen ekonomike, anarshinë shoqërore të asaj kohe,

Mehmet pashë Deralla *në kujtimet e një gjenerali*

Dr. Selman Meziu

Jeta e njeriut është si një përrua malor që zbret në kapërdredhjet e ngushta të shtratit formuar prej tij, përgjatë një relievi të përthyeshëm. Ndërsa e një patrioti të madh si Mehmet pashë Deralla, jeta i ngjan një lumi ujëshumë me shumë ujëvara, lakore, bërryle e shtrat gjerë, ku prurjet e tij lëvizin plotë kapriço.

Në librin e tij me kujtime gjeneral Vinçenco Murikio krahas përshtypjeve të udhëtimeve nëpër Shqipëri, analizon situatën politike, gjendjen ekonomike, anarshinë shoqërore të asaj kohe, hedh dritë mbi embrionin e krijimit të shtetit të ri shqiptar dhe takimet me disa patriotë të mëdhenj shqiptarë si Ismail Qemalin, Mehdi Frashërin, Luigj Gurakuqin, Prenk Bib-Dodën, Abdi bei Toptani, Fezi Alizoti etj.

Lexojmë se si shkruan ai për pashallarët e kohës së sundimi osman: "Nga viti 1905 – 1908 u thirra nga gjeneral Gjorgjis ku më ngarkoi me detyra në Vilajetin e Manastirit... Në këtë rast jam përpjekur të sillem e të ndihmoj mjaft pronarë shqiptarë myslimanë, të cilët kishin mjaft toka në pronësi... (V. Murikio Kujtime nga shqip. f.14, Napoli 1935)

Ai vlerëson te këto pashallarë shpirtin patriotik, për mëvetësinë e Shqipërisë. Dhe lexojmë: "Jo pak prej këtyre bejlerëve kishin ndjenja patriotike, te cilën e vlerësonin shumë... një autonomi të qëndrueshme, por me një të ardhme jo të shpejtë për Shqipërinë." (V. Murikio, 1935:14-15)

Duke vazhduar leximin e librit, i cili është i mbushur me ngjarje e fakte, zbulojmë mbi jetën e patriotit Deralla. "Në vitet 1912-1913 banoja në qytetin e Barit me detyrën e komandantit të një grupi artilerësh. Gjon Deragjati kishte dëgjuar mbi raportet e mia me shqiptarët, prandaj më afroi e më prezantoi me mjaft shqiptarë me banim të përkohshëm në qytetin e Barit, ose që po kalonin këndej. Më njohu përsëri me midir (mbarështues qeveritar i një krahine, qyteti. S.M.) beu me emrin Mehmet bej Deralla- Tetova. Ky me Ismail bej Qemalin kishin formuar në Vlorë Qeverinë e parë Shqiptare (12 nëntor 1912- këtu autori ka gabuar pra është 28 nëntor 1912 S.M).,, (po aty, f. 17)

Gjenerali duke patur një kujtesë të fuqishme, kthehet prapa me kujtimet e tija duke pasqyruar në detaje një takim tjetër me patriotin tetovar Deralla. Dhe lexojmë: "Midir Beu, pra Mehmet pash Deralla, gjendesh në Vlorë i izoluar nga babai i



tij, me Ismail Qemal beun, sepse bregdeti shqiptar ishte bllokuar nga pushtuesit grek, prandaj ai më kërkoi ndihmë financiare. Unë i dhashë atij kursimet e mia (3000 lira), i cili me premtoi se do të mi kthente sapo të largoheshin grekërit. Kur po kthehesha në Shqipëri dëshironte të më përshëndeste. Pashai i vjetër më përqafoi ngrohtësisht duke më falënderuar për ato që unë kisha bërë për familjen e tij. Ai më tha: ***"Kolonel, po qe se do të keni rastin, në të ardhmen, të shkelni në tokën shqiptare, kujto shtëpinë time se ajo do të jetë në shërbimin tuaj."*** **(*po aty,*** f. 15-16)

Përsëri jemi në fillimet e vitit 1914, dhe gjenerali takon përsëri pashain tetovar dhe ja çfarë shkruan: **"...megjithatë edhe në Durrës pata raste të takoi njerëz të shquar shqiptar, si të krishterë, si muslimanë-takohem me Mehmet pash Derallën nga Tetova (Kosova), Hasan bej Prishtinën, doktor Turtuli nga Korça, Murat bej Toptanin, Fuat bej Toptanin", (po aty f.28)**

Duke lexuar këto pjesë të shkurtëra të shkëputura nga kujtimet e gjeneralit italian, mik i ngusht i shqiptarëve, lind vetëvetiu pyetja: Vallë, çfarë kërkonin, me çfarë merreshin këto njerëz të shquar në qytetin e Durrësit dhe Tiranës? Sa për ta kuptuar po shkëputim një pjesëz,po aty f.28**: "Në këtë kohë disa bejelerë të Maqedonisë, ishin të pushtuar nga trupat armike serbe e nga grekërit, prandaj ato kishin ardhur në Tiranë dhe kishin formuar Klubi e tyre**."

Aq shumë ishte forcuar miqësia e patriotit tetovar me gjeneralin italian saqë: "*Mehmet pash Deralla më ftoi një mbrëmje për të ngrënë në Klubin e bejelerëve të Kosovës, ku ai ishte president. Me prezantoi me të gjithë miqtë e tij duke më konsideruar mik i sinqertë i çështjes shqiptare.*"(po aty. f. 28-29)

Erdhi momenti të trajtojmë një çështje mjaft delikate, e vështirë të jepen përfundime të sakta, por që mjerisht vazhdon akoma te shqiptarët e Maqedonisë, në Kosovë, Mitrovicë e Mal të Zi etj. Një plagë e cila kullon ende gjak, shkombëtarizimi, e ne shqiptarët nuk jemi të organizuar, të unifikuar, për ta ndaluar përfundimisht. Dukuri e cila edhe në trungun e kombësisë shqiptare që është Shqipëria pas viteve 1990, ka hyrë si një epidemi shkatërruese, duke sjellë në një mënyrë ose në një tjetër shkombëtarizim, ligësim politik, ekonomik dhe zbehjen e çështjes kombëtare, "dhuratë" e politkanëve shqiptarë përgjatë një çerek shekulli.

Autori i këtij libërthi të vogël në volum, por me një analizë të thellë të fakteve, ngjarjeve na dërgon qetësisht në një problem plagëshumtë: "Mehmet pash Deralla, një ditë prej ditësh më propozon që ti bëja një kërkese për të shitur gjithë pronat e tija në pjesën e sipërme të Vardarit (Tetova), kapitalistëve italianë. Un iu shkruajta menjëherë Ministrisë përkatëse në Romë ku erdhi përgjigja që mund të filloja bisedimet."(po aty, f. 29)

Dhe më tej, autori e përgjithëson këtë veprim duke e shtrirë më gjerë. "**Mjaftë**

Autori i këtij libërthi të vogël në volum, por me një analizë të thellë të fakteve, ngjarjeve na dërgon qetësisht në një problem plagëshumtë: "Mehmet pash Deralla, një ditë prej ditësh më propozon që ti bëja një kërkese për të shitur gjithë pronat e tija në pjesën e sipërme të Vardarit (Tetova), kapitalistëve italianë. Un iu shkruajta menjëherë Ministrisë përkatëse në Romë ku erdhi përgjigja që mund të filloja bisedimet.

bejelerë të tjerë, në krahinat e pushtuara nga serbët dhe grekërit në Luftën e DytëBallkanike, vinin tek unë dhe më propozonin të njëjtën kërkesë që më bëri më parë Mehmet pasha." (po aty f. 29)

Por, arsyet e largimit nga vendlindja, mëmëdheu i tyre jo vetëm i të pasurve, por edhe i fshatarësisë e qytetarëve të varfër, ka shpjegime e arsye më të thella, më të dhimbshme, më njerëzore, më konkrete, më jetësore. Edhe për këtë rast po i drejtohemi librit të gjeneral Vinçencos: "Vizitojm dy Dibrat dhe Lumën (Mars 1913, S.M), ku mund të evidentojm që ushtria serbe ishte tërhequr matanë kufirit, duke masakruar gjithçka. Azgjë më shumë se barbarët duke mos kursyer pasuritë modeste për jetesë, as gratë, as fëmijët që pinin qumësht nga nënat, të cilët i hidhni në zjarr për ti zhdukur. Të mëdhenjt, të cilët nuk kishin ikur të fshiheshin në pyje e që fatkeqësisht kishin rënë në duar të tyre, i kanë masakruar të gjithë. Në një fshat të Dibrës së poshtme të gjithë meshkujt janë gjetur të therur". (po aty, f. 18)

Kapitalet e huaja ishin të interesuara që të hynin në Shqipëri edhe pse gjendja politike ishin mjaft e acaruar dhe shqiptarët ekonomikìsht ishin kockë e lëkurë. Dhe ja si e trajton koloneli italian: "**Një ditë paraqitet tek unë një inxhinier francez, emri i të cilit nuk më kujtohet, i cili më kërkoi që unë të hyja në bisedë për shitje tokash, për llogari të kapitalistëve francezë, bie fjala për këto toka në Maqedoni, pronarë një shqiptar. Unë u përgjigja i qetë dhe me kulturë inxhinierit francez, se po të dëshironi kontaktoni direkt me këto bejlerë". (po** aty. f. 30)

Në këto situata teje e të vështira për Shqipërinë jetoi e punoi në mes shqiptareve gjeneral Viçenco, duke kryer veprimin tjetër më njerëzor se kurrë, më të kulturuar sa s'ka ma, pasqyruar në ketë libër, këtë odise udhëtimi e qëndrimi duke e mbyllur kështu: "**Sukseset e dy popujve të cilët jetojnë përballë njëri-tjetrit me ndarjen ujore,Detin Adriatik e Jon, për të jetuar si gjithmonë në vëllazërim, duke iu rekomanduar shqiptarëve që të njihen sa më mirë nga italianët, të cilët gjithmonë kanë dëshiruar e dëshirojnë si në një kohë,zhvillimin e pandërprerë moral e material". (po aty f.** 55).

Gjithashtu, përshkruan takimet, bisedat, marrëdhëniet me mjaft njerëz të shquar që punonin për krijimin e shtetit shqiptar, forcimin ekonomik, stabilitetin politik të Shqipërisë, por edhe problemet social ekonomike të secilit prej tyre.

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Gjurmë lashtësie në Çidhën

Nga **Ali HOXHA**



Çidhna, kjo njësi territoriale dhe etno-kulturore, gjeografikisht shtrihet në Dibër të Poshtme, në luginën e Drinit të ZI, në veri dhe veriperëndim të qytetit të Peshkopisë. Si territor përfshin një hapësirë relativisht të gjerë që fillon që nga Zhuri i Pllajut në kufi me Matin dhe maja e Runjës së Lurës, duke përfshirë këtu edhe bjeshkët e Pllajut e të Xharxhishtit, që shtrihen në anën perëndimore të Drinit të Zi dhe arrin deri në rrëzë të Korabit, përfshirë këtu edhe bjeshkën e Gramës, në anën lindore të Drinit. Çidhna si krahinë nga veriu kufizohet me krahinën e Dardhës; nga veri-lindja kufizohet me Ujë e m' ujen (Shumbetin, Slloven etj); nga lindja kufizohet me malin e Korabit; nga jug-lindja kufizohet me Katundet e Epra(Limjan, Sohodoll etj); nga jugu kufizohet me përroin e Gjelagjoshtit e katundet Vakuf e Kishavec në anën lindore të Drinit dhe me krahinën e Muhurrit; nga perëndimi kufizohet me krahinën e Matit me të cilët i ndan Bjeshka e Pllajut; dhe nga veri-perëndimi kufizohet me Lurën, të cilët i ndan bjeshka e Xharxhishtit.

Aktualisht Çidhna si krahinë, përbëhet prej 18 katundesh: Çidhna e Poshtme, Grykë-Nokë, Sinë e Epër, Sinë e Poshtme, Arras, Kodër-Leshej, Mustafaj në anën perëndimore të Drinit; Kurse në anën lindore të Drinit të Zi shtrihen fshatrat: Fushë-Çidhën ose Fushë-Alie, Laçes, Blliçe e Epër, Blliçe e Poshtme, Rrenzë, Kukej, Kastriot, Brest i Epër, Brest i Poshtëm, Kandërr dhe Fushë-Kastriot (nënkupto këtu vetëm Krekasit (ose Përgjegjej) duke mos llogaritur këtu sektorin e NB-së, i cili është populluar edhe me banorë të ardhur nga krahina të tjera.

Qysh në fillim duhet theksuar se ashtu si vetë krahina e Çidhnës, edhe banorët e saj të sotëm janë shumë të vjetër në këtë trevë. Ata, si ngulim, arrijnë deri në thellësi të shekujve. Në dokumentin shtetëror osman të shek.XV, Defteri emëror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467,[1] përmenden këto katunde të Çidhnës së bashku me banorët (kryefamiljarët) e tyre: Çidhna e Epër me 16 shtëpi, Çidhna e Poshtme me 8 shtëpi, Sina e Epër me 3 shtëpi, Sina e Poshtme me 3 shtëpi; Gardhi i Poshtëm me 9 shtëpi; Shashari me 2 shtëpi; Guri me 4 shtëpi, Bresti i Epër me 2 shtëpi dhe Brest i Poshtëm me 5 shtëpi. Në atë dokument përmenden edhe fshatrat Ariza (Arëza) (sot Arras,-A.H) me 5 shtëpi, Bulkije 6 shtëpi, Shilbatër (Salbatër-A.H) me 6 shtëpi, për të cilat unë kam hedhur mendimin[2] se ata mund t'i identifikojmë me katundet e sotme të krahinës së Çidhnës, respektivisht me Arizan me Arrasin, Bulkijen me Blliçen e Poshtme (e cila thirret dhe Bulç, në kuptimin bujq) dhe Shilbatrën me Salbatrën, d.m.th. Sulejt, siç quhet sot një nga lagjet e fshatit Fushë-Çidhën[3]. Siç shihet, koha ka bërë të vetën, Çidhna e Epër sot nuk ekziston as si katund dhe as si mikrotoponim. Mbështetur në të dhënat e dokumentit të lartpërmendur, si dhe në toponomastikën dhe onomastikën e sotme siç e kam trajtuar edhe në një studim të mëparshëm[4], kam pas arritur në përfundimin se në mos u përputhtë plotësisht me fshatin e sotëm Grykë-Nokë, Çidhna e Epër, duhet të ketë qënë shtrirë në nëj territor të tillë që nga Gjurra e Nokës dhe lagjja Pashnjar e deri në Livadh të Arrase, në Prat. Por duke u thelluar në mikrotoponimin e "Çidhnës së Poshtme të sotme, (**një parantezë**: ky toponim e ka ruajtur edhe sot atributin "Çidhën e Poshtme", edhe pse aktualisht nuk ekziston antonimi "Çidhna e Epër" e vitit 1467. Banorët vendas kanë vazhduar ta quajnë gjithmonë kështu "Çidhna e Poshtër" për ta diferencuar e dalluar atë nga termi "Çidhën" në kuptimin e gjithë krahinës) kam evoluar, e tërheq mendimin e parë, sepse më afër së vërtetës është mundësia që Çidhna e Epër e përmendur në Defterin kadastral osman të vitit 1467, të mund të identifikohet me skajin veriperëndimor të rrafshës së Çidhnës së Poshtme të sotme, më sakt, me lagjen veriperëndimore të saj, e cila nga banorët vendas të Çidhnës quhet "Katuni i Epër", sepse ajo është në një pozitë gjeografike, në një terren pak më të lartë se pjesa tjetër jug-lindore e rrafshes së Çidhnës, e cila nga banorët vendas, nga Çidhnakët quhet "Katuni i Poshtër", sepse kjo lagje është në një pozitë gjeografike pak më të ulët se pjesa tjetër veri-perëndimore, siç përmendet "Katuni i Epër". Pra, përfundimisht "Çidhna e Epër", e përmendur në "Defterin emnor të Vilajetit të Dibrës të vitit 1467", duhet të identifikohet me "Katunin e Epër" me lagjen veriperëndimore të Çidhnës së sotme, kurse "Çidhna e Poshtër" e përmendur në Defterin emnor të vitit 1467, duhet të identifikohet me lagjen "Katuni i Poshtër" i Çidhnës së sotme. Ajo që na shtyn të ngulim këmbë për këtë tezë, na ndihmon edhe fakti se katundi Çidhën ka edhe pesë lagje të tjera: "Breth", "Bokas", "Maj të Epër" dhe "Maj të Poshtër" dhe "Resëm", të cilat edhe pse me një distancë të largët nga qendra e fshatit, ato quhen lagje dhe jo katund, ashtu si dy lagjet e përmendura më sipër: "Katuni Epër" dhe "Katun i Poshtër".

Së dyti, nisur dhe nga fakti se të gjithë fiset e "Katunit të Epër: Basha, Cani, Tola, Xheçi e Cerri, të cilët pjesërisht shtrihen edhe në lagjet "Breth" e "Bokas", thirren edhe me një emër të përbashkët më të hershëm: "Bisë", kurse fiset e Katunit të Poshtëm: Krrash, Tërshallë, Daci, Kolë, Përgjegji e Sala njihen me emrin e përbashkët "Dujs", të cilët përbëjnë një vëllazëri më vete, ky fakt na jep një argument tjetër më shumë se këto dy lagje në kohë të hershme kanë qenë fshatra më vetë, të pavarur nga njëri-tjetri.

Që "Katuni i Epër" i Çidhnës së Poshtme të sotme duhet identifikuar me Çidhnën e Epër mesjetare të vitit 1467 dhe "Katuni i Poshtër"(Poshtëm) i Çidhnës së sotme është "Çidhna e Poshtër" mesjetare e vitit 1467, të cilët kanë qenë katunde më vete, të pavarura, këtë mendim e mbështesim edhe në këto argumente të tjera shtesë: Të gjithë fiset e Katunit të Epër: Basha, Cani, Tola, Xheçi Hoxha (Kuta) dhe Cerri, të shtrirë edhe në lagjet Breth e Bokas, të Çidhnës, si edhe me fiset Margjoni, Kuta, Spata e Manërkolli, të shpërndarë në fshatrat në anën tjetër, lindore të Drinit: në Laçes, Blliçe, Rrenz, Fushë Çidhën (Fushalie) dhe Kandërr, përbëjnë një etni qysh prej asaj kohe (të Tolë Gjoneshit) që përmendet në Çidhnën e Epër të vitit 1467, sa që as sot nuk bëjnë krushqi, jo vetëm ndërmjet tyre, por as edhe me nipërit e mbesat e fiseve përkatëse (nga ana e vajzave të martuara në fise të tjera). Ndërsa në të kundërtën e asaj që përmendëm më sipër, fakti se fiset e "Katunit të Epërm" të Çidhnës: Basha, Cani, Tola kanë lidhje krushqie me fiset e "Katunit të Poshtër" të Çidhnës, respektivisht: fiset Daci, Krrashi, Tërshalla etj, përbën një argument tjetër më shumë që na bind se Çidhna e Epër e vitit 1467 duhet identifikuar me lagjen "Katuni i Epër" të Çidhnës së Poshtër të Sotme.

Katundi "Shashari" i vitit 1467 sot haset si lagje e fshatit "Kodër-leshej", më saktë "Zall-Leshej" kurse "Gardhi i Poshtëm" haset si lagje e fshatit Sinë e Poshtme, ndonëse është për t'u theksuar se toponime me emrin "Zhgjerth" kemi sot edhe në Sinë të Epërme edhe në Çidhën të Poshtme. Siç dihet, fjala zhgjerdh, shumësi i fjalës gardh, e cila ka lidhje me fjalën sllave "grad" që në shqip do të thotë "qytet", dhe që një toponim i tillë i sotëm me emrin "qytet", siç kemi në Çidhën "Kepi i Xhitetit" (qytetit) pranë të cilit dëshmohet "Kalaja e Çidhnës", buzë Setës, pikërisht në kodrën në të cilën është shtëpia e Mersim Zenel Krrashit, ngjitur me Kepin e Xhitetit, në anën e majtë të lumit të Setës, aty ku sot është ura automobilistike mbi lumin e Setës, përbën argument bindës se fshati "Gardhi i Poshtëm" që përmendet në testamentin e Gjon Muzakës si njëri nga fshatrat (Sina dhe Gardhi i Poshtëm) që kanë qenë prona e parë e Pal Kastriotit, gjyshit të Skënderbeut, duhet të ketë qënë këtu, pranë Kepit të Xhitetit, më saktë, fshati Çidhën e Poshtme. Ndërsa fshatrat e sotëm Mustafej, Kodër-Leshej, Laçes, Fushë-Çidhën (Fushë-aliej), Rrenzë, Kukej dhe Kastriot nuk përmenden në atë dokument, prandaj nxjerrim konkluzionin se ato mund të jenë krijuar më vonë, pas asaj periudhe. Ndaj hedhim mendimin se fshati Kastriot duhet te jetë quajtur kështu në kujtim të fisit më të përmendur të asaj kohe, Kastriotëve, veçanërisht për nder të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, si bir i kësaj treve.

Siç dihet, banorët e sotëm të trevës së Çidhnës, ashtu si të mbarë Dibrës, për arsye të njohura historike kanë emra të besimit islam, por vazhdimësia më e hershme e besimit të mëparshëm të tyre ruhet në mbiemrat (Llagapët) e tyre, të cilët janë ruajtur nga emrat e vjetër të burimit shqiptar, si: Tola, Kola, Marku, Loka, Laçi, Kariçi, Noka, Bushi, Manërkolli, Margjoni, Kuta, Spata, Zhuka etj. Kështu nga Tolë Gjoneshi i vitit 1467 kemi sot fiset Tola, Basha, Cerri, Kuta, Hoxha, Margjoni, Manërkolli e Spata, ndonëse të përhapur në Çidhën të Poshtme, Fushë-Çidhën (Fushëalie), Laçes, Rrenzë, Blliçe dhe Kandërr. Nga Gjergj Karriçi dhe Leka Laçi të vitit 1467 në Çidhën të Epër kemi sot fiset Kariçi e Laç në Grykë-Nokë, si dhe të gjithë ato fise të tjera që janë të një gjaku me ta; nga Kolë Prifti i vitit 1467në Sinë të Poshtme, kemi sot fiset Prifti, Tafa, Kovaçi (ky i fundit në Sinë të Epërme dhe në Laçes).

Në studimet tona të mëparshme "Një vështrim gjuhësor mbi toponimet e fshatit Çidhën e Poshtme"[5] dhe "Vështrim historiko-gjuhësor mbi toponimet e trevës së Dibrës"[6] (këtë të fundit në bashkëpunim me Myfit Trepçën) ku kemi shqyrtuar nga pikëpamja historike dhe gjuhësore disa nga toponimet e trevës së Dibrës, kemi trajtuar lidhjet e vazhdimësisë ndërmejt toponimeve të sotme dhe toponimeve ilire, të dokumentuara ose jo tek autorët antikë, por që duke i ananlizuar gjuhësisht, të çojnë këtu. Kështu, ndër të tjera kemi arritur në përfundimin se krahas toponimeve **Dibër** e **Titajrë** edhe makrotoponimi **Çidhën** dhe **kalaja** e saj: **"Kidhina"** në Defterin turk të vitit 1467; **"Kudine"** tek Barleti dhe **"Chidne"** (Didna) te Biemmi; **"Chidna"** te S.Gasperi që të kujtojnë kalanë "K i v i v a s" (kithinas), të ndërtuar prej Justinianit, **lidhen drejpërdrejt me ilirishten** dhe në të njëjtën kohë **tregon vazhdimësinë etno-kulturore ilire të banorëve të kësaj treve.**

Emrin e fshatit "Arras", që në Defterin turk të vitit 1467 del me formën "Ariza" (Arëza)[7], në veprën "De Aedificiis" të Prokopit të Cezaresë, shkruajtur rreth vitit 558 të erës sonë, e hasim në formën "Arsa" (Apoa)[8]- emër kështjelle për krahinën e Dardanisë. Gjuhëtarja Eljana Paço mendon se emri **Arsa** i Prokopit të Cezarese ruhet edhe sot si emër vendi dhe ajo e gjen atë të ruajtur në dy forma, Arsa dhe Arra, në të cilat ruhet a-ja nistore e theksuar, emër vendi në rrethin e Dukagjinit, në të djathtë të lumit Drin.[9] Kurse ne e gjejme atë të ruajtur edhe te fshati **Arras** i Çidhnës, i cili në bazë të ligjeve fonetike të shqipes shpjegohet plotësisht me fenomenin e metatezës, përveç faktit se pranë tij kemi edhe kalanë shumë të vjetër të Çidhnës (pikërisht në vendin ku sot ka shtëpinë Mersim Zenel Krrashi). Duke u rikthyer tek emri nga kuptimi "Arras" theksojmë se ai lidhet me fjalën "arrë-a" dhe është mjfat i përhapur në Shqipri, si "Arra", "Arrë-Mollë", "Fushë-Arrëz" etj. A.Majer (Die Sprache der Alten Illyrier, fq.61) emrin Arsa të Prokopit e lidh me emrin e fshatit Ras[10], gjasim ky që është më pak i mundshëm.

Të kësaj natyre, që ngrenë peshë në lidhjet e përbashkëta iliro-shqiptare janë edhe forma të lashta emërtimesh që sot ekzistojnë si mikrotoponime, kurse si apelativa paraqiten në forma të reja në përputhje me ligjet fonetike të Shqipes. E kemi fjalën këtu për emërtime të tilla të nomenklaturës gjeografike si shkrep, kep, krep dhe grep, në kuptimin "shkëmb"[11]. Të tilla mikrotoponime, në përbërje të të cilave kanë fjalën **grep** kemi mjaft, si: Grepi në Sinjë të Poshtme; Grepi i Shkallmagjës, Grepi i Rrilës, Dardha-Grepas në Çidhën të Poshtmel Grepi i Lapve në Grykë-Nokë, Grepi i Çene (i qenve) ne Pllaj etj.

Edhe toponimet me origjine latine, si dhe ato që u krijuan më vonë në truallin e shqipes nga apelativa latinë, siç paraqiten në gjendjen e sotme, si: Shetrrej, Kepi i Xhitetit, Fusha e Xhitetit, në Çidhën të Poshtme; Shëmërtaj në Grykë-Nokë, dhe Kodra e Shënediellit në Rrenzë dëshmojnë se edhe gjatë mesjetës kanë ardhur po nëpërmjet gojës së shqiptarëve.[12] Një argument i qenësishëm në këtë drejtim është vazhdimësia po nëpërmjet gojës së shqiptarëve, bile deri në ditët tona, i elementëve toponimikë me prejardhje nga terminologjia e krishtërimit katolik, të përhapura shumë kohë më përpara se ardhja e sllavëve në këto vise. Të tilla janë si: Domark nga Dom Mark në Çidhën të Poshtme; Shëmërtaj (nga Shën Martin) në Grykë-Nokë; Kodra e Shënediellit në Rrenzë etj, pa llogaritur këtu toponimin "kishë" që është shumë i dendur në këtë krahinë. Të gjitha këto sa thamë më lart tregojnë se banorët e sotëm të Çidhnës janë autoktonë, se të parët tanë kanë qenë gjithnjë të pranishëm në këtë trevë, gjë që dëshmon për vazhdimësinë e tyre të drejtpërdrejt nga stërgjyshërit tanë të hershëm, ilirët. Në këtë aspekt theksojmë faktin se në Çidhën kemi pas një qytet, gjë që dëshmëohet nga dy toponimet: Kepi i Xhitetit dhe Fusha e Xhitetit, si dhe Kalaja e Çidhnës, një kala e vjetër ilire kjo, rrëzë së cilës shtrihet lumi Seta, në një terren të ngjashëm për nga konfiguracioni, identik me simotrën e saj, kalanë ilire, 2500 vjeçare të Beratit, me një konfiguracion gjeografik të përngjashëm, identik: të dyja në anën jugore të kodrave përkatëse, të mbrojtura nga erërat e veriut dhe që të dyja buzë lumenjve me ujë të pijshëm, respektivisht të SETËS dhe OSUMIT. Në mbështetje të mendimit tonë se këtu pranë "Kepit të Xhitetit" ka qenë Kalaja Ilire e Çidhnës, si argument po bashkëngjes këtu një foto të "murit ilir" të kësaj kalaje, të fotografuar në vitit 1960 nga fotografi Refik Veseli, ish-punonjës i Institutit të Monumenteve të Kulturës, i cili poshtë saj kishte shënuar këtë diçiturë:

"Kala ilire përballë Fushë-Alies".

(vijon në numrin e ardhshëm)

1 Defteri emëror i vilajetit të Dibrës, Muaji Shaban, viti 571 hixhri (mars 1467) fq.62 etj.
2 Dibra dhe Dibranët, Tiranë 1981, fq.67-69.
3 Në kohën kur është hartuar kjo kumtesë, Fushë-Alies i qe ndërruar emri në Fushë-Çidhën, kurse pas viteve 1990 iu rikthye përsëri Fushë-Alie.
4 A.Hoxha-1)Defteri emnor i Dibrës i vitit 1467, vepër e cituar po aty; 2)"Një vështrim gjuhësor mbi toponimet e fshatit Çidhën e Poshtme, mbajtur në sesionin vjetor të Sektorit të gramatikës dhe të dialektologjisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave, Tiranë, në nëntor 1982
5 Po aty
6 M.Trepça-A.Hoxha, "Vështrim historiko-gjuhësor mbi toponimet e trevës së Dibrës", në Studime Filologjike Nr.3, fq.173, viti 1982
7 Defteri emëror i vilajetit të Dibrës, mars 1467, fq.62
8 Cituar sipas E.Paço, "Rreth disa toponimeve të trevave shqiptare që dalin në veprën "De Aedificiis" të Prokopit të Cezares" në Studime Filologjike, nr.3, 1982, fq.145.
9 E.Paço, po aty, fq.145
10 Cituar sipas E.Paços, po aty, fq.145
11 M.Trepçe-A.Hoxha, vepër e cituar, fq.173
12 Po aty, fq.174

Shkëputur nga libri:
"Filozofia popullore"

Odat ku prodhohej **filozofia** popullore

Nga **Xhafer MARTINI**

Nëse streha e filozofisë së antikitetit kanë qenë shkollat filozofike, nëse streha e filozofisë së sotme moderne janë universitetet, streha e filozofisë popullore kanë qenë odat dhe kuvendet. Në odat është holluarmendja, në oda është thelluarmendimi, në oda filozofët popullorë angazhoheshin në sipërmarrjen e përbashkët për ta çuar jetën përpara me anë të diturisë. Odat kanë qenë parlamente të vërteta popullore. Madhësia e tyre ka qenë e ndryshme, por preferoheshin odat e mëdha, që merrnin shumë burra, që ishin të hapura natë e ditë, jo vetëm për miqtë e dashamirët, por edhe për rrugëtarët e shtegtarët, për çdo njeri që kalonte andej. Kuptohet se sa e larmishme ishte pjesëmarrja e natëpërnatshme e burrave që hanin, pinin, dhe shkëmbenin mendime për çdo problem të jetës. Për të krijuar një ide rreth këtyre odave po japim vetëm njërën që e ka përshkruar misionarja angleze Margaret Hasluck:

"*Odë me përmasa të jashtëzakonshme kishte Cen Elezi në Sllovë. Aty mund të flinin njëqind burra secili me dyshek e me jorganin e vet. Përmasat e saj të sakta nuk i dimë, por kjo merret me mend nga miqtë e shumtë që mund të rregulloheshin në nji natë. Oda ishte jo vetëm shumë e madhe, por edhe shumë moderne për atë kohë e për kohën tonë. Ajo kishte nji oxhak të stërmadh, rreth të cilit ishin shtruar shilte, lëkura, sixhade, për një ndenje të rehatshme, këmbëkryq, si qëmoti, tue e pa zarmin me sy. Në zjarm vihej nji kërcunë e madhe që vetëm ai oxhak e merrte. Oda, veç tek oxhaku, kishte ene kande të tjera, sipas shijeve e qëllimeve të tjera. Kishte nji kand me kolltuqe moderne, nji tjetër me divanë të gjanë, ku mund të rrinin rreth nji tryeze njizet burra lirshëm. Në mes të odës ishte nji tryezë jashtëzakonisht e madhe, e rrumbullakët, rrethue me kolltuqe, ku mund të uleshin tridhjetë – dyzet burra. Oda kishte tetë dritare të mëdhaja, që, për nga gjatësia, shkonin deri afër tavanit, që ishte pesë-gjashtë metra i naltë. Kjo odë ishte në katin e dytë. Edhe pse kishte shumë dritare e të mëdhaja, ishte ndërtue në atë mënyrë që askush nuk mund të shikonte nga jashtë në odë, në çfarëdo kodre e maje ku mund të ngjitej. Kësisoj oda ishte e mbrojtur nga çdo sulm eventual që mund t'i bahej nga larg. Çdo natë në këtë odë darkoheshin dhe flinin njiqind udhëtarë, secili në të ague vijonte rrugën e vet. Kishte nji kuzhinier, i cili kishte një dhomë gatimi më vete, ku therte çdo natë nga dy desh ose nji ka dhe përgatiste të njejtën menu: supë, mish të zier dhe pilaf orizi. Gratë kishin kuzhinën e tyne, ku gatuanin për vete dhe për fëmijët në rast se shefi i kuzhinës nuk u linte gja për të ngranë".* [1] Si kjo odë nuk kishte as paria, edhe ata më të pasurit, por, sidoqoftë, oda të mëdha dhe më pak moderne kishin shumë prej tyre. Njerëzit e thjeshtë të popullit kishin oda të veçanta për burra, por, natyrisht, shumë modeste. Shumica dërrmuese e popullit ishte shumë e varfër. Kjo shumicë e priste mikun në vatrën e zjarrit, në odën e vetme ku gatuanin e hanin, ku rrinin edhe gratë e fëmijët; edhe në ato kushte, në vatrën e zjarrit, thuheshin shumë fjalë të mençura që e pasuronin fondin e artë të filozofisë popullore. Prandaj filozofia popullore nuk mund të kuptohet edhe pa kontributin e vatrave shqiptare.

Në odat e popullit ajo që të mahniste ishte mënyra se si bisedohej. Fjala merrej me radhë, edhe pse askush nuk mbante radhë. Bisedohej me qetësi dhe urtësi, duke e peshuar çdo fjalë, mos vriste dikë pa dashje, kurse me dashje dhe me qëllim ajo punë nuk bëhej kurrë. Kur shikon sot se si kacafyten në emisione televizive "analistë dhe politikanë" për t'u treguar "të zgjuar", si përleshen në parlament i cili jo vetëm nuk është tempull i mençurisë, por është kulmi i marrëzisë, të vjen të thërrasësh: ku jeni o kohët e shkuara, kur në Shqipëri kishte vërtet burra!

Po le të merremi me ata burra. Në popull kishte disa filozofë të vërtetë, megjithëse pa shkollë. Ata kishin një etikë dhe kulturë të madhe në mënyrën e sjelljes dhe të bisedës. Shumë herë shtronin ndonjë pyetje për gjithë mexhelisin. Problemi rrihej nga të gjitha anët dhe arrihej në një përfundim të caktuar. Nëse problemi kishte rëndësi të përgjithshme, më vonë do të bëhej normë zbatimi i tij.

Zakonisht në mexhelise vepronin si "një pendë qe", dy mendimtarë popullorë që hapnin bisedën duke e orientuar atë sipas tematikës. Kultura e tyre e shprehjes ishte e madhe, alegoria dhe simbolet që përdornin ishin me vend, gjë që e bënte bisedën të këndshme për secilin dëgjues. Ja se si na vjen mënyra e përcaktimit të tematikës dhe të problematikës së një mexhelisi duke pasur parasysh këtu edhe interesin e pjesëmarrësve në atë mexhelis:

"Atë natë Vesves Huta dhe Murat Buta, dy bartës të shkëlqyer të filozofisë së popullit dhe të alegorisë së tij, ishin miq në shtëpinë e Ali Kucbashit, në odën e tij të madhe mbushur me burra. Murati, si më i vjetër që ishte, kishte zënë kryet e vendit, kurse përkarshi tij, pothuaj përballë, ishte ulur Vesves Huta.

- Or Vesves Huta, a i hipim kaikes, a rrimë në tokë?- e pyeti Murat Buta.

- Ma mirë rrimë në tokë, o Murat, se si toka nuk ka. Detit nuk i dihet."

Burrat e tjerë nuk e kishin të vështirë për ta kuptuar që Murat Buta pyeti Vesves Hutën nëse do të flisnin për ngjarje ndërkombëtare, duke kapërcyer detin, apo për hallet e popullit në Shqipëri. Pra, siç shikohet, përcaktohet më parë tematika e bisedës, por kjo gjë nuk bëhet në mënyrë shkollareske dhe vulgare. Pastaj ata të dy do ta udhëqinin bisedën jo duke vënë norma dhe kufinj, por duke e alternuar atë sipas përbërjes së mexhelist, madje duke ndarë edhe rolet mes veti:

- O Murat, a të kapësh lopatën apo kazmën? – e pyet shokun Vesves Huta.

- Jo, jo, o Vesves Huta, më mirë gërmo ti dhe unë po qes, se jam burrë i vjetër e kazma më lodh. Janë vegla vorri, të dyja të rënda, por si ma e lehtë asht lopata.

- Jo, vallahi, gërmojmë bashkë dhe qesim dheun bashkë, - se ene mua më ka lanë takati krejt.

- E po mirë, si të duesh ti po e bajmë".

Dy filozofët popullorë, siç mund të kuptohet, morën përsipër ta drejtonin të dy bisedën, duke aktivizuar krejt mexhelisin e burrave. [2]

Me shprehjen "përtej detit", kuptohej se në mexhelise trajtoheshin edhe çështje ndërkombëtare, bëhej politikë e jashtme kombëtare, me kthjelltësi dhe largpamësi, gjithnjë në përputhje me interesin kombëtar. Për këso tematikash zakonisht ishin kuvendet e burrave ku jo vetëm shqyrtoheshin probleme me rëndësi, por merreshin edhe vendime për zbatimin e tyre:


" Në Kuvendine Nandë Maleve të Dibrës që u mblodh tek Ferra e Pashës në Dibër të Poshtme, foli patrioti Selman Alia e tha:

- Kam marrë vesh se mbas turkut vendi ynë ka me u shkelë nga serbi, prandaj të mendojmë si me ja ba.

- Unë mendoj se duhet me u lidh me inglizin se "asht i madh e na mba, asht i pasun e nuk na ha",- tha atdhetari Isuf Karahasani.

- Ke inglizi duhet me shpresue, por ene të kapim pushkët me luftue,- tha Ahmet Kaloshi i Vjetër". [3]

Duke përjashtuar ndonjë odë si ajo e Cen Elezit, në përgjithësi odat e popullit, edhe kur ishin veç për burrat, ishin të thjeshta, me dysheme prej dheu, mbuluar me hasra dhe mutafë Prizreni, ku burrat rrinin këmbëkryq për të marrë sa më shumë njerëz. "Një pasuri e tillë siç ishin bisedat nuk mund të ruhej veçse në një ngrehinë të thjeshtë, e cila nuk duhej të tërhiqte vëmendjen e grabitësve dhe keqbërësve. Një pasuri e tillë e brendshme sikur nuk i pranonte zbukurimet dhe stolitë e jashtme. Në atë thjeshtësi gati shpellore janë ruajtur vlera të mëdha, tërë pasuria shpirtërore e popullit. Aty ka funksionuar ai mekanizmi i çuditshëm që prodhonte art, filozofi, strategji, politikë, diplomaci, e gjithçka tjetër. Aty në ato pak metra katrore kishte "aerodrome" ku "avionët" e mendjes ngriheshin dhe uleshin vazhdimisht, kalonin detra dhe oqeane, shtete dhe kontinente. Aty bëheshin planet e betejave e të luftërave, aty fillonin kryengritjet popullore, aty lidheshin aleancat, firmosej paqja, aty i kishin selitë konsullatat e ambasadat e shteteve të huaja, aty trokonin trenat e Orientit dhe të Oksidentit, aty ishte abetarja e enciklopedia, universitetet, telekomi, radarët, kompjuterat, transmetimet satelitore, interneti etj. [4]



FILOZOFIA POPULLORE / XHAFER MARTINI
Botimet M&B, 2017 / ISBN 978-9928-4458-3-4 / Faqe 256 / Çmimi: 1000 lekë

1) Margaret Hasluck: "Kanuni Shqiptar", Tiranë 2006, f. 33 (Referohet sipas librit "Perlat e Dibrës". Botimi i dytë, Tiranë 2008, f. 46)
2) Xhafer Martini: "Perlat e Dibrës", Tiranë 2008, f. 124
3) Martini: "Perlat e Dibrës": 2008:30
4) Martini: "Perlat e Dibrës": 2008:47

Poezi nga
Sanie Degjoni Ndreka



TË JESH GRUA / **Sanie Ndreka**
Botimet M&B, 2018
ISBN 978-9928-256-22-5
Çmimi: 700 lekë

Të jesh grua

Sapo ka dalë në qarkullim libri "Të jesh grua", i autores Sanie Degjoni Ndreka, botuar nga Shtëpia botuese M&B.

Ky libër me poezi vjen pas disa botimeve të tjera të autores.

Sanie Degjoni Ndreka u lind në Brezhdan, Peshkopi. Pas diplomimit në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi, ka punuar si mësuese në disa shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Ka punuar si drejtore e shkollës 9-vjeçare Arras dhe nëndrejtore e shkollës 9-vjeçare "Selim Alliu", Peshkopi. Është trajnuar për metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ka botuar librin me poezi "Ëndrra të vrara". Poezitë e saj janë botuar edhe në librin "Antologji e poezisë dibrane". Ka botuar, me bashkautore Femie Kaziun, librat për fëmijë "Një buqete për ju", në dy vëllime për klasat 1-2 dhe 3-4.

Ka menaxhuar për disa vite në mënyrë të suksesshme kopshtin e saj privat "Fluturat". Bashkë me kolegen Femie Kaziu po përgatisin një libër tjetër për fëmijë. Vazhdon të punojë me pasionin e saj të kahershëm si mësuese e suksesshme!



Përjetim

Kisha provuar një herë
detin me këmbë.
Më duket se një tjetër herë
luftova me mullinjtë e erës
si Don Kishot.
E ferrit të Dantes i rashë
pash e me pash.
Po krenarinë
rrugës askund s'e lashë.
Më pas u kreha bukur
me krehrin e argjendtë
me mendimet që kacavirren
si enigma të një kohe të çmendur
fillova prapë të zgjedh mend!
Madhështor ai çast
kur të tjerët para meje
janë veçse hije
që fshehin fytyrat prej hiene!!!

Jetë më dhuroni...

(fëmijëve të mi)

Pikëzat e mia të mjaltit
që më ushqeni çdo ditë
me pjalm lulesh, nektarë
me kalori të shëndetshme
me copëza dashurie
të kristalta si ujëvarë.

Me dhuroni çdo ditë
energji
që ta filloj të nesërmen
një ditë të re, ndryshe
gjithsesi!

Kjo është jeta

Në jetë ka jetë
që zgjasin një jetë
në jetë ka jetë
që mbeten në gjysmë
në jetë ka pengje
që s'u thanë kurrë,
në jetë ka duar
që zgjaten urë!

Në jetë ka zemra
që nuk përgjysmohen,
në jetë ka dashuri
që nuk shteron kurrë,
në jetë ka finesë
që mbetesh grua
në jetë ka vepra
që mbetesh burrë!

In memorie 5

(Bashkëshortit tim M. Ndreka)

Sa e sa herë kthehem
tek ky kënd i bibliotekës
Pas kaq vitesh të gjata
sa një jetë,
Me fotot e tua pranë
por pa ty!
Sa herë folëm për dashurinë
dimensionet pa limit!
Dashuria s'ka fund më thoje
por as fillim,
E kemi aty çdo çast e moment
dashuria është pritje, ikje, kthim
Është gëzimi i së përditshmes
është puthje, përqafim,
është aty, por pa ty!

E përhumbur nga mungesa
jote e gjatë
Ti sfidon me buzëqeshjen tënde,
Gjunjëzimi s'është për fitimtarët
më thua!
Të dukem e gjunjëzuar?
Jo, kurrë
ende s'më besohet
që s'je më aty!
dhe pa ty!

Ti që më flisje gjithmonë
për sakrificat e orëve të vona
të mjekut të rojes,
për jetë të shpëtuara fëmijësh,
për dhjetëra beteja të fituara mbi vdekjen
për shpresë jete dhe projekte!

Na dhemb ikja jote e shpejtë
një vend bosh në tavolinën e gëzimeve,
një trokëllitje e munguar gote.
Se ti nuk ishe aty
në gëzimin më të bukur të vajzës
kishe mbledhur gjithë nektarin e botës
si pikëzat e vesës së agut,
e shpesh ëmbëlsisht i thoje
Princesha e babit!
Se ti nuk ishe aty
në gëzimin më të bukur të djalit
kish mbledhur gjithë kaltërsinë e qiellit
me vezullime të arta të yjeve,
e shpesh ëmbëlsisht i thoje
Drita e syve!
Po ti s'ishe aty
as për ditëlindjen tënde e timen
të festonim si përherë
Atje tek Class
me nga një gotë festash
me verë!
Na mungojnë dhuratat e tua
lulet, librat me dedikim
mungon mundimshëm
në çdo gëzim,
Si se dije që ishte një ikje
pa kthim!

Flas me ty çdo mëngjes,
çdo mbrëmje
Aty në një kënd të bibliotekës,
mes librash që na i dhuroje ti!
Shpesh dhimbja na kaplon të treve
unë jua lexoj dhimbjen
fëmijëve në sy, por pa ty!
Është e egër bota ku jetojmë
sado vlera të kesh
këtë s'e kam ndier
kur isha me ty!
Po ti buzëqesh, prapë si përherë,
hiç mos u trishto më thua,
e ne vërtetë po ia dalim,
ashtu ndershëm dhe njerëzisht
siç na mësove ti!
Ndaj flasim parreshtur
Çdo mëngjes, çdo mbrëmje
Me ty, për ty!

E vërtetë

Sidomos fajtorëve
vërju një emër!
Se faji mbetet gjithmonë jetim,
e vërteta nuk ka çmim!
E thotë e madhja Nënë Terezë
Njerëzit që gabojnë
të japin një mësim!

Poeti dhe lulet

Lulet dhe poeti janë një
lulet ishin aty
para njerëzimit.
Pastaj erdhën poetet
dhuruan pjalm lulet
dhe nektar bletët
dhe u ngjizën poetët.
Simbioze perfekte.
E çfarë nuk krahasuam me lulet
vajzat si lulet, dashuria si lulet,
e bukur si lulet
erëmirë si lulet
qëndisur si lulet.
U tha muza e poetit
kur u thanë lulet,
lulet e thara nuk buzëqeshin
Lulet e thara akuze
për të dëshmuar pritjen....
ikjen, udhën e kthimit
dëshmi autentike
copëza të thyera të trishtimit!

Ndjesi

Atë ditë të bardhë gushti
shiu m'u duk si femër
me flokë të qullëta,
me buzë të ngrohta
të lagura nga puthja.
Më përkëdhelin
pikëlzat e shiut në fytyrë
lehtas si krahë pulëbardhe.

U zgjova nga ëndrra
me njëmijë pendime,
vetëm pulëbardhat e qiellit
dinë të përkëdhelin kështu.

Rastësisht

Duhet shumë pak
për të t'u prishur dita:
Një zgjim pa ngjyra
Rastësisht me të marrin
e parë një takim
E ç'kapriço bën dhe natyra.
SYZA MIOPI

Zbulo diçka të bukur
te vetja çdo ditë,
le t'i mungojnë,
botës së verbër sytë
Do të mjaftojë edhe vetvetja
për t'u bërë bashkë
për t'i thënë botës mjaft!
Je hipokrite, je e padrejtë!
je dreqi vetë,
Kufiri i së keqes
s'është i pamundur
për t'i thënë botës
vër syze
ose ndërro numër!

Eh... Jetë

Shtigje të ashpra të rrugës jete
ca rrugë përgjysmë në ngjitje përpjetë
ca rrugë i humbëm ende pa i gjetë
gënjim zhgënjim qenka kjo jetë!

Si trëndafili

I kuq trëndafili i zemrës,
Rozë trëndafili i dashurisë,
i bardhë trëndafili
i engjëjve të qiellit
simbol i përjetësisë!

Trëndafila si deti
ngjyrë blu...
Dy sytë e tu!

Rruga e Arbërit nr. 146

kujtesë

Hafiz Visha u ka qëndruar dhe vazhdon përsëri që t'ju qëndrojë pranë njerëzve në nevojë, duke u kryer të gjitha vizitat dhe analizat në klinikën e tij falas.

Hafiz Visha, një emër i njohur në mjekësinë shqiptare

Nga **Munir HOXHA**

Kam shumë e shumë vite që shkruaj, portrete e skica, reportazhe e poezi, tekste të ndryshme këngësh që i këndojnë këngëtarë edhe nga Shqipëria por edhe nga Kosova. Dhe jam i lumtur se sado pak jam munduar të hedh një gur të çmuar në godinën e artit, kulturës e folklorit shqiptar.

Sot krejt ndryshe e rroka penën, them krejt ndryshe se e di që jam shumë i vonuar. Të shkruash për njerëzit e thjeshtë, për njerëzit që dijet që kanë përfituar në shkollë kërkojnë ti shfrytëzojnë në dobi të shëndetit të njerëzve. Ndoshta me të drejtë shumë kush mund të thotë se vitet e fundit humanizmi në shëndetësi ka humbur, nuk ekziston. Krejt ndryshe mendoi unë. Kur ke madhe që kishte për profesionin e mjekut, gatishmëria e vullneti i fortë që kishte për të punuar në kushte mjaft të vështira e në një teren malor, e bënë doktor Hafizin njeriun më të dashur dhe respektuar në të gjithë krahinën e madhe të Kalasë së Dodës. Emri i tij u përhap si era, anembanë trevës së Kalasë por dhe jashtë sinorit të saj, personaliteti i tij gjithmonë vinte në rritje. Kudo lakohej me respekt. "Zoti në qiell e doktor Hafizi në tokë", shpreheshin në raste të vështira ku sytë e të gjithëve ishin mbërthyer në derë kur do të futej me çantën e ndihmës së shpejtë doktor Hafizit.

Vite më vonë doktor Hafizi kreu specializim të plotë për radiologji-imazheri. Ishte ndoshta i vetmi specialitet që kishte nevojë jo vetëm Kalaja e Dodës por e gjithë Dibra. Pas



përballë mjekun e talentuar, birin e Kalasë së Dodës Hafiz Visha, bindesh plotësisht në këtë që them.

Hafizi lindi në Kala të Dodës, në fshatin Ceren më 8 dhjetor 1965 në një familje të mirë e të njohur atdhetare, bujare e arsimdashëse. Hafizi fëmijë ëndërronte shumë, ëndërronte kur shikonte mjekun e vetëm në fshat që me një çantë të thjeshtë në dorë futej shtëpi më shtëpi kur kishte ndonjë të sëmurë e kërkonin ndihmën e tij. "Mjeku shpëton jetë" mendonte djaloshi i Cerenit dhe unë e kam një ëndërr në jetë. Të bëhem mjek e ti shërbej popullit tim" Kështu ëndërronte atëherë Hafizi fëmijë por ëndrrën e kishte mbajtur në sirtar. Do të rritej djaloshi, do të përfundonte shkollën në fshat dhe pastaj do të vazhdonte shkollën e mesme në qytetin e Peshkopisë në vitet 1979-1983, dhe kjo falë ndihmës e kontributit të xhaxhait të tij Destan Vishës.

Ajo ëndrra e kahershme më së fundi u realizua fill pas përfundimit të shkollës së mesme. Vazhdoi studimet e larta në mjekësi të cilat i përfundon me rezultate të larta që klasifikohet një ndër studentët më të mirë të asaj periudhe. Fill pas diplomimit si mjek i përgjithshëm emërohet në vendlindjen e tij, në Kala të Dodës. Derë më derë e shtëpi më shtëpi, në kohë të mirë, në borë e stuhi, doktor Hafizi do të gjendej pranë çdo të sëmuri që kërkonte ndihmën e tij. Asnjëherë nuk u mërzit, asnjëherë nuk u pendua se pse zgjodhi këtë profesion human, kur vinin në çdo orë të natës e binte dera. Doktor Hafizi gjithmonë i pa përtuar, me një elektrik dore do të vraponte para shoqëruesit e do të gjendej tek i sëmuri. Përkushtimi dhe dashuria e

Doktor Hafizi u ka qëndruar dhe vazhdon përsëri që t'ju qëndrojë pranë njerëzve në nevojë duke u kryer të gjitha vizitat dhe analizat në klinikën e tij falas. Doktor Hafizi mbetet një shembull model për tu marrë nga të gjithë mjekët e tjerë se ende humanizmi nuk ka vdekur.

viteve nëntëdhjetë doktor Hafizi zhvendoset familjarisht me banim në Tiranë. Klinika e tij "Visha" ka krijuar një emër të mirë dhe një besueshmëri të lartë.

Përvoja e gjatë, përballja me një mori sëmundjesh të ndryshme, ndoshta edhe nga më të rrallat e bëri kështu të njohur doktor Hafizin edhe ndaj kolegëve të tij si njeri e mjek që sfidon e fiton mbi të keqen.

Duke përfunduar e duke qenë i bindur se kamë lënë edhe shumë gjëra pa thënë nuk mund të lë pa përmendur virtytet njerëzore më të mira të Hafizit si njeri, intelektual, mjek i kualifikuar, human në shpirt. Ai u ka qëndruar dhe vazhdon përsëri që t'ju qëndrojë pranë njerëzve në nevojë duke u kryer të gjitha vizitat dhe analizat në klinikën e tij falas. Doktor Hafizi mbetet një shembull model për tu marrë nga të gjithë mjekët e tjerë se ende humanizmi nuk ka vdekur. Ka njerëz të mirë me shpirt e zemër që kontribuojnë vazhdimisht në shëndetin e njeriut.

Faik Xhani, 70 vjet jetë aktive me vizion, freski e energji

Nga **Met DELIU**



70-vjetori i ditëlindjes është nga festat më të bukura e më domethënëse për çdo njeri. Kjo është mosha kur jeta fillon e flet për ty me ato që ti ke bërë gjatë saj dhe kjo të shton krenarinë e të nxit sedrën për të bërë dhe shumë gjera të tjera të mira në shërbim të vetes, familjes dhe shoqërisë.

Në këtë moshë ke akoma mundësi e optimizëm, ke pjekurinë dhe përvojën, për të realizuar punëra të tjera dhe më të mëdha.

I dashur Faik!

Ti mbushe 70-vjet jetë e punë aktive, por në shpirtin, vizionin dhe fizikun tënd ke shumë rini, freski dhe energji realizuese. Në këtë 70-vjetor ti vjen me një panoramë komplekse e shumë të pasur. Në 20 vitet e para të punës tënde intelektuale ke dhënë kontributin tënd të vyer në administratën shtetërore vendore, duke i dhënë asaj fytyrën njerëzore.

Në 25 vitet e fundit, na shfaqesh plot dinjitet, duke depërtuar e eksploruar fusha e tema interesante të historisë, të kulturës e deri te figura e bëma të veçanta, shqiptare e të huaja. Në veprimtarinë tënde të shumanshme shohim forcën integruese, modelin e njeriut të përshtatur me frymën e kohës, aktivistin e gjithanshëm, gjurmuesin e gjithçkaje me motivin e mbijetesës dhe për t'ia transmetuar brezave.

Gjithçka e përjetuar nga Faiku ka marrë jetë dhe është fiksuar me realizëm të veçantë në librat e tij të shumtë e mbresëlënës.

Krijimtaria e Faikut është rritur natyrshëm, duke u pjekur dhe shtrirë në shumë fusha. Nga koha në kohë ajo është bërë më intensive, më e vrullshme, me problematikë të gjerë e të thellë ku të gjitha shtresat, moshat dhe profesionet gjejnë veten.

Është interesant fakti se, Faiku, në të gjithë librat e tij i trajton ngjarjet dhe personazhet me mjeshtëri, dashuri e delikatesë, në përputhje me modelin e sjelljes së tij në marrëdhëniet e përditshme me cilindo. Personazhet e tij janë jetësorë, gjuha e tyre është elokuente, e pasur dhe e kuptueshme. Midis shprehjes e mendimit, problematikës dhe asaj që personifikon çdo personazh, mbizotëron një unitet i veçantë në llojin e vet. Vepra e Faikut është sa artistike aq edhe reale, sa analizë e realitetit aq dhe sintezë e fantazisë së zhvilluar, sa gërshetim i formimit, kulturës e aftësive krijuese, aq dhe triumf mbi sfidat e gjalla të vetë jetës së tij.

Vepra e tij u flet të gjithëve me thjeshtësi. Ajo kuptohet e asimilohet me lehtësi nga intelektualët dhe nga shtresat e gjera. Ajo nuk është shkruar në sallone mondane e uikende të gjata. Kjo vepër ka lindur natyrshëm në ecje e sipër, në mendjen e një vëzhguesi të hollë që prek ndjeshmërisht çdo marrëdhënie njerëzore me realitetin. Ajo është shkruar vijimësisht netëve pa gjumë, është rritur e ka dalë në dritë me sakrificat e vetë autorit dhe dashamirësisë së një rrethi të ngushtë njerëzish, të cilët urimi e mirësia i ndjektë ngaherë!

Vepra e tij u flet të gjithëve me thjeshtësi. Ajo kuptohet e asimilohet me lehtësi nga intelektualët dhe nga shtresat e gjera. Ajo nuk është shkruar në sallone mondane e uikende të gjata. Kjo vepër ka lindur natyrshëm, në ecje e sipër, në mendjen e një vëzhguesi të hollë që prek ndjeshmërisht çdo marrëdhënie njerëzore me realitetin.

Është nder që në moshën 70-vjeçare të ndjehesh e të jesh si ti, shok e mik i ndjeshëm, punëtor, studiues e krijues i formuar, bashkëbisedues i këndshëm, bartës dhe realizues i së mirës, plot freski e energji, i pëlqyer dhe i vlerësuar nga njerëzit e thjeshtë deri te intelektualët më në zë të kohës.

Vitet që kanë kaluar, nuk të kanë lëvizur e deformuar. Ato vetëm të kanë pjekur, të kanë shtuar reflekset, të kanë kalitur vullnetin dhe kanë ndikuar fuqishëm në shumëfishimin e krijimtarisë letrare.

Me rastin e 70-vjetorit të lindjes, nga zemra të uroj shëndet të mirë, jetë sa më të gjatë e të lumtur, krijimtari të suksesshme letrare dhe fat e mbarësi, për vete e për të mirën e familjes dhe të shoqërisë.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit


<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Kapiteni Floran Delia u nderua me titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes).

Humbi jetën në detyrë, Dibra nderon kapitenin e FA



Dibra do të kujtojë përherë kapiten Floran Delia, pilotin e Forcës Ajrore, i cili humbi jetën në një aksidenti ajror 2 vjet më parë.

Në një ceremoni të zhvilluar në mjediset e Pallatit të Kulturës në Peshkopi, me vendim të Këshillit Bashkiak, ku merrnin pjesë familjarë, kolegë dhe qytetarë të Peshkopisë, kapiteni Floran Delia u nderua me titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes).

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, në fjalën e rastit u shpreh se kujtimi i heronjve të FA të rënë në krye të detyrës është njëherësh angazhim për vëmendjen që meritojnë ushtarakët shqiptarë.

"Ky angazhim solemn që në fakt më takon ta marr edhe personalisht në cilësisnë e ministres së Mbrojtjes, na detyron të gjithëve të kujtojmë me shumë respekt sakrificën e të gjithë atyre që nuk jetojnë më.

Njëherësh është edhe angazhim për të nderuar të gjithë ushtarakët që i shërbejnë atdheut, që kanë marr përsipër të rrezikojnë edhe jetën e tyre për të bërë profesionin shumë të nderuar të ushtarakut, por edhe profesionin e rrezikshëm të pilotit", tha Ministrja në fjalën e saj.

Ministrja e Mbrojtjes falenderoi qytetarët e Dibrës për këtë gjest bujar:

"Shumë faleminderit qytetarëve të Dibrës për këtë gjest bujar por shumë të merituar për heorin tonë. Dhe duke nderuar Floranin njëherësh keni nderuar vlerësuar kontributin e secilit prej 8 mijë efektivëve të FA për të kontribuar për sigurinë e vendit dhe për jetën e çdo qytetari të Republikës të Shqipërisë".

Me vendim të Këshillit Bashkiak, edhe rruga Ceren – Radomirë do të mbajë emrin e kapitenit të lindur e rritur në Dibër. Kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, ranë në krye të detyrës në mesditën e 6 prillit të vitit 2016 gjatë një fluturimi stërvitor në Grizhë të Malësisë së Madhe.

Të dy ushtarakët janë shpallur ''Dëshmorët e Atdheut'' nga Komisioni Shtetëror për Dëshmorët./a.ç

Ike o Besim Daci, parajsa është jotja!



Ekisha bërë të derdh ndjenjat e mija të shpirtit për komshiun tim në hyrjen tjetër të pallatit tonë në Peshkopi, Besim Dacin, shoferin e "Korabit", qytetarin, prindin e përkushtuar, njeriun që e vlerësoja si "Qytetar Nderi" i trevës ku lindi, u rrit, bëri emër të përveçëm...

Sa ishte në jetë...

Tash, me hidhërim mësoj nga e bija, Zhuljeta, se Besim Daci iku...

Iku për të bërë vend në parajsën njerëzore.

Më erdhi keq.

Mu desh të kërkoj në arkivin tim fotografik...

E gjeta në Kifisia të Athinës...

Krah për krahu në një shëtitje mbrëmjeje...

E gjeta krah për krah në një portret që na bëri djali im, Indriti...

E gjeta familjarisht së bashku...

Një pikë loti kapërcej rrudhat e moshës mbi fytyrën time...

Besim Daci iku...

Nuk është më...

Fjala "ngushëllim" më vjen e ftohtë tua them fëmijëve të tij, bashkëshortes, të afërmeve ku i ka, miqve me të cilët u takua dhe udhëtoj në jetë...

Po them:

Të rroni!...

Ta kujtoni!...

Ta nderoni!...

Se prindi është në jetë të jetëve kur fëmijët e kujtojnë dhe e nderojnë.

E dini atë shprehjen e madhe popullore?

Është djali...

Është vajza...

Është nipi...

Është mbesa...

Është e shoqja...

E ...

Ike or Besim Daci, ike...

Ike o prind dhe gjysh Besimi duke lënë pas një emër me të cilin krenohen fëmijët, nipërit, mbesat, njerëzit që i deshe dhe të deshën...

Këtyre ndjenjave të çastit po u shtoj tri fotografi nga takimi në Kifisia të Athinës në një mbrëmje dashurie e respekti...

I lehtë dheu qoftë të përjetësi...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 27 qershor 2018

XHELAL KAROSHI, ushtaraku që kujtohet me respekt nga Jugu në Veri



Në fillim të qershorit u nda nga jeta, në moshën 70 vjeçare, Xhelal Selman Karoshi.

Xhelali u lind në Tiranë më 25 mars 1948, por shumë shpejt familja e tij u kthye në vendlindje, në Fushë Alie të Dibrës. Xhelali lindi në një familje atdhetare. Babai i tij, Selman Karoshi, kishte kryer studimet ushtarake në Itali dhe prej andej u përfshi me forcat partizane, deri në çlirimin e plotë të vendit..

Xhelali u rrit në një familje të madhe dhe në kushte të vështira. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në fshat, edukimi atdhetar i familjes ngjiti te Xhelali dëshirën duke shkuar në fidanishten e ushtrisë shqiptare në shkollën "Skënderbej" e mandej në shkollën e bashkuar ushtarake.

Xhelali atje u dallua për rezultate të larta duke u titulluar oficer në organet e sigurisë. Çdo njeri ka një origjinë, por Xhelali u bë i gjithë Shqipërisë duke shërbyer në Dibër, në male të Kurveleshit, në qytetin e metalurgëve Rubik e në bregdetin e Durrësit ku mbylli karrierën.

Në vitin 1970 u martua me Lefterinë, e cila e ndoqi në çdo hap duke lindur 2 fëmijë Rudinën dhe Arbenin që kanë vendlindje Tepelenën, u rritën në Rubik e së fundi krijuan familjet në Durrës e jashtë vendit. Xhelali dhe Lefteria nuk u la fëmijëve ndonjë pasuri, por u la atyre emrin e mirë. Ata shkëlqyen dhe mbetën jo vetëm në zemrat e familjarëve të tij, por edhe në kujtesën e malësorëve të Dibrës, Mirditës e Labërisë, në Shqipërinë e Mesme e te të komshinjve të tyre e çdo njeriu që i njohu.

Xhelali përshtatej me çdokënd në jetë, ka qenë praktik, duke e jetuar atë në përshtatje me rrethanat, duke i kapërcyer me kurajë situatat që i ka sjellë jeta.

Xhelali ka dhënë një kontribut shumë të vyer në periudhën e ndryshimit të sistemit, duke përgatitur e motivuar efektivët e policisë, në përputhje me standardet e reja të kohës, duke qenë kështu një shembull për tu ndjekur.

Me daljen në reforma kreu punë të ndryshme, edhe fizike, për të plotësuar kushtet e familjes e duke mos u dorëzuar.

Xhelali e Lefteria, në mendjet e kujtdo do mbaheni mend si një çift shembullor, si prindër model, si qytetar të ndershëm, si shembull për çdo njeri që bëhet prind.

I paharruar qoftë kujtimi i tyre.

Xhelo Tozaj, Nevruz Brezi, Kamber Manjani, Skënder Lusha, Selim Lata, Hysen Repa



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/ Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.



Tortë me mollë



PËRBËRËSIT PËR 8 PERSONA: mollë 700 gr.; gjail 100 gr.; vezë 2 kokrra; sheqer 200 gr.; miell 200 gr.; limon 1 kokërr; kanellë 2 gr.; qumësht 50 ml.; maja 1 bistinë.

VËSHTIRËSIA: e thjeshtë.

KOHËZGJATJA: 80 minuta.

PËRGATITJA: Qërojmë mollët, i patrojmë nga brenda dhe i presim në feta të holla. I vendosim në një enë dhe shtojmë lëkurën e limonit, të cilën e kemi grirë në rende. Shtojmë vezët dhe sheqerin dhe i përziejmë. Më pas shtojmë gjalpin e butë, miellin, kanellën qumështin dhe majanë. I përziejmë mirë deri sa të krijojmë një masë homogjene. Masën e përftuar e hedhim në një tavë ëmbëlsire të cilën paraprakisht e kemi lyer me gjalp dhe miell. Tavën e fusim në furrë të ngrohtë në temperaturën 170 0 për rreth 60 minuta.

info@vivandachef.al

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT...

Kushton vetëm 600 lekë në vit... / email: rrugaearberit@gmail.com


LIBRA

Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 qershori deri më 30 gusht 2018


...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...




1500 lekë



1500 lekë



700 lekë



800 lekë

Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.

Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):